

**RREGULLAT E
TREGUT SHQIPTAR
TË BALANCIMIT TË
ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Final 27.2.19

Përmbajtja

| | | |
|-------|---|----|
| 1 | DISPOZITA TË PERGJITHSHME | 5 |
| 1.1 | Qëllimi dhe objektivi..... | 5 |
| 1.1.1 | Qëllimi | 5 |
| 1.1.2 | Objektivi | 5 |
| 1.2 | Fjalor dhe marrëveshje | 5 |
| 1.2.1 | Marrëveshje | 5 |
| 1.2.2 | Fjalor..... | 6 |
| 2 | BAZA LIGJORE | 7 |
| 3 | DISIPLINIMI | 7 |
| 3.1 | Miratimi i Rregullave TShB..... | 7 |
| 4 | QELLIMI..... | 8 |
| 4.1 | Rolet dhe përgjegjësitë | 8 |
| 4.1.1 | OST..... | 8 |
| 4.1.2 | OShB | 10 |
| 4.1.3 | PPB..... | 12 |
| 4.2 | Detyrimet mbi të gjitha Palët e Lidhura..... | 13 |
| 4.2.1 | Detyrimi për të siguruar matje të përgjegjshme në pikën / pikat e caktuar/a të shkëmbimit me rrjetin ose marrëveshja me palën lidhëse (OST ose OSSh) se si përcaktohen ndryshe këto shkëmbime | 12 |
| 4.2.2 | Detyrimi për të emëruar një Palë Përgjegjëse për Balancimin (ose të bëhet vetë e tillë)..... | 13 |
| 5 | BALANCIMI I SISTEMIT | 14 |
| 5.1 | Specifikimi i masave që duhet të merren nga OST në rastin e disbalancave në sistem | 14 |
| 5.1.1 | Veprime parandaluese balancimi ndaj veprimeve balancuese nga OST të huaja brenda të njëjtës zonë sinkronizimi (rrjeti i balancimit)..... | 13 |
| 5.1.2 | Masat dhe rendi në të cilin ato zbatohen | 13 |
| 5.2 | Përgjegjësia e balancimit..... | 15 |
| 5.2.1 | Përkufizimi..... | 15 |
| 5.2.2 | Njohja si PPB | 15 |

| | | |
|------------|---|-----------|
| 5.2.3 | Regjistri i Palëve Përgjegjëse Balancuese | 15 |
| 5.3 | Proçesi i Nominimeve të Energjisë | 17 |
| 5.3.1 | Proçesi i nominimit..... | 18 |
| 5.4 | Proçesi i shkëmbimit të të dhënave të matjes..... | 18 |
| 5.5 | Rregullat Operative në lidhje me nominimet dhe shkëmbimin e të dhënave të matjes | 18 |
| 5.5.1 | Rregullat në lidhje me nominimet..... | 18 |
| 5.5.2 | Rregullat në lidhje me shkëmbimin e të dhënave të matjes | 18 |
| 5.6 | Çmimi i disbalancave | 18 |
| 5.7 | Kërkesat e kolateralit të PPB | 19 |
| 5.7.6 | Garancitë financiare ndryshojnë në varësi të llojit të PPB: | 19 |
| 5.8 | Faturimi dhe shlyerja për PPB | 21 |
| 5.8.1 | Faturimi..... | 21 |
| 5.8.2 | Fatura e disbalancave | 23 |
| 5.8.3 | Afati i pagesës..... | 21 |
| 5.8.4 | Kundërshtimet..... | 24 |
| 5.8.5 | Modalitetet për mbledhjen e çdo shume të papaguar..... | 24 |
| 5.9 | Proçesi i ndryshimit të PPB..... | 24 |
| 5.9.1 | PPB përfundon shërbimet e saj..... | 24 |
| 5.9.2 | Ndryshimi i PPB-së në një pikë lidhje..... | 25 |
| 5.9.3 | PPB e mundësisë së fundit..... | 25 |
| 6 | PËRKUFIZIME TË PRODUKTIT | 25 |
| 6.1 | Lista e produkteve | 25 |
| 6.2 | Rezervat e mbajtjes së frekuencës (FCR) | 26 |
| 6.3 | Rezervat e rivendosjes së frekuencës të aktivizuara automatikisht (aFRR) | 27 |
| 6.4 | Rezerva e rivendosjes së frekuencës e aktivizuar manualisht (mFRR) | 29 |
| 6.5 | Rezerva zëvendësuese (RR) | 29 |
| 6.6 | Rezervat e Emergjencës (ER) | 28 |
| 7 | PARAKUALIFIKIMI | 28 |
| 8 | PROÇESI I ANGAZHIMIT MBI DISPONUESHMËRINË DHE SHPËRNDARJEN..... | 29 |
| 9 | PROÇESI I AKTIVIZIMIT..... | 29 |

| | | |
|------|--|-----|
| 9.1 | FCR | 29 |
| 9.2 | aFRR..... | 29 |
| 9.3 | mFRR/RR me kohë aktivizimi ≤ 30 min. | 34 |
| 9.4 | Rezervat e Emergjencës | 34 |
| 9.5 | Rezerva Zëvendësuese me kohë aktivizimi > 30 min. | 34 |
| 10 | FATURIMI DHE SHLYERJA PËR OShB..... | 35 |
| 11 | MENAXHIMI I KONXHESTIONEVE TË BRENDSHME | 35 |
| 12 | ANEKSET | 37 |
| 12.1 | Modeli i Marrëveshjes së OShB (në një dokument të veçantë) | 37 |
| 12.2 | Modeli i Marrëveshjes së PPB (në një dokument të veçantë)..... | 337 |
| 12.3 | Specifikime të Rregullave të Operimit (në një dokument të veçantë) | 34 |
| 12.4 | Përcaktimi i çmimeve të disbalancave | 35 |

1 DISPOZITA TË PERGJITHSHME

1.1 Qëllimi dhe objektivi

1.1.1 Qëllimi

1.1.1.1 Qëllimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit është të:

- a. themelojnë menaxhimin me bazë tregu të balancimit të Sistemit Elektroenergjitik, që operohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- b. përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në tregun e balancimit;
- c. mundësojnë përgjegjësi të qarta të balancimit për pjesëmarrësit e tregut;
- d. përshkruajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimit të balancimit,
- e. krijojnë një mekanizëm për përcaktimin e çmimit të shërbimeve balancuese të prokuruar nga OST si dhe mekanizmin për llogaritjen e çmimit të shlyerjes së disbalancave dhe pagesave financiare të disbalancave për Palët Përgjegjëse të Balancimit; dhe
- f. çështje të tjera që lidhen me operimin e tregut balancues.

1.1.2 Objektivi

1.1.2.1 Objektivi i Rregullave të TShB është krijimi i një mekanizmi balancues eficient, transparent dhe jodiskriminues që përcakton përgjegjësitë e balancimit dhe nxit pjesëmarrësit e tregut të kryejnë balancimin si dhe të ofrojnë shërbime balancuese.

1.2 Fjalor dhe marrëveshje

1.2.1 Marrëveshje

1.2.1.1 Në këto Rregulla TShB, me përjashtim të rastit kur citohet ndryshe:

- a. numri njëjës përfshin numrin shumë të anasjelltas;
- b. referimi për çdo gjini përfshin edhe gjininë tjetër;
- c. Referimi në çdo dokument ligjor ose akt nënkupton dokumentin ligjor ose aktin siç është në fuqi sipas rastit, në përputhje me termat e tij; me kusht që referimi të Rregullat e Tregut nënkupton Rregullat e Tregut që janë në fuqi në datën kur janë miratuar këto Rregulla TShB;
- d. referimet në çdo legjislacion përfshijnë referimet për çdo amendim ose rimiratim të këtij legjislacioni si dhe çdo legjislacion që ka zëvendësuar atë legjislacion; dhe
- e. referimet në dokumentet ose aktet ligjore do të konsiderohen që i referohen të gjitha shtesave ose amendimeve të tyre.

1.2.1.2 Në këto Rregulla të TShB:

- a. Koha – do të jenë me Orën Lokale në Shqipëri.

- b. Monedha – monedha e përdorur në këto Rregulla të TShB do të jetë në Euro pasi tregjet e organizuara *ex-ante* të energjisë elektrike janë të qarta mbi këtë.
- c. Njësitë – Të gjitha njësitë teknike shprehen në Sistemin Ndërkombëtar të Njësiave (SI). Gjenerimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë elektrike shprehen në kWh (MWh, GWh), në mënyrë të ngjashme gjenerimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë reaktive shprehet në kVARh (MVARh). Kapaciteti ose kërkesa ose Fuqia shprehen në kW (MW).

1.2.2 Fjalor

| | |
|--------------------|--|
| aFRR | Rezervat për Restaurimin e Frekuencës të aktivizuara automatikisht |
| PPB | Pala Përgjegjëse për Balancimin |
| OShB | Ofrues i Shërbimit të Balancimit |
| Zonë Kontrolli | Zonë kontrolli LFC |
| Bllok Kontrolli | Bllok kontrolli LFC |
| OSSH | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes |
| NgM | Ngarkesë e menaxhueshme |
| EBGL | Udhëzuesi mbi Balancimin e Energjisë në Evropë |
| ENTSO-E | Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike |
| ERE | Enti Rregullator i Energjisë |
| FCR | Rezervat për Mbajtjen e Frekuencës |
| FRR | Rezervat për Restaurimin e Frekuencës |
| BrendaDitës (ID) | BrendaDitës në Rritje/Rënie |
| TBrendaDitës (IDM) | Tregu Brenda Ditës |
| PShD | Periudha e Shlyerjes së Disbalancave |
| KESH | Korporata Elektroenergjitike Shqiptare |
| LFC | Rregullimi Ngarkesë-Frekuencë |
| NC LFC&R | Kodi i Kontrollit Fuqi-Frekuencë (tashmë pjesë e SOGL) |
| L.max | Ngarkesa maksimale në sistem |
| LRR | Rezervat e mundësisë së fundit |

| | |
|---------|---|
| mFRR | Rezervat e Restaurimit të Frekuencës të aktivizuara manualisht |
| OSSh | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes |
| OST sha | Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit |
| BShE | Bursa e Energjisë, që organizon tregun e Ditës në Avancë dhe Brenda Ditës |
| RR | Rezervat Zëvendësuese |
| SOGL | Udhëzuesi për Operimin e Sistemit i EN N-E |
| OST | Operatori i Sistemit të Transmetimit |

2 BAZA LIGJORE

2.1 Ligji për sektorin e energjisë elektrike, nr. 43/2015, i ndryshuar, përcakton "balancimin" si tërësinë e veprimeve dhe proceseve përmes të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufinjve të paracaktuar të qëndrueshmërisë. Tregu Balancues përcaktohet si një menaxhim me bazë tregu i veprimeve për balancimin e Sistemit Elektroenergjitik, i operuar nga OST.

2.2 Rregullat TShB u hartuan si një dokument plotësues i Rregullave të Tregut, sipas Ligjit Për sektorin e Energjisë Elektrike, i cili parashikon që Rregullat e Tregut do të përfshijnë balancimin e energjisë elektrike: Neni 51 pika 1(b), Neni 51 pika 2 (c); Neni 98, neni 99 pika (2) dhe Neni 3 pika Përkufizime (59).

2.3 Rregullat TShB bazohen mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit të të gjithë pjesëmarrësve të tregut si dhe transparencës në komunikim dhe sjelljes korrekte midis OST dhe pjesëmarrësve të tregut (përfshirë PPB dhe OShB). Në rast të ndonjë mospërputhje midis dispozitave që lidhen me balancimin, të vendosura sipas këtyre Rregullave të TShB dhe Rregullave të Tregut, këto Rregulla do të mbizotërojnë.

3 MIRATIMI DHE RISHIKIMI

3.1 Miratimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit

3.1.1 Sipas Neni 98 të Ligjit Për Sektorin e Energjisë Elektrike, ERE, me propozimin e OST sha dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton Rregullat e tregut të energjisë elektrike, ku përfshihen rregullat për planifikimin, dispeçerimin, balancimin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kërkesat për menaxhimin e rezervës.

3.1.2 Këto Rregulla të Tregut Shqiptar të Balancimit do të konsiderohen si Treg Balancues pjesë e Rregullave të Tregut, të parashikuara në Ligjin Për Sektorin e

Energjisë Elektrike, dhe si të tilla ndjekin procesin e hartimit dhe miratimit të përshkruar më sipër.

3.2 Hyrja në fuqi e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit

3.2.1 Rregullat TShB hyjnë në fuqi ditën e miratimit të tyre nga Bordi i ERE-s. Duke pasur parasysh Nenin 2 të VKM nr. 519, datë 13/7/2016 për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Nenin 100 pika (3) të Ligjit nr. 43/2015 Për Sektorin e Energjisë Elektrike, të ndryshuar, ERE duhet të lëshojë një vendim për shfuqizimin e “Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike” në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullave të TShB.

3.2.2 ERE dhe OST do të publikojnë Rregullat TShB në faqet e tyre të internetit.

3.3. Ndryshimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit

3.3.1 Rregullat TShB mund të ndryshohen bazuar në shkaqe të argumentuara nga OST sha, ERE ose nga çdo pjesëmarrës tregu nëpërmjet një kërkesë të drejtuar OST sha. OST sha do të krijojë një Komision përgjegjës për amendimin e Rregullave, i cili mund të iniciojë ndryshimin e Rregullave TShB dhe OST sha do t'i paraqesë zyrtarisht ERE-s ndryshimin e propozuar.

3.3.2 Proçesi i ndryshimit ndjek të njëjtën procedurë si ajo e miratimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit: ndryshimi i propozuar paraqitet nga OST sha në ERE për miratim ose iniciohet nga ERE pas konsultimit me OST sha.

3.3.3 Në përjashtim nga proçesi i përgjithshëm për ndryshimin e tyre, i përshkruar në paragrafin e mësipërm dy muaj pas përfundimit të vitit të parë të funksionimit të Tregut Shqiptar të Balancimit, fillon një “Proçes Fillestar i Shqyrtimit të Zbatimit të Rregullave të TShB”. Proçesi është në varësi të paraqitjes nga OST sha në ERE të një raportit përmbledhës mbi eksperiencën e fituar tashmë me zbatimin e Rregullave të TShB. Raporti do të përfshijë regjistrimin e ankesave dhe/ose vërejtjeve të pjesëmarrësve të TShB si edhe çështjeve të identifikuara nga OST sha, të shoqëruara me veprimet korrigjuese përkatëse. Pas konsultimit të organizuar nga ERE, mund të përgatiten dhe zbatohen ndryshimet në këto Rregulla në vitin e dytë të zbatimit të Rregullave TShB.

3.4 Proçedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit (dhe në Marrëveshjet e PPB dhe OShB)

3.4.1 Në rast mosmarrëveshje, palët e përfshira në mosmarrëveshje do të përpiqen të zgjidhin atë në mirëkuptim, nëpërmjet negocimit ose ndonjë zgjidhje tjetër miqësore.

3.4.2 Në rast se mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet përmes mirëkuptimit, Pala/Palët mund të paraqesin mosmarrëveshjen e tyre tek ERE në përputhje me Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e

mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror (Vendimi i Bordit të ERE-s, nr. 114, datë 8.7.2016).

3.5 Procedura dhe kushtet për vendosjen e gjobave

3.5.1 ERE monitoron performancën e pjesëmarrësve të tregut dhe mund të vendosë gjoba në përputhje me “Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vënies së gjobave” të parashikuar nga neni 107 pika 4 të Ligjit Për sektorin e Energjisë Elektrike.

3.6 Elemente të tjera të Disiplinimit

3.6.1 Çështje të tjera që nuk mbulohen nga këto Rregulla TShB, të tilla si: Kodi i sjelljes, çështjet e konfidencialitetit dhe disiplinime të tjera, do të zbatohen në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut në fuqi.

4 QËLLIMI

4.1 Rolet dhe përgjegjësitë

4.1 OST sha

4.1.1.1 OST sha është Operatori i Sistemit të Transmetimit në Shqipëri, i cili është përgjegjës për ruajtjen e sigurisë së sistemit. Një nga kriteret e sigurisë së sistemit është balanca e sistemit. Për ta ruajtur atë, OST sha do të jetë përgjegjëse për prokurimin e shërbimeve balancuese nga ofruesit e shërbimeve të balancimit (OShB) në mënyrë që të garantojë sigurinë operationale.

4.1.1.2 OST sha është përgjegjëse për minimizimin e kostos së prokurimit të shërbimit të balancimit duke kontraktuar dhe aktivizuar rezervat më efikente në kosto. Çdo vit, OST sha duhet të përcaktojë madhësinë e rezervave balancuese të nevojshme.

4.1.1.3 OST sha do të zbatojë një model të vetë-dispeçerimit për përcaktimin e skeduleve të gjenerimit dhe të konsumit.

4.1.1.4 OST sha është e detyruar të mbajë neutralitetin e saj financiar të rregulluar, duke mbartur në tarifën e vitit të ardhshëm rezultatet neto të shërbimeve të balancimit.

4.1.1.5 Vëllimi i plotë i nevojshëm i rezervës balancuese prokurohet me bazë tregu, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.

4.1.1.6. Nëse vërtetohet se OShB nuk i përmbush më kushtet e parakualifikimit, OST sha do të njoftojë OShB me letër rekomande për çëshjen. Nëse brenda 15 ditëve pas marrjes së njoftimit, OShB nuk vepron mbi letrën rekomande dhe vazhdon të mbetet në papajtueshmëri me kushtet, OST sha ka të drejtën të përfundojë Marrëveshjen me OShB pa miratimin paraprak nga gjykata. Kjo nënkupton që nëse OShB dëshiron të ofrojë shërbimin, pas përfundimit së marrëveshjes, duhet të ri-aplikojë nëpërmjet

procedurës së parakualifikimit dhe të nënshkruajë një Marrëveshje të re me OST sha, në pajtim me kushtet përkatëse.

4.1.1.7 OST sha ka të drejtën të vlerësojë, në çdo kohë gjatë periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së OShB, nëse OShB është apo jo në pajtueshmeri me termat dhe kushtet e përmendura në këtë Marrëveshje të OShB. Për të shmangur paqartësinë, kjo nuk përfshin të drejtën e OST për akses fizik në asetet e OShB, kjo duke mos cënuar rregulloret e tjera p.sh Kodin e Transmetimit, lidhur me aksesin në instalimet e lidhjes së OShB. Nëse vërtetohet se OShB nuk i përmbush më kushtet e Marrëveshjes së OShB, OST sha do të njoftojë OShB me letër rekomande. Brenda 15 ditësh, OShB duhet të provojë se janë ndërmarrë masat e duhura. Në të kundërt Marrëveshja e OShB do të pezullohet për xx ditë. Pas periudhës së pezullimit, OST sha vlerëson përsëri pajtueshmërinë e OShB me kushtet. Nëse është arritur pajtueshmëria, pezullimi anulohet. Nëse jo, Marrëveshja me OShB përfundon. Pas përfundimit të Marrëveshjes, nëse OShB dëshiron të ofrojë shërbimin, duhet të ri-aplikojë nëpërmjet procedurës së parakualifikimit dhe të nënshkruajë një Marrëveshje të re me OST, në pajtim me kushtet përkatëse.

4.1.1.8 Brenda 12 muajve pas hyrjes në fuqi të Rregullave TShB, OST sha do të zhvillojë një proces parakualifikimi dhe do të bëjë të disponueshme publikisht detajet e procesit të parakualifikimit.

4.1.1.9 OST sha ka të drejtën të ndërpresë testimet e Parakualifikimit në çdo kohë nëse ato rrezikojnë sigurinë e Rrjetit të Transmetimit ose të Rrjetit të Shpërndarjes. Në rast se OST sha vendos të ndërpresë Testin e Parakualifikimit, OST sha do të informojë OShB për një datë të re për Parakualifikim, pasi siguria e sistemit të jetë stabilizuar.

4.1.1.10 OST sha ka të drejtën të refuzojë Ofertat e Kapaciteteve që nuk janë në përputhje me rregullat dhe detyrimet e përcaktuara në këto Rregulla TShB dhe në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e OShB.

4.1.1.11 Në rast se vë re një sjellje e cila mund të çenojë Rregullat e Tregut dhe/ose konkurrencën e drejtë midis palëve, pasi është konsultuar me ERE, OST sha rezervon të drejtën të përjashtojë OShB nga prokurimet e ardhshme.

4.1.2 OShB

4.1.2.1 OShB është pjesëmarrës tregu me njësitë ofruese të rezervës, e cila është në gjendje të ofrojë shërbime balancuese për OST-në.

4.1.2.2 Një OShB i mundshëm (i quajtur gjithashtu kandidat për OShB) duhet të paraqesë në OST sha një aplikim zyrtar së bashku me informacionin e kërkuar të rezervës së mundshme balancuese që ofrojnë njësitë teknike. Brenda 8 javëve nga marrja e aplikimit, OST sha do të **konfirmojë** nëse aplikimi është i plotë. Nëse OST

gjykon se aplikimi nuk është i plotë, brenda 4 javëve nga marrja e kërkesës për informacion shtesë, kandidati për OShB duhet të paraqesë informacionin shtesë të kërkuar. Nëse kandidati për OShB nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati, atëherë aplikimi do të konsiderohet i tërhequr. Brenda 3 muajve pas konfirmimit se aplikimi është i plotë, OST do të vlerësojë informacionin e ofruar dhe do të vendosë nëse njësitë e mundshme të ofrimit të rezervës i plotësojnë kushtet për parakualifikim.¹

4.1.2.3 OST do të verifikojë në parakualifikimin OShB, kapacitetin e OShB për përmbushjen e kërkesave ligjore, informatike-teknike, të komunikimit, organizative dhe financiare. Një kriter i rëndësishëm në mënyrën me vetë-dispeçerim është që OShB duhet të ketë një kontratë me një PPB me njohje të plotë dhe shpërndarja e energjisë balancuese i caktohet portofolit të një PPB. Kandidati OShB duhet të kalojë një test komunikimi administrativ që përfshin të gjitha llojet e shkëmbimit të informacionit mes OShB dhe OST, duke përfshirë mesazhet për ofertim, për pranim, shkëmbimin e sinjaleve të standardizuara ndërmjet pajisjeve në rrjetin kompjuterik për të kontrolluar transferimin e të dhënave, për shlyerje dhe për të provuar qëndrueshmërinë e tij financiare.

4.1.2.4 OST do të kontrollojë portofolin e burimeve gjeneruese të OShB nëse teorikisht OShB mundet apo jo të ofrojë kapacitetin balancues për një produkt të caktuar përgjatë gjithë periudhës kontraktuese siç është deklaruar në aplikim. OShB i parakualifikuar do të marrë emërtimin OShB.

4.1.2.5 Kualifikimi i njësive të OShB ri-vlerësohet:

- a. Në rast se kanë ndryshuar kushtet e disponueshmërisë teknike ose pajisjet;
- b. Në rast se janë modernizuar pajisjet në lidhje me aktivizimin e Rezervës së Energjisë.

Si pasojë, OShB përkatës do të nënshkruajë me OST Marrëveshjen OSB. Marrëveshja OShB përcakton të gjitha Termat dhe Kushtet ndërmjet OShB dhe OST.

4.1.2.6 Nëse vërtetohet se OShB nuk është më në pajtueshmëri me kushtet e procedurës së parakualifikimit, OST do të njoftojë OShB me letër rekomande. Nëse brenda 15 ditëve pune pas marrjes së njoftimit, OShB vazhdon të mbetet në papajtueshmëri me kushtet e parakualifikimit, Marrëveshja e OShB përfundon. Nëse pas përfundimit të Marrëveshjes, OShB dëshiron të ofrojë shërbimin, duhet të ri-aplikojë nëpërmjet Procedurës së Kualifikimit dhe të nënshkruajë një Marrëveshje OShB të re me OST për ofrimin e shërbimit.

¹ Burimi: RREGULLORE E KOMISIONIT (BE) 2017/1485 për krijimin e linjave guidë mbi operimin e sistemeve të transmetimit të energjisë

4.1.2.7 Pas nënshkrimit të Marrëveshjes, OShB dhe OST do të bien dakord për listën e njësive teknike që do të përdoren për të siguruar shërbimin e balancimit. Të gjitha njësitë teknike në listë duhet të kalojnë procesin e parakualifikimit të njësive teknike që vërteton kapacitetin e tyre për të përmbushur kërkesat teknike dhe organizative të përcaktuara nga OST. OShB-të e zgjedhura nuk lejohen të marrin pjesë në ankande pa përfunduar procesin e parakualifikimit të njësive teknike. Parakualifikimi i njësive përfshin:

- a. Përfundimin me sukses të Testit të Komunikimit me SCADA, dhe
- b. Përfundimin me sukses të testeve të parakualifikimit (për Njësitë Teknike që përmbushin kërkesat teknike).

4.1.2.8 Vëllimi i parakualifikuar i Rezervës së Energjisë së njësive teknike mund të jetë i barabartë e shumta me vëllimin maksimal që OShB mund të ofrojë në ankande. Rezultati për një parakualifikim të suksesshëm të njësive është një licencë për njësinë e parakualifikuar.

4.1.2.9 Çdo OShB do të informojë OST, sa më shpejt që të jetë e mundur, për çdo ndryshim në disponueshmërinë ekzistuese të njësive të tij teknike, të rëndësishëm për rezultatet e parakualifikimit.

4.1.2.10 Të gjitha kostot në lidhje me parakualifikimin mbulohen nga kandidati për OShB. Kjo mund të përfshijë të gjitha kostot variabël për demonstrimin si: lëndë djegëse, organizim etj.

4.1.2.11 OShB do t'i ri-nënshtrohet testeve të parakualifikimit nëse OShB:

- a. Parakualifikon njësitë e tij teknike për një Produkt të ri të Shërbimit, me kërkesa të tjera (të FCR, aFRR); ose
- b. Rrit volumin për të cilin është parakualifikuar.

4.1.2.12 Para se të hyjë në ankandin për kapacitet, OShB dhe OST do të nënshkruajnë marrëveshjen kuadër të ankandit, i cili përcakton termat dhe kushtet specifike të ankandit mes OShB dhe OST.

4.1.2.13 Çdo OShB duhet t'i paraqesë OST ofertat e kapacitetit të tij balancues që ndikojnë në një ose më shumë PPB. Secili OShB që merr pjesë në ankandin për kapacitet balancues duhet të paraqesë dhe do të ketë të drejtën të përditësojë ofertat e tij për kapacitet balancues përpara kohës së mbylljes së portës së procesit të prokurimit.

4.1.2.14 Pasi OShB të fitojë ankandin për kapacitet, do të marrë një kontratë për kapacitet si OShB. Kontratat për kapacitet të OShB do të përmbajnë vlerën specifike të kapacitetit rezervë balancues në MW, periudhën e kontraktimit, çmimin e kapacitetit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e detajuara të OShB në fjalë.

4.1.2.15 Çdo OSHB me një kontratë kapaciteti duhet të ofrojë vëllimin e kontraktuar pa kosto për aktivizimin e tij. Ata duhet gjithashtu të ofrojnë vëllime shtesë përtej detyrimit të kontratës për aktivizimin e tyre pa kosto. Çdo OShB pa kontratë kapaciteti mund ta ofrojë dhe aktivizojë atë falas.

4.1.2.16 OShB-të nuk do të transferojnë detyrimet e tyre kontraktuale ndërmjet tyre, si një strategji për të shmangur pagesat e penaliteteve.

4.1.3 PPB

4.1.3.1 PPB është në vetvete një pjesëmarrës tregu ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij që mban përgjegjësi për disbalancat e tij.

4.1.3.2 Të gjitha nominimet nga PPB duhet të jenë në pozicion neto zero. Para kohës së mbylljes së portës ndër-zonale të Tregut Brenda Ditës, çdo PPB mund të ndryshojë skedulet, të nevojshme për të llogaritur pozicionin e saj. PPB do të veprojë sipas nominimit për të shmangur disbalancat, që janë diferenca mes shkëmbimeve të nominuara dhe të realizuara në rrjet. Çdo PPB do të jetë financiarisht përgjegjëse për disbalancat kundrejt OST. PPB ka të drejtë të devijojë nga skedulimet e njësisë vetëm me miratimin e OST pas njoftimit me e-mail të PPB-së, veçanërisht për shkak të sigurisë së rrjetit.

4.1.3.3 PPB, në çdo kohë do të marrë të gjitha masat e mundshme në mënyrë që të veprojë sipas nominimit të tij ose për të ndihmuar në ruajtjen e balancës së sistemit nëpërmjet:

- a. Pozicionit(eve) të injektimit dhe/ose të tërheqjes në Pikat e Lidhjes për të cilat PPB është përgjegjëse në përputhje me Marrëveshjet e Lidhjes respektive;
- b. Pozicionit(eve) të injektimit dhe/ose tërheqjes në rrjetin(at) e shpërndarjes, përveç rrjetit të OST (d.m.th. Pikat e Lidhjes për të cilat PPB është përgjegjëse në përputhje me kontratat respektive që zbatohen në rrjetin(et) e shpërndarjes duke marrë parasysh metodën e alokimit të përdorur nga OSSh);
- c. Nominimin(et) e tij të importit dhe eksportit; dhe
- d. Transfertat e tij të brendëshme të nominimit(eve) të energjisë tek PPB-të e tjera brenda zonës së kontrollit të OST.

4.2 Detyrimet mbi të gjitha Palët e Lidhura

4.2.1 Detyrimi për të siguruar matje të sakta në pikën(at) e caktuar(a) të shkëmbimit me rrjetin ose për të patur një marrëveshje me palën lidhëse (OST ose OSSh) se si këto shkëmbime përcaktohen në mënyrë alternative

4.2.1.1 Palët e Lidhura janë të detyruara të sigurojnë matje të sakta në pikën(at) e caktuar(a) të shkëmbimit siç përshkruhet në Kapitullin VII të Kodit të Transmetimit

(Neni 195, paragrafi 10), si dhe në Kapitullin II të Kodit të Matjes dhe Kodit të Shpërndarjes (Kapitulli 4.6.8) për përdoruesit respektivë të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes.

4.2.2 Detyrimi për të caktuar një Palë Përgjegjëse Balancuese (ose të jetë vetë PPB)

4.2.2.1 Sipas Nenit 99 të Ligjit Nr. 43/2015 Për Sektorin e Energjisë Elektrike, një Palë e Lidhur mund të mbajë vetë përgjegjësinë e balancimit ose mund ta transferojë atë tek një palë e tretë (PPB). Çdo pike lidhje duhet t'i caktohet një PPB, e cila mund të jetë ose vetë pala e lidhur, ose një tjetër PPB. OST mund të mbështetet në Regjistrin e Lidhjes për të identifikuar nëse një Pikë e lidhjes përfaqësohet nga një PPB. Në këtë rast, OST do të alokojë vlerat e matura në këto pika lidhje në përputhje me llogarinë e balancimit të PPB-së respektive.

4.2.2.2 PPB mund të jetë çdo person tjetër fizik ose juridik që plotëson kriteret e PPB të përcaktuara nga OST, duke përfshirë prodhuesit e energjisë elektrike, konsumatorët e mëdhenj, OShB-të, tregtarët etj.

5 BALANCIMI I SISTEMIT

5.1 Specifikimi i masave që duhet të merren nga OST në rastin e disbalancave në sistem

5.1.1 Parandalimi i veprimeve balancuese ndaj veprimeve balancuese nga OST-të e tjerë brenda të njëjtës zonë sinkrone (kompensimi i disbalancave)

5.1.1.1 OST duhet të koordinojë me OST-të fqinjë në mënyrë që të zbatojë një proces të kompesimit të disbalancave me sipas nenit 145 pika 1 të SOGL dhe në përputhje me EBGL, si dhe sipas nismave të ENTSO-E. Kompensimi i disbalancave ndihmon në shmangien e aktivizimit të njëkohëshëm të aFRR dhe/ose mFRR në drejtime të kundërta mes OST-ve të dy zonave të ndryshme LFC.

5.1.1.2 OST do të lidhë marrëveshjet e nevojshme në përputhje me nenin 141 të Kodit të Transmetimit dhe do të implementojë proceset në përputhje me nenin 158 të tij.

5.1.2 Masat dhe rendi në të cilin duhet të zbatohen

5.1.2.1 OST është përgjegjëse për dimensionimin, prokurimin, kontraktimin dhe aktivizimin e shërbimeve balancuese në mënyrë që të ruajë balancën e sistemit. Në rastin e disbalancës së sistemit OST ka të drejtë të aktivizojë shërbimet balancuese nga OShB e kontraktuar, deri në rikthimin e balancës në sistem. Klasifikimi i shërbimeve balancuese përshkruhet në Kapitullin 6, ndërsa procesi i aktivizimit në Kapitullin 10 të këtyre Rregullave TShB.

5.1.2.2 Pasi të jenë shteruar të gjitha ofertat, OST mund të shqyrtojë anulimin e programeve të eksportit për të reduktuar disbalancën e sistemit. OST duhet të hartojë dhe publikojë procedurën për këtë anulim duke marrë në konsideratë nominimet ndërkufitare të PPB-ve të përfshira.

5.1.2.3 Hapi tjetër përshkallëzues në masat balancuese është detyrimi i OShB-ve për të ulur ose rritur rezevën për të cilën OST ka dijëni që ata e disponojnë, por që nuk e kanë ofertuar për çfarëdo lloj arsye. Gjeneruesit në fjalë do të marrin automatikisht çmimin e disbalancës për kontributin e tyre, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së OShB.

5.1.2.4 Si masë të fundit, OST mund të detyrojë çkyçjen e Kërkesës në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit.

5.2 Përgjegjësia e balancimit

5.2.1 Përkufizime

5.2.1.1 Ashtu siç përcaktohet në Nenin 17 të Udhëzuesit Evropian mbi Balancimin e Energjisë Elektrike 2017/2195 (BE), në kohë reale, çdo PPB do të përpiqet të jetë në balancë ose të ndihmojë sistemin të jetë në balancë. Për më tepër, çdo PPB duhet të jetë financiarisht përgjegjëse për disbalancat kundrejt OST lidhëse.

5.2.1.2 Përgjegjësia e balancimit nënkupton detyrimin ligjor mbi palët e lidhura për të dorëzuar skedulimet në lidhje me prodhimin, transmetimin dhe konsumin e energjisë elektrike, sipas kërkesave të specifikuara nga OST dhe OSSh dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat. Programet duhet të përmbajnë shkëmbimet e rrjetit të nominuara në çdo pikë lidhje dhe/ose transaksionet me të gjitha PPB-të e tjera, të ndara si transaksione brenda një zone ofertimi dhe transaksione përgjatë kufirit të një zone ofertimi.

5.2.2 Njohja si PPB

5.2.2.1 Ka dy lloje të njohjes së PPB: PPB me njohje të plotë dhe PPB me njohje tregtare. PPB me njohje të plotë janë ato të cilat mbajnë përgjegjësinë e balancimit në pikat e lidhjes në emër të palëve të lidhura dhe të cilat janë përgjegjëse për tregtimet me PPB-të e tjera. Një palë e privilegjuar e cila nuk mban përgjegjësinë e balancimit për ndonjë Pikë Lidhje, gjithashtu mund të njihet si PPB me njohje të plotë.

5.2.2.2 PPB-të me njohje tregtare janë ato të cilat mbajnë vetëm përgjegjësinë e balancimit mbi transaksionet me PPB-të e tjera. Edhe pse një tregtar nuk ka një pikë lidhje, transferimi i pronësisë së energjisë fizike mund të bëhet përmes nominimit të transaksioneve të cilat do të bëhen vetëm nga një PPB.

5.2.3 Regjistri i Palëve Përgjegjëse Balancuese

5.2.3.1 OST është përgjegjës për regjistrimin e një PPB-je të caktuar në Regjistrin e PPB, i cili publikohet në faqen e internetit të OST ose kudo që konsiderohet e nevojshme nga ERE, dhe Marrëveshjes së PPB të nënshkruar me OST. Marrëveshja e PPB përcakton termat dhe kushtet në marrëdhëniet midis OST dhe PPB-ve.

5.2.3.2 Përgjegjësia e balancimit nuk do të jetë e transferueshme te OST ose OSSh në mënyrë që të shmangët konflikti i interesit me përgjegjësitë e tregut. Përjashtim bën rasti kur PPB përfundon shërbimet e saj pa caktimin në kohë të një pasuesi dhe OST duhet të veprojë përkohësisht si PPB e mundësisë së fundit deri sa të caktohet pasuesi. Në këtë rast:

- a. Përgjegjësia si PPB ndahet midis PPB-ve të mbetura bazuar në Termat dhe Kushtet ndërmejt OST dhe PPB (të cilat mund të jenë proporcionale me kapacitetin total të pikave të lidhjes për të cilat çdo PPB është përgjegjëse).
- b. Ekzekutim i përkohshëm i PPB nga OST (deri sa të përfundojë ndarja); detyrim për informim të OST dhe ERE; kostot përfshihen në tarifë.

5.2.3.3 Me qëllim që të regjistrohet si PPB, PPB duhet të paraqesë në OST një aplikim në formën dhe në përputhje me afatet e specifikuar nga OST.

5.2.3.4 Aplikimi duhet të përfshijë:

- a. Emrin e regjistruar të shoqërisë që aplikon;
- b. Informacionin mbi kontaktin e personit përgjegjës për nënshkrimin e kontratës, për nominimin, për faturat;
- c. Deklaratë noteriale;
- d. Kapacitetin teknik të PPB, i cili mund të paraqitet në formën e një përmbledhje të transaksioneve kryesore të shoqërisë për blerje dhe shitje të enegjisë elektrike gjatë tre viteve të fundit;
- e. Një listë të OST-ve dhe/ose OSSh-ve evropiane për të cilat ato ofrojnë shërbime si PPB, ose në forma të tjera të ngjashme.

5.2.3.5 Për të miratuar aplikimin, OST do të verifikojë që aplikuesi ka ekspertizën e kërkuar dhe pajisjet teknike, administrative dhe organizative të kërkuara për të ekzekutuar të drejtat e tij si PPB duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me nominimet, ofertimet dhe shlyerjen e disbalancave. Për këtë qëllim, më pas OST do të testojë pajisjet për shkëmbimin korrekt të mesazheve elektronike përkatëse. Me tej, OST do të nënshkruajë Marrëveshjen e PPB në të cilën PPB angazhohet të përmbushë detyrimet e saj lidhur me:

- a. Kërkesat e kolateralit, që mund të përmbushen në formën e një garancie bankare, duke u plotësuar në mënyrë opsionale (sipas zgjedhjes së PPB) me një depozitë në OST;
- b. Pagesën e çdo shume të debituar si pasojë e marrëveshjes (p.sh. shumat e shlyerjes së disbalancave)
- c. Kushtet e përfundimit të marrëveshjes.

5.2.3.6 Në rastin e tërheqjes para kohe nga njohja si PPB:

- a. OST do të sigurohet që arsyet për tërheqjen e parakohëshme nuk ekzistojnë më dhe nuk ka dyshim se ato do të përsëriten.
- b. OST do të njoftojë njohjen si PPB dhe do ta publikojë atë në faqen e saj të internetit. Njoftimi duhet të përmbajë emrin, adresën dhe vendin e regjistrimit të PPB dhe llojin e njohjes (të plotë ose tregtare). OST do të informojë PPB përkatëse me e-mail para publikimit.

5.2.3.7 Pas njoftimit të aplikimit të suksesshëm, OST duhet të regjistrojë PPB në Regjistrin e PPB-ve.

5.2.3.8 Marrëveshja e PPB hyn në fuqi një ditë pasi është regjistruar në Regjistrin e PPB-ve. Në këtë Regjistër, OST do të regjistrojë emrat, adresat, numrat e telefonit /faksit dhe llojin e njohjes së të gjitha PPB-ve të njohura si dhe të dhënat përkatëse mbi komunikimin kompjuterik.

5.2.3.9 OST do të informojë PPB për datën e hyrjes në Regjistrin e PPB-ve. Një PPB ka të drejtë të konsultohet me Regjistrin dhe të kërkojë korrigjimin e gabimeve në lidhje me përgjegjësinë e saj të balancimit. OST informon menjëherë të gjitha PPB dhe OSSh për çdo ndryshim në Regjistër.

5.2.3.10 Detyrimi për PPB me njohje të plotë është të mbajë përgjegjësinë e balancimit në pikat e lidhjes ashtu siç përmendet në Regjistrin e Lidhjes. Regjistri i Lidhjes është një listë e organizuar e të gjitha pikave fizike të lidhjes për secilin operator ku është bërë lidhja, d.m.th OST ose OSSh (Hartimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit të Lidhjes është një detyrim i përbashkët i OST dhe OSSh, ndërsa secili prej tyre mban përgjegjësi individualisht për përditësimin e Regjistrit me informacion në lidhje me palët me të cilat kanë lidhur Marrëveshje Lidhje). Në këtë rast, OST mund të mbështetet në Regjistrin e Lidhjes për të caktuar pikat e lidhjes për PPB e caktuar.

5.2.3.11 Njohja si PPB do të konsiderohet e përfunduar menjëherë, me përfundimin e Marrëveshjes së PPB. Në këtë rast, OST do të informojë menjëherë OSSh dhe PPB-të e tjera dhe do të reflektojë ndryshimet në Regjistrin e PPB-ve.

5.3 Procesi i Nominimeve të Energjisë

Procesi i nominimit

5.3.1.1 Të gjitha PPB-të janë të detyruara të dërgojnë nominimin e tyre te OST para mbylljes së portës. Nominimi përfshin të gjitha tregtimet ndër-zonale dhe brenda-zonale si dhe shkëmbimin brenda rrjetit për çdo PShD të ditës së transaksionit.

5.3.1.2 Informacioni i detajuar i kërkuar është specifikuar nga OST dhe dokumentohet në Specifikimin e Rregullave Operative.

5.3.1.3 PPB duhet të ndjekë procesin e nominimit dhe mbylljen e portës përkatëse, të cilat përcaktohen nga OST dhe përshkruhen në Specifikimin e Rregullave Operative.

5.3.1.4 OST duhet të kontrollojë nominimet e PPB-ve sa i përket konsistencës së tyre. Përkufizimi i konsistencës jepet në Specifikimin e Rregullave Operative. Nëse jepet konsistenca e nominimit, PPB do të marrë një miratim nga OST për nominimet e saj ndër-zonale dhe brenda-zonale.

Fall-back

5.3.1.5 Në rast se sistemi i mesazheve elektronike me anë të kutisë qendrore të postës nuk funksionon ose PPB nuk ka përkohësisht akses në sistem, një procedurë emergjence mund të lejojë PPB-të të dorëzojnë nominimet/ri-nominimet me anë të e-mailit, në një format sipas kërkesave që do të përcaktohen nga OST.

5.4 Proçesi i shkëmbimit të të dhënave të matjes

5.4.1 Lidhur me shkëmbimin e të dhënave në kohë reale midis sistemeve SCADA të PPB dhe OST, OST do të përcaktojë një listë të informacionit që do të shkëmbehet. Kjo listë detajohet në Specifikimin e Rregullave Operative.

5.5 Rregullat Operative në lidhje me nominimet dhe shkëmbimin e të dhënave të matjes

5.5.1 Rregullat në lidhje me nominimet

5.5.1.1 Në orën **14:00** të Ditës në Avancë (D-1), PPB duhet të njoftojë në OST Detyrimet e tij të Rezervës së Energjisë. Në ditën D-1, PPB do të vendosë dhe informojë OST mbi kombinimin e njësive teknike që do të sigurojnë Detyrimin e Rezervës së energjisë së tij .

5.5.1.2 PPB do të përdorë *file-n* standart të nominimeve të paracaktuar nga OST. Paraqitja e tij do të bëhet përmes platformës online të dedikuar që do të instalohet nga OST dhe, në rastet e padisponueshmërisë së platformës, me e-mail si një zgjidhje rezervë.

5.5.1.3 Në rastin e ndërprerjes të detyruar, PPB njofton menjëherë OST përmes e-mail-it te personat e kontaktit të Operimit në Kohe Reale dhe Personat e Kontaktit sipas

marrëveshjes me PPB-në. Në këtë rast, PPB paraqet nominimin e ndryshuar për periudhën brenda ditës për njësitë e saj .

5.5.1.4 Për çdo nominim në çdo drejtim, PPB gjithashtu duhet të ofrojë, çmimet e ofertave (në €/MWh) për çdo 15 minuta, sipas specifikohet Kapitullin 9.

5.5.1.5 Pasi kontrollohet vlefshmëria e nominimeve të dërguara në D-1 nga PPB tek OST dhe çdo korigjimi të mundshëm, nominimet e rezervave të marra do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë për koherencën ndërmjet kontratave të tjera të shërbimeve ndihmëse të lidhura ndërmjet OST dhe PPB dhe korigjohen, sipas rastit. Shpeshësia e këtyre nominimeve është 15 minuta. Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 45 minuta para fillimit të 15 minutave të para të përfshira në përditësim.

5.5.1.6 PPB duhet të provojë aftësinë e saj për të dërguar dhe marrë të gjitha mesazhet elektronike të përcaktuara për proceset e ndryshme të punës. Kjo është pjesë e procesit të regjistrimit të PPB-ve. PPB i mohohet regjistrimi (dhe kontrata e mëvonshme) nëse nuk përfundon me sukses testimin e dërgimit të mesazheve.

5.5.1.7 OST dhe OSSh kanë detyrimin të specifikojnë:

- a. Rregullat lidhur me specifikimet e mesazhit për shkëmbimin elektronik të të dhënave,
- b. Procedurat dhe specifikimet për përdorimin e një sistemi qendror për shkëmbimin e mesazheve elektronike;
- c. Protokollet e komunikimit për shkëmbimin e përditshëm të informacionit;
- d. Specifikimet për mesazhet e nominimit dhe të gjitha mesazhet që kanë lidhje me të.

5.5.1.8 OST është **administratori ekskluziv** i sistemit qendror të mesazheve.

Kërkesat mbi përdoruesin e sistemit qendror të mesazheve duhet të jenë të certifikuara nga OST për shkëmbimet elektronike të të dhënave nëpërmjet këtij sistemi.

5.5.1.9 Procedura në rast se përdoruesi shkëmben mesazhe pa certifikatën e kërkuar është:

- a. OST do të dërgojë një paralajmërim që tregon se mesazhi u injorua për shkak të certifikatës së gabuar, duke përmendur gjithashtu se paralajmërimi është regjistruar në OST, duke përmendur në fund rrezikun e heqjes së të drejtës për 2 javë, nëse përdoruesi nuk ka ridërguar një mesazh me certifikatën e saktë brenda këtyre 2 javëve.

- b. paralajmërimi regjistrohet dhe ruhet në OST (mbahet si arsye për procesin e tërheqjes së të drejtave),
- c. Nëse certifikata nuk është marrë brenda 2 javësh nga paralajmërimi i dërguar nga OST, efektivisht kjo do të thotë se nuk mund të paraqiten nominime dhe matje pasi do të konsiderohet si Tërheqje e të Drejtave për përdorimin e sistemit qendror të mesazheve.

5.5.2 Rregullat në lidhje me shkëmbimin e të dhënave të matjes

5.5.2.1 Përpara orës 10:00 të ditës pasuese të punës, Pala Përgjegjëse për Matjen mbledh vlerat e matjes për çdo Pikë Lidhje dhe i dorëzon vlerat paraprake tek OST ose OSSh ku PPB-të lidhen dhe vlerat përfundimtare të konfirmuara brenda 10 ditëve pune pas ditës së operimit.

5.5.2.2 OST dhe OSSh i kombinojnë këto vlera me PPB përgjegjëse për secilën Pikë Lidhje. OSSh përcjell informacionin e matjes për çdo PPB në OST. OSSh gjithashtu përcakton vlerat e matjes të të gjithë konsumatorëve të profilizuar për çdo PPB dhe çdo PShD dhe më pas i përcjell këto vlera në OST.

5.5.2.3 Si përfundim, OST ka për çdo PShD dhe për çdo PPB vlerat e matura në të gjitha Pikat e Lidhjes plus vlerat e matura për klientët e tyre të profilizuar.

5.6 Çmimi i disbalancave

5.6.1 Kostot e prokurimit të kapacitetit rezervë mbarten në tarifë. Çdo rezultat neto për OST nga PPB dhe shlyerja e OShB do të përlllogariten në tarifën e vitit të ardhshëm. Të gjitha kostot e tjera të alokuara për OST për të zhvilluar, operuar dhe mirëmbajtur proceset operative që lidhen me regjistrimin e PPB, ndryshimet, dispozitat e PPB të mundësisë së fundit, shlyerjen e disbalancave si dhe kosto të ngjashme mbulohen nga tarifa.

5.6.2 Nuk ka përjashtime as për detyrimet financiare të PPB dhe as për detyrimin e Palëve të Lidhura për të caktuar një PPB në Pikat e Lidhjes. Secila palë e lidhur dhe secila palë tregtare duhet të caktojë një PPB. Të gjithë PPB-të marrin në ditën pasuese (D + 1) një faturë disbalancash.

5.6.3 Çmimet e energjisë balancuese të OShB paguhen si *pay as cleared*. OShB kompesohet me çmimin e tregut (klingut) i cili është i barabartë me çmimin e ofertës më të shtrenjtë të pranuar (në rast të ofertës së kapacitetit) ose të aktivizuar (në rast të ofertës për energji). Si pasojë, llogaritja e çmimit të disbalancës bazohet në çmimet e energjisë balancuese të OShB. Çmimi i disbalancës për mungesat është gjithmone më i lartë ose i barabartë me çmimin më të lartë të energjisë balancuese për aktivizimin në rritje; çmimi i disbalancës për mungesat është gjithmonë më i ulët ose i barabartë me çmimin më të ulët të energjisë balancuese për aktivizimin në rënie (poshtë). Detaje të tjera përshkruhen në aneksin e këtyre Rregullave TShB.

5.6.4 OST do të publikojë çmimet e përkohshme të disbalancës në ditën pasardhëse të punës dhe çmimet përfundimtare të disbalancës si dhe vëllimet përfundimtare të disbalancës neto, do të publikohen normalisht brenda 10 ditëve pune pas ditës së operimit.

5.7 Kërkesat e kolateralit të PPB

5.7.1 Si kusht pezullues për lidhjen e Marrëveshjes PPB, dhe maksimumi për nënshkrimin e vlefshëm të saj, PPB do t'i japë OST një garanci që përputhet me kushtet për të gjithë afatin e Marrëveshjes PPB si dhe për të gjithë kohëzgjatjen e ekzekutimit të të gjitha detyrimeve financiare që rrjedhin nga pjesëmarrja e saj në tregun e balancimit të energjisë elektrike.

5.7.2 Garancia është një siguri për ekzekutimin e kërkuar dhe të përpiktë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja e PPB në tregun e balancimit të energjisë elektrike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, pagesën për Disbalancat dhe/ose mos-konsistencat e jashtme.

5.7.3 Garancia mund të jetë në formën e një garancie bankare me kërkesën parë të lëshuar paraprakisht nga një institucion financiar ose një pagese në Cash në OST.

5.7.4 Një PPB ka të drejtë të përdorë garanci të ndryshme gjatë kohës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së PPB. Çdo garanci duhet të ketë një afat fillestar prej të paktën një viti kalendarik dhe do të rinovohet në kohë nga PPB, me qëllim që të mbajë sigurinë e kërkuar për të gjithë afatin e Marrëveshjes së PPB dhe për të gjithë kohëzgjatjen e ekzekutimit të të gjitha detyrimeve financiare që rrjedhin nga Marrëveshja.

5.7.5 Në fund dhe/ose në përfundimin e Marrëveshjes së PPB për çfarëdo arsye, OST do ta kthejë garancinë të PPB me kusht që PPB të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e saj që rrjedhin nga Marrëveshja.

5.7.6 Garancitë financiare ndryshojnë në varësi të llojit të PPB:

5.7.6.1 Për PPB-të me njohje tregtare:

- a. Madhësia e kolateralit për një PPB përftohet nga vëllimi në MWh i transaksionit neto më të lartë të asaj PPB me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike;
- b. Për fillimin e zbatimit të këtyre Rregullave TShB, madhësia e kolateralit për një PPB përftohet nga vëllimi i transaksionit neto më i lartë të pritshëm të asaj PPB me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike, me një minimum prej 50 MWh;
- c. Shuma e kolateralit të kërkuar është e barabartë me dyfishin e madhësisë së përmendur në pikën a), ose respektivisht b) e shumëzuar me çmimin mesatar të tregut të energjisë së ditës së mëparshme, gjatë 3 muajve përpara përcaktimit të kolateralit;

- d. Në rast se vëllimi i transaksionit neto më të lartë tejkalon më tepër se shumën në të cilën është bazuar kolaterali, me kërkesën e OST, PPB do të rrisë kolateralin e saj, ku kolaterali i ri bazohet në vëllimin e transaksionit neto më të lartë gjatë një dite kalendarike, të vërejtur gjatë 6 javëve paraardhëse pa ndërprerje. Në rast se vëllimi i transaksionit neto më i lartë është thelbësisht më i ulët se shuma mbi të cilën bazohet kolaterali, me kërkesën e PPB, OST do të lejojë një shumë kolaterali më të ulët, ku kolaterali i ri bazohet në vëllimin e transaksionit neto më të lartë gjatë një dite kalendarike, vërejtur gjatë 6 javëve paraardhëse pa ndërprerje.

5.7.6.2 Për PPB me njohje të plotë

- a. Madhësia e kolateralit për një PPB përftohet nga:
- i. Vëllimi në MWh i transaksionit neto më të lartë të asaj PPB me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike (për herë të parë bazohet në vlerat e pritshme me një minimum prej 50 MWh).
 - ii. Kapaciteti total i transmetimit në pikat e lidhjes për të cilat ai mban përgjegjësinë e balancimit
- b. Shuma e kolateralit të kërkuar është e barabartë me dyfishin e madhësisë së përmendur në a. i, shumëzuar me çmimin mesatar të tregut të energjisë elektrike gjatë 3 muajve para përcaktimit të kolateralit. Kjo është shuma kolaterale A.
- c. Kapaciteti i transmetimit siç është përmendur në pikën a) ii) përcaktohet nga:
- i. Numri i lidhjeve në nivelin 2-10 MW shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel.
 - ii. Numri i lidhjeve në nivelin 11-25 MW shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel
 - iii. Numri i lidhjeve në nivelin 26-50 MW shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel
 - iv. Kapaciteti total i lidhjeve > 50 MW, ku përdoren kapacitetet individuale të lidhjes
- d. Kapaciteti total i transmetimit i përcaktuar në këtë mënyrë shumëzohet me 24, ku përfundimi, nëse është më i vogël se 50 MW rritet në 50 MW, pastaj shumëzohet me çmimin mesatar të tregut gjatë tre muajve para përcaktimit të kolateralit. Kjo është shuma kolaterale B.
- e. Kolaterali që duhet ti vendosët PPB përcaktohet më poshtë:

- i. Nëse $(2 * A) > B$, shuma e kolateralit që do t'i vendoset është $2 * A$
 - ii. Nëse $(2 * A) \leq B$, shuma e kolateralit që do t'i vendoset është $A + B$
- f. Për rregullimin e kërkesave për kolateral, veprohet në të njëjtën mënyrë si me PPB me njohje tregtare (shih paragrafin e mësipërm d) dhe e))

5.8 Faturimi dhe shlyerja për PPB

5.8.1 Faturimi

5.8.1.1 Çdo njoftim pagese i dërguar nga OST te PPB do të përfaqësojë një pagesë të përkohshme, në varësi të zbritjes së një llogarie. Kjo zbritje realizohet në ditën pasuese të punës, në formën e një fature ose të një njoftimi pagese dhe ndërkohë merr parasysh korrigjimet dhe informacionet e dërguara ndërkohë në OST.

5.8.2 Fatura e disbalancave

5.8.2.1 OST do të përcaktojë një llogari fillestare të Disbalancave të PPB për çdo 15 minuta, në ditën pasuese të punës, pasi OST të ketë mbledhur të gjitha nominimet e miratuara për tërheqje dhe injektim për çdo pikë lidhje, për transaksionet e brendshme me PPB të tjera dhe për transaksionet ndër-zonale për çdo kufi zone.

5.8.2.2 Rregullimi në lidhje me llogarinë përfundimtare është i mundur vetëm pasi të dhënat e tërheqjes, injektimit, transaksionet ndër dhe brenda zonale dhe të dhënat e aktivizimit të shërbimeve ndihmëse janë përfundimtare në përputhje me proceset e zbatuara.

5.8.2.3. Fatura dërgohet me bazë ditore.

5.8.3 Afati i pagesës

5.8.3.1 PPB do t'i paguajë OST faturat neto pa zbritje, brenda 7 ditëve nga marrja e tyre, e cila mendohet të jetë 3 ditë pas datës në të cilën janë dërguar.

5.8.3.2 Nëse brenda 10 ditëve nga dërgimi i faturës OST nuk merr pagesën e të gjitha ose disa prej shumave të mbuluara nga faturat, OST do të ketë të drejtën të kërkojë interesin e pagesës së vonuar pa njoftuar. Interesi duhet të paguhet nga dita e dhjetë pas datës në të cilën është dërguar fatura, deri në datën kur ajo është paguar plotësisht. Vlera referuese për interesin është interesi bazë mesatar nga Java e mëparshme W-1 e publikuar nga Banka e Shqipërisë.

5.8.3.3 OST do të dërgojë një njoftim të mospagesës te PPB ndërmjet ditës së 11 dhe 15 pas ditës së lëshimit të faturës. Monedha e përdorur për faturimin dhe shlyerjen është Euro.

5.8.3.4 OST do të ketë të drejtën e tij për kompensimin e kostove ligjore në përputhje me Kodin Civil Shqiptar dhe legjislacionin në fuqi në Shqipëri, përmes të gjitha

procedurave, duke përfshirë ato para gjykatës. Përcaktimet e sipërpërmendura nuk reduktojnë të drejtat e tjera të OST në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe dispozitat në termat dhe kushtet.

5.8.4 Kundërshtimet

5.8.4.1 Çdo kundërshtim në lidhje me faturën, në mënyrë që të jetë i pranueshëm duhet të dërgohet nga PPB në formën e shkresës zyrtare para ditës së 10 pas dërgimit të faturës. PPB do të përshkruajë arsyet për kundërshtimin e saj në mënyrë të kuptueshme dhe në aq detaje sa është e mundur.

5.8.4.2 Një kundërshtim në asnjë mënyrë nuk e çliron PPB nga detyrimi i saj për të paguar faturën.

5.8.4.3 Nëse PPB ka paguar tërësisht një faturë të kontestuar në përputhje me këtë përcaktim dhe duket qartë se kundërshtimi i formuluar në përputhje me këtë përcaktim është i justifikuar, PPB ka të drejtën të kërkojë kthimin e çdo shume të paguar të kontestuar.

5.8.5 Modalitetet për mbledhjen e çdo shume të papaguar

5.8.5.1 Nëse fatura nuk paguhet nga PPB brenda 7 ditëve pas marrjes së njoftimit zyrtar për mospagesë të dërguar nga OST, i cili mendohet të ketë ndodhur 3 ditë pasi është dërguar [10 ditë në total siç referohet në paragrafin 1 të nenit 5.8.3], OST ka të ketë të drejtën të tërheqë garancinë financiare siç përcaktohet në termat dhe kushtet kontraktuale të ankandit, pa cenuar zbatimin e dispozitave të mësipërme. Masat për mbledhjen e shumave të papaguara do të zbatohen nga OST në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri.

5.9 Procesi i ndryshimit të PPB

PPB përfundon shërbimet e saj

5.9.1.1 Palët e Lidhura dhe Furnizuesit e përfshirë do të informohen në kohë dhe do të kenë kohë të mjaftueshme për të gjetur një PPB alternative. Në rast se nuk gjendet në kohë asnjë PPB alternative, do të ketë një PPB të mundësisë së fundit.

5.9.1.2 Një PPB që dëshiron të përfundojë shërbimet e saj duhet të njoftojë, të paktën 30 ditë pune para hyrjes në fuqi, të gjitha Palët e Lidhura ose Furnizuesit e tyre ose të dy (në rast se lidhja është më e madhe se p.sh. 3x80A) dhe OST ose OSSh ku është lidhur, në lidhje me përfundimin e synuar të shërbimeve të saj. OST do të informohet gjithashtu nëse lidhja është në nivelin e OSSh.

5.9.1.3 OST do të reflektojë përfundimin e shërbimit të PPB në Regjistrin e PPB-ve.

5.9.1.4 Palët e Lidhura të përfshira ose Furnizuesi që përfaqëson Palët e Lidhura do të informojnë OST për PPB-në(të) e(të) cila(ët) do të marrë(in) përsipër përgjegjësinë nga PPB që përfundon shërbimet e saj.

5.9.1.5 Në rast se nuk është përcaktuar në kohë pasuesi i PPB në cilindro nga Pikat e Lidhjes në fjalë:

- a. Përgjegjësia e balancimit në Pikat e Lidhjes të përfshira shpërndahet mbi PPB-të e mbetura me njohje të plotë sipas rregullave të specifikuara. Kjo mund të jetë mbi bazën e p.sh. vëllimeve historike në pikat e lidhjes për të cilat ato mbajnë përgjegjësinë e balancimit.
- b. Nëse është e nevojshme, OST merr përkohësisht rolin e PPB në Pikat e Lidhjes të përfshira dhe informon Palët e Lidhura në fjalë dhe ERE sipas rastit (PPB e mundësisë së fundit, shih gjithashtu paragrafin 5.9.3). Kostot e këtij roli të përkohshëm të PPB duhet mbarten në tarifë.

5.9.2 Ndryshimi i PPB-së në një pikë lidhje

5.9.2.1 Brenda 5 ditëve pune para hyrjes në fuqi, një Palë e Lidhur do të informojë OST ose OSSh ku është lidhur, lidhur me një ndryshim të PPB në një ose më shumë nga Pikat e tij të Lidhjes. Ky informacion duhet të shoqërohet me një deklaratë të PPB në fjalë ku ajo pranon këtë përgjegjësi. Nëse kjo deklaratë mungon, OST ose OSSh ku ato lidhen, i mohon transferimin. Përndryshe, transferimi regjistrohet në Regjistrin e Lidhjes.

5.9.3 PPB e mundësisë së fundit

5.9.3.1 Në rast se një PPB përfundon shërbimet e saj pa përcaktimin në kohë të një pasuesi, përgjegjësia e balancimit në Pikat e Lidhjes në fjalë do të ndahet mbi PPB-të e mbetura sipas Termave dhe kushteve ndërmjet OST dhe OShB-ve. Kjo ndarje mund të bazohet në numrin e total të pikave të lidhjes për çdo PPB. OST do të informojë menjëherë PPB-të përkatëse duke përfshirë kohën që ju jepet para se të hyjë në fuqi rialokimi.

5.9.3.2 Do të ketë një PPB të mundësisë së fundit për të marrë përkohësisht detyrat e PPB për aq kohë sa rialokimi i përgjegjësive së balancimit nuk ka hyrë në fuqi. Për momentin ky rol i është dhënë OSSh dhe nuk ka urgjencë për ta ndryshuar këtë para se të fillojë operimin Tregu Shqiptar i Balancimit. Caktimi i OSSh si PPB e mundësisë së fundit mund të rishikohet në të ardhmen nga ERE, kur detyrimi i Shërbimit Publik të furnizimit për OSSh do të reduktohet.

6 PËRKUFIZIME TË PRODUKTIT

6.1 Lista e produkteve

6.1.1 Angazhimi i burimeve për të mbajtur frekuencën e rrejtit në nivelin e pranueshëm, organizohet nëpërmjet katër produkteve balancuese të paraqitura në këtë seksion. OShB është operatori i njësive teknike që ofron cilindo nga këto tre shërbime për rregullimin e frekuencës. Një përmbledhje e shkurtër e informacionit kryesor të rëndësishëm në lidhje me secilin nga produktet paraqitet në tabelën më poshtë:

| Produkti | Dimensi onimi | Vëllimi i kërkuar (indikativ) | Kapaciteti i kontraktuar me bazë | Periudha e kontraktimit | Çmimi i kapacitetit | Çmimi i energjisë balancuese |
|-----------------------|---------------|-------------------------------|----------------------------------|-------------------------|----------------------|--|
| FCR | Po | 6 | Vjetore | 1 vit | <i>Sipas ofertës</i> | ska, energjia e ofruar do të shlyhet si disbalancë |
| aFRR | Po | 45 | Javore | 1 javë | <i>Sipas ofertës</i> | <i>Paguar me çmimin më të ulët të ofruar (aFRR+mFRR)</i> |
| mFRR | Po | 105 | Javore | 1 javë | <i>Sipas ofertës</i> | <i>Paguar me çmimin më të ulët të ofruar (aFRR+mFRR)</i> |
| Rezerva e emergjencës | Jo | N/A | Vjetore | 1 vit | <i>Sipas ofertës</i> | <i>Sipas ofertës</i> |

6.2 Rezervat e mbajtjes së frekuencës (FCR)

(Rezervat Primare)

6.2.1 Rezervat e Mbajtjes së Frekuencës (FCR), të njohura gjithashtu si rezervat e rregullimit primar aktivizohen në rastet e devijimit të frekuencës. FCR janë rezervat operative të nevojshme për mbajtjen konstante të frekuencës nga devijimet nga vlera nominale, me qëllim ruajtjen e balancës së fuqisë së çastit në të gjithë sistemin sinkron të interkonektuar në Evropë. Qëllimi i aktivizimit të FCR është stabilizimi i frekuencës së sistemit sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që të shmangët rritja e disbalancave dhe dalja jashtë kontrollit e sistemit.

6.2.2 FCR aktivizohet në të dy drejtimet si në rritje ashtu dhe ulje. Përkufizimi i përgjithshëm i rregullimit në rritje dhe në ulje për të gjitha produktet balancuese është si më poshtë: Nën-Frekuenca pasqyron situatën, ku injektimet janë më të ulëta se

tërheqjet, në këtë mënyrë nevojitet një injektim shtesë ose tërheqje më e ulët për të balancuar sistemin. Rregullimi në ulje përdoret në rastet e mbi-frekuencës. Mbi-frekuenca nënkupton se injektimet janë më të mëdha se tërheqjet, kështu që nevojiten më pak injektime ose më shumë tërheqje.

6.2.3 Kapacitetet e kontraktuara të FCR-së aktivizohen automatikisht në mënyrë të vazhdueshme nga objektet e ofruesit të shërbimit të balancimit (OShB). Kështu, njësia teknike e ofruesit të shërbimit të balancimit (OShB) duhet të jetë e pajisur me një sistem kontrolli të frekuencës. Sistemi ka për detyrë të dedektojë automatikisht ndryshimet e frekuencës në rrjet dhe të reagojë ndaj këtyre devijimeve duke aktivizuar operimin e FCR-së. FCR duhet të jetë plotësisht e disponueshme gjatë gjithë periudhës së kontraktuar. Për devijimin maksimal të frekuencës, njësia ofruese e FCR duhet që brenda 15 sekondave të aktivizojë gjysmën e kapacitetit të kontraktuar dhe kapacitetin e plotë brenda 30 sekondave. Pas arritjes së kapacitetit të plotë, FCR duhet të qëndrojë e aktivizuar pa-ndërprerje për të paktën 15 minuta konsekuative.

6.3 Rezervat e rivendosjes së frekuencës të aktivizuara automatikisht (aFRR)

(Rezervat Sekondare)

6.3.1 Qëllimi kryesor i aFRR është që të rivendosë balancën në zonën e kontrollit (bllokun e kontrollit LFC) në mënyrë të vazhdueshme dhe automatike, brenda kohës së rivendosjes së frekuencës. Gjithashtu njihet si Rezervë Sekondare. Duke vepruar kështu, aFRR në mënyrë progresive zëvendëson FCR-në e aktivizuar dhe sjell përsëri në vlerën e skeduluar shkëmbimin fizik neto në kufinj të bllokut të kontrollit LFC, bllokuar për reagim primar.

6.3.2 OST dimensionon me bazë vjetore volumin e kapacitetit të aFRR bazuar në metodën e formulës empirike të përcaktimit të madhësisë së aFRR. Metodologjia për dimensionimin e aFRR kryesisht merr parasysh ngarkesën e parashikuar maksimale të sistemit gjatë gjithë vitit.

6.3.3 aFRR-ja aktivizohet automatikisht në drejtimin në rritje ose në drejtimin në ulje në varësi të disbalancës së sistemit (respektivisht mungesë ose tepriçë). Në rast të aktivizimit të aFRR, nga qendra dispeçer e OST transmetohet një sinjal me një tarim të përcaktuar për në qendrën dispeçer të OShB-së, sinjal i cili sjell rritjen ose uljen e fuqisë së injektuar. Procesi i aktivizimit duhet të garantojë aktivizimin e plotë të rezervës sipas tarimit të të dërguar nga OST, brenda 7.5 minutave siç përcaktohet në kërkesat e detajuara.

6.3.4 aFRR operon në qark të mbyllur, duke marrë Gabimin e Kontrollit të Rivendosjes së Frekuencës (FRCE) si të dhënë në hyrje dhe vlerën e tarimit për aktivizimin e aFRR si të dhënë në dalje. FRCE është i barabartë me gabimin e zonës së kontrollit (ACE) i cili përshkruan devijimin mes fuqisë reale të shkëmbyer midis

zonës përkatëse LFC me zonat fqinje LFC dhe shkëmbimit ndërkufitar të skedular për shkak të aktivizimit të kapacitetit të FRR të ndarë mes tyre. Aktivizimi i aFRR synon të çojë në reduktimin e FRCE drejt zeros.

6.3.5 Vlera e tarimit për aktivizimin e aFRR do të llogaritet nga një Rregullator i vetëm për Rivendosjen e Frekuencës, i operuar nga OST brënda zonës së kontrollit LFC. Neni 145 pika 4 i Udhëzuesit Evropian për Operimin e Sistemit të Transmetimit (SOGL) përcakton kërkesat e mëposhtme për rregullatorin e rivendosjes së frekuencës. Ai duhet:

- a. Të jetë një pajisje kontrolli automatike e projektuar për të reduktuar FRCE në zero;
- b. Të ketë karakter proporcional-integral;
- c. Të ketë një algoritëm kontrolli i cili parandalon komponenten integrale të rregullatorit që të akumulojë gabimin e kontrollit dhe mbirregullimin.
- d. Të ketë funksione për modalitete operimi jashtëzakonshme për gjendjen e alarmit dhe emergjencës.

6.3.6 aFRR duhet të jetë e kontrollueshme nga LFC-ja e OST. Për qëllime monitorimi nga të gjitha OShB-të duhet të vihen në dispozicion matjet në kohë reale të fuqisë.

6.3.7 OST duhet të sigurojë disponueshmërinë e minimumit të kapacitetit të kërkuar balancues të aFRR për çdo PShD, nëpërmjet kontratave me OShB-të për të gjitha PShD-të e një peridhe kontraktuese të përcaktuar. Në këtë mënyrë OShB-të angazhohen të ofertojnë për çdo PShD të periudhës së kontraktimit, një vëllim të ofertave për energji të aFRR të paktën të barabartë me sasinë e kapacitetit të kontraktuar të aFRR gjatë procesit të aktivizimit të saj. Palë të tjera gjithashtu mund të ofertojnë kapacitetin e tyre të mbetur në dispozicion në procesin e angazhimit të shpërndarjes së energjisë balancuese të aFRR në bazë vullnetare, nëse zotërojnë njësi të parakualifikuara për ofrimin e aFRR në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga OST. Ofertat për energji balancuese nga aFRR të kontraktuara nuk kanë ndonjë prioritet mbi ofertat vullnetare të energjisë balancuese të aFRR. Radha e aktivizimit të ofertës së aFRR përcaktohet bazuar në ofertën e çmimit të aktivizimit sipas rendit të meritës (nga më i ulëti tek më i larti) .

6.3.8 OShB-të do të paraqesin ofertat e tyre të të energjisë balancuese përmes PPB-së së tyre. Energjia e aktivizuar regjistrohet në portofolin e PPB-së së tyre respektive si një transaksion energjie midis PPB-së dhe OST.

6.3.9 OST mundet, pas një paralajmërimi të dokumentuar, të refuzojë ofertat e energjisë balancuese të aFRR nga një OShB për një periudhë të pakufizuar. Kjo mund të ndodhë kur matja operationale e disponueshme tregon se ky OShB nuk është në gjendje të ndjekë sinjalet e kontrollit të tarimit të aFRR, ose kur mungon sinjali i

matjeve operacionale. OShB mund të krijojë një objekt rregullimi për aFRR duke specifikuar të njëjtin emër të objektit rregullues, për një ofertë në rritje dhe një për ofertë në rënie. Përkufizimi i një objekti rregullues parandalon aktivizimin dhe çaktivizimin e njëkohshëm të ofertës në rritje dhe ofertës në rënie e cila kufizon shpejtësinë totale të rregullimit të kërkuar.

6.4 Rezerva e rivendosjes së frekuencës e aktivizuar manualisht (mFRR)

(Rezerva Terciare, koha e aktivizimit ≤ 15 min.)

6.4.1. Rezervat e mFRR janë rezerva fuqie të cilat aktivizohen manualisht nga prodhues të caktuar të energjisë dhe/ose konsumatorët e mëdhenj industriale të cilët i vënë në dispozicion të OST. Detyra e mFRR është i njëjtë me aFRR. mFRR merr këtu një rol mbështetës për aFRR, në rast se ndodh një disbalancë serioze (e madhe dhe sistematike) jo e zakonshme. Aktivizimi i mFRR preferohet në rast se është më e lirë se aktivizimi i aFRR.

6.4.2 Në lidhje me kërkesat teknike, koha e aktivizimit dhe ç'aktivizimit të kapacitetit të plotë të mFRR nuk mund të jetë më e gjatë se 15 minuta. Ka dy tipe të mFRR:

- a. Rezervë prodhimi, d.m.th. injektimi i fuqisë shtesë në rrjet;
- b. Reduktim konsumi, d.m.th. reduktimi i sasisë së energjisë së tërhequr nga rrjeti nga ana e përdoruesit.

6.4.3 Një OShB që nënshkruan me OST një kontratë angazhimi për disponueshmerinë e mFRR për rezervat e prodhimit, merr përsipër:

- a. T'i sigurojë OST-së gjatë gjithë periudhës së kontraktimit, angazhimin për shpërndarjen e mFRR sipas ofertës, të paktën të barabartë me sasinë e kontraktuar;
- b. T'a shpërndajë produktin në përputhje me kërkesat teknike të tij brenda parametrave të ofertës për të cilën është angazhuar, sipas kërkesës së OST-së për aktivizim. mFRR duhet të ofrohet plotësisht brenda 15 minutave pasi OST e ka kërkuar atë.
- c. OST mund të kërkojë vetëm aktivizimin e rezervave për të cilat është dhënë një ofertë dhe për aq kohë sa është e nevojshme.

6.4.4 Aktivizimi nga OST do të konfirmohet nga prodhuesi duke përdorur një ndërfaqe të instaluar në OST dhe në ambientet e prodhuesit.

6.5 Rezerva zëvendësuese (RR)

(Rezerva Terciare, koha e aktivizimit > 15 min.)

6.5.1 Rezervat Zëvendësuese (RR) janë rezerva të fuqisë aktive të disponueshme për të zëvendësuar njësitë generuese që pësojnë një ndërprerje të detyruar ose që përdoren për qëllime të menaxhimit të kongjestionit. Në sistemet me vetëdispeçerim, RR duhet të aktivizohet ekskluzivisht nga tregu për të recuperuar daljet jashtë pune të njërive gjeneruese. Në përgjithësi kjo kërkon që mbyllja e portave të tregut Brenda Ditës (ID) të jetë sa më afër të jetë e mundur me operimin kohë reale. Në këtë kuptim, RR me kohë të aktivizimit më të gjatë se mbyllja e portës së tregut BrendaDitës nuk duhet të përdoret nga OST për balancimin e sistemit. Kjo mbetet përgjegjësi e tregut.

6.5.2 Shkaku për aktivizimin e RR nga OST duhet në këtë mënyrë të kufizohet në situatat e kongjestionit që kërkojnë menaxhim efikas dhe pro-aktiv, në çdo kohë duke filluar nga mbyllja fillestare e portës së ofertave në D-1 deri në mbylljen finale të portës së ofertave. Aktivizimi i RR bëhet manualisht njëlloj si mFRR. Sipas përkufizimit, koha e aktivizimit të RR është më shumë se 15 minuta. Aktivizimi i RR bëhet manualisht njëlloj si mFRR

6.5.3 RR duhet të ofertohet plotësisht në fillim të Periudhës së Shlyerjes së Disbalancës kur OST e kërkon ose pas kërkesës së OST brenda kohës së plotë të aktivizimit (siç specifikohet në ofertë), cilado kërkesë është bërë e fundit.

6.6 Rezervat e Emergjencës (ER)

6.6.1 Rezervat e emergjencës (ER) janë një lloj i veçantë i mFRR të kontraktuara me anë të menaxhimit të Kërkesës. Rezervat e Emergjencës do të merren parasysh në rast se nuk mund të kontraktohet volumi i mjaftueshëm i mFRR nga asetet e gjenerimit, për të mbuluar kërkesat e dimensionimit dhe/ose si një mbështetje për tregun që ka dështuar të aktivizimin në kohë të rezervave zëvendësuese për ndërprerjet. Rezerva e Emergjencës do të mbahet e ndarë nga aFRR dhe mFRR e tjera dhe do të shfrytëzohen si një lloj i "rezervës së mundësisë së fundit".

6.6.2 ER mund të kontraktohet në bazë vjetore. Kontrata për ER do të përfshijë detyrimet e kapacitetit, çmimin e kapacitetit dhe çmimin e aktivizimit. Ngjashëm me FCR, nuk ka ankand për angazhimin për shpërndarje. Pas kontraktimit vjetor, njësitë e ER-së kanë mundësinë të paraqesin edhe një herë një ofertë në ankandin e kapacitetit, përndryshe ata deklarojnë pa-disponueshmërinë.

6.6.3 ER nuk i nënshtrohen kërkesave të dimensionimit, por ato janë një zëvendësim për mFRR dhe për këtë arsye sasia e kontraktuar do të zvogëlojë sasinë e mFRR për tu kontraktuar.

7 PARAKUALIFIKIMI

7.1 Para hyrjes në tregun balancues, OShB duhet të regjistrohet dhe të marrë certifikatën e parakualifikimit të njërive specifike duke synuar tregtimin e produkteve të veçanta të shërbimit të balancimit. Për më tepër, OShB duhet të caktojë

një PPB, i cili është përgjegjës për të mbajtur të balancuar portofolin e tij të balancimit.

7.2 Si parakusht për të hyrë në ankand, OShB duhet të provojë në parakualifikim aftësinë e njësive të tij teknike për të furnizuar shërbimet balancuese në përputhje me të gjitha kërkesat organizative, komunikuese dhe teknike të përcaktuara dhe të verifikuara nga OST. Procesi i parakualifikimit, kërkesat teknike të detajuara dhe testimi për çdo produkt shërbimi balancues duhet të përcaktohen nga OST dhe të dokumentohen në Specifikimin e Rregullave Operative. OST duhet të publikojë gjithë informacionin në lidhje me parakualifikimin.

7.3 Rezultati i parakualifikimit përcakton nëse njësitet mund të furnizojnë llojin dhe sasinë maksimale të kapacitetit që njësia mund të ofrojë për këtë produkt specifik. OShB duhet të provojë jo vetëm aftësinë e njësive teknike të saj për të garantuar disponueshmërinë e deklaruar përgjatë gjithë periudhës kontraktuese, por gjithashtu aftësinë për të dhënë përgjigjen e kërkuar kur këto njësi teknike janë aktivizuar nga OST për furnizimin e shërbimeve balancuese.

8 PROCESI I ANGAZHIMIT MBI DISPONUESHMËRINË DHE SHPËRNDARJEN

8.1 OST është përgjegjës për prokurimin e kapacitetit balancues në ankandet e angazhimit për disponueshmërinë dhe të mundësisë për aktivizimin e shpërndarjes së energjisë balancuese në ankandin e angazhimit për shpërndarje.

8.2 Për prokurimin e shërbimit të balancimit, OST si Blerës i Vetëm, duhet të zhvillojë procese të standardizuara. Këto procese do të specifikohen nga OST dhe do të dokumentohen në Specifikimin e Rregullave Operative. Përshkrimi i procesit të prokurimit përfshin listën e aktiviteteve që duhet të kryhen nga OST dhe OShB, si dhe specifikimi i çdo aktiviteti dhe kohën e të gjitha aktiviteteve. Të gjithë këto informacione gjithashtu specifikohen në Specifikimin e Rregullave Operative.

8.3 OST duhet të publikojë në faqen e saj të internetit informacionin në lidhje me procesin e prokurimit dhe rezultatet e secilit ankand.

9 PROCESI I AKTIVIZIMIT

9.1 FCR

9.1.1 FCR aktivizohet vazhdimisht duke reaguar ndaj devijimeve të vrojtuar të frekuencës së matur me frekuencën nominale. Niveli standard i frekuencës është 50Hz, por frekuenca mundet të devijojë pak nga kjo vlerë për të korigjuar devijimet e agreguara të frekuencës gjatë kohës (e ashtquajtura frequency time deviation). OST

duhet të informojë OShB-të ofrues të FCR-së për çdo ndryshim kontributut të tyre në FCR në mënyrë që ata të mund të tarojnë kontrollorët e tyre primarë, sipas rastit.

9.1.2 Pas reagimit fillestar, i cili është një veprim i përbashkët i të gjithë ofrueseve të FCR-së në të gjithë sistemin sinkron, frekuenca duhet të kthehet në vleren nominale.

9.2 aFRR

9.2.1 Si një hap tjetër në kontrollin e frekuencës, blloku i kontrollit LFC që shkakton devijimin e frekuencës duhet të rivendosë pozicionin e tij neto (= shuma e flukseve në import minus flukset në eksport, të korigjuara për rregullimin primar) në pozicionin neto të skedular (= shuma importeve të skeduluara minus shumën e eksporteve të skeduluara). Balancimi ndërmjet këtyre dy vlerave është balanca e sistemit. Kjo balancë duhet të rivendoset brenda TTRF (Koha për Rivendosjen e Frekuencës) e cila në sistemin sinkron të Evropës Kontinentale është përcaktuar 15 minuta. Kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet një procesi të koordinuar dhe centralizuar nga OST: me anë të aktivizimit automatik të aFRR nëpërmjet sistemit LFC në kombinim me aktivizimin manual të mFRR me anë të mesazheve elektronike (set point).

9.2.2 OST do të përpiqet të minimizojë kostot totale të aktivizimit të rezervave, për të rivendosur balancën e sistemit. Prandaj duhet të marrë vendimet e mëposhtme:

- a. Sa nga ofertat e ofruara për FRR do të përdoren për aktivizimin automatik të LFC?
- b. Në çfarë kushtesh duhet rritur aFRR në LFC ose kur duhet aktivizuar mFRR në vend të saj?

Procedura konkrete përcaktohet si më poshtë:

- a. **Procesi i nominimit**, duke dhënë për përzgjedhje dhe aktivizim ofertat e aFRR të vendosura si më të lirë, të paktën deri në vëllimin e kërkuar të LFC. Ky nominim bëhet për çdo PShD menjëherë pas mbylljes së portës për ofertim. OShB-të e përfshira informohen se ofertat e tyre janë nominuar për rregullimin LFC. Në rast se do të përzgjidhen dhe aktivizohen të gjitha ofertat e nominuara/pranuara, dhe pritët që disbalanca do të vazhdojë, ka dy mundësi nga të cilat operatori duhet të zgjedhë më optimalen, duke marrë parasysh vëllimin e aktivizuar, kohëzgjatjen e pritshme të disbalancës, cilësinë e kërkuar të kontrollit të balancës dhe kostot respektive:
 - i. Nominohen dhe shtohen në LFC më shumë oferta për aFRR ; ose
 - ii. Aktivizohen ofertat e mFRR (me çmim oferte sipas *rendit të meritës*) me qëllim që të zëvendësohet aFRR e aktivizuar

Parimisht, nëse ofertat e mFRR janë më të lira dhe ekziston mundësia që kjo disbalancë të vazhdojë për PShD aktuale dhe atë në vijim, mundësia (ii) do të preferohet krahasuar me mundësinë (i),

b. **Procesi i përzgjedhjes**, ky është një algoritëm automatik brenda LFC që përzgjedh nga ofertat e nominuara, aq oferta sa nevojiten me çmimin sipas *rendit të meritës* për t'u aktivizuar në paralel me qëllim që të arrihet përgjigja e kërkuar. Ky proces operon në dy drejtime: përzgjidhen më shumë oferta nëse nevojitet më shumë reagim, përzgjidhen më pak oferta nëse nevojitet më pak reagim.

c. **Procesi i aktivizimit:**

- i. Të gjitha ofertat e përzgjedhura aktivizohen paralelisht (pro-rata);
- ii. Ofertat që aktivizohen nga LFC në një PShD, por nuk janë më të disponueshme ose janë përzgjedhur për PShD pasardhëse, vendosen në zero duke respektuar shpejtësinë e rregullimit që ishte specifikuar. Megjithëse kjo krijon energji balancuese të aktivizuar për atë ofertë në PShD-në pasuese, oferta të tilla nuk do të ndikojnë në çmimin e aktivizimit në PShD-në pasardhëse.
- iii. Kërkesa për sasinë e energjisë së aFRR monitorohet vazhdimisht nga LFC kombëtare për çdo cikël të LFC dhe ky informacion regjistrohet për çdo ofertë dhe për çdo 5 min për qëllime të shlyerjes. Çdo OShB (ose PPB-ja e tij) gjithashtu pritët të regjistrojë energjinë e aktivizuar nga OST me qëllim lehtësimin e kontrollit në informacionin e shkëmbyer.

9.2.3 Një sasi standarde e aFRR së ofruar nominohet me Cmim sipas *rendit të meritës*, të barabartë me kërkesat e dimensionimit, për secilën PShD. Kjo është e mjaftueshme për të rregulluar gabimet në disbalancë.

9.2.4 Përveç kësaj, mund të nominohen gjithashtu ofertat për aFRR deri në 100% të vëllimit kërkesës së dimensionyuar për mFRR, deri sa ofertat e nominuara të aFRR bëhen më të shtrenjta se oferta më e lirë e mFRR.

9.2.5 Kriteri i përzgjedhjes për përzgjedhjen e ofertave nga LFC është shpejtësia e disponueshme (ramp) e rregullimit nga ofertat e përzgjedhura kundrejt shpejtësisë së kërkuar të rregullimit siç kërkohet nga LFC. Nëse kjo është më e lartë, ofertat përzgjidhen në drejtim të kundërt sipas *rendit të meritës* së çmimit. Nëse kjo është më e ulët, ofertat përzgjidhen sipas *rendit të meritës* së çmimit.

9.2.6 Kur gjatë një periudhe të caktuar kohore janë aktivizuar ofertat në LFC që janë më të shtrenjta se oferta tjetër e disponueshme në rangun e ofertës së mFRR, nëse

operatori i sistemit gjykon që rreziku i mbi-aktivizimit është minimal, aktivizohet oferta e mFRR.

Shihni specifikimet e **procesit të nominimit** në Specifikimin e Rregullave Operative.

9.3 mFRR/RR me kohë aktivizimi ≤ 30 min.

9.3.1 Ofertat e mFRR përdoren për disbalanca të mëdha dhe/ose që pritet të zgjatin në kohë. Fillimisht OST zbulon humbjen në shkallë të gjerë të prodhimit ose ngarkesës nga gradienti i rritjes së disbalances e krahasueshme me madhësinë e ndërprerjes. OST gjithashtu mund të marrë informacion nga pjesëmarrësi përkatës tregut mbi një vlerësim të shkallës në të cilën dhe kohën në të cilën, pasojat e ndërprejes priten të elimonhen nga vete pjesëmarrësi i tregut. Paralelisht, disbalanca do të zvogelohet automatikisht nga LFC me anë të aFRR në dispozicion. Nëse aFRR-ja e mbetur në dispozicion bie poshtë një pragu të caktuar dhe prishmëria është që incidenti të vazhdojë me gjatë se sa disa PShD, atëherë mFRR do të aktivizohet manualisht nga OST derisa aFRR e mjaftueshme të vihet në dispozicion për shkak të veprimeve korigjuese të pjesëmarrësve të tregut. Gjithashtu çmimi i aktivizimit mund të jetë një arsye për të aktivizuar mFRR kur është më i lirë se sa aktivizimi i aFRR më gjatë. Ofertat e mFRR aktivizohen për një periudhë minimale të një PShD të plotë dhe gjithmonë në madhësinë e plotë të ofertës.

9.4 Rezervat e Emergjencës

9.4.1 Në rast të rezervave të emergjencës së kontraktuara, ato do të aktivizohen vetëm pas paraqitjes së një mesazhi urgjent të tregut se ekziston një rrezik në rritje i aktivizimit të rezervave të emergjencës, përveç rasteve kur sigurohen më shumë oferta të mFRR në rritje. Ky mesazh mundet tashmë të transmetohet në ditën paraardhëse, pas mbylljes së portës të ditës paraardhëse për ofertimin e rezervave nëse ofertat e aFRR dhe mFRR në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar kërkesat e dimensionimit.

9.5 Rezerva Zëvendësuese me kohë aktivizimi > 30 min.

9.5.1 Çdo ofertë për rezerva të aktivizuara manualisht me kohë aktivizimi më të madhe se 30 minuta do të kategorizohet si "oferta për qëllime të tjera". OST do të aktivizojë keto oferta vetëm për rastet e kongestionit dhe menaxhimit të sigurisë të rrjetit. Kjo kërkon që këto oferta të kenë gjithashtu një gjeotag (*vendodhja e paraqitur elektronikisht*).

9.5.2 Nëse këto oferta janë aktivizuar, ata do të marrin për kompensimin e kostove të aktivizimit, çmimin më të lartë të ofertës dhe çmimin e energjisë balancuese, por nuk duhet të vendosin çmimin e energjisë balancuese. Kështu ata do të cilësohen si të aktivizuara për qëllime të tjera. Çdo ofertë e aktivizuar në drejtim të kundërt për të mbajtur balancën nuk do të cilësohet dhe mund të shlyhet si çdo ofertë tjetër balancuese (*paguar me çmimin më të ulët të ofruar*).

10 FATURIMI DHE SHLYERJA PËR OShB

10.1 Për çdo vëllim të angazhimit mbi disponueshmërinë të dhënë, OShB do të marrë një konfirmim të kërkesë/ofertës duke deklaruar numrin e kërkesë/ofertës së blerjes dhe kompensimet për Kapacitetin Rezervë të kontraktuar (rezervimi).

10.2 Përmes një platforme të përbashkët ose mjete tjetër të miratuar, OST do t'i ofrojë OShB pas çdo dite pasuese të punës pas ditës së operimit, një raport lidhur me të dhënat dhe monitorimin e disponueshmërisë së kapacitetit balancues dhe shpërndarjen e energjisë balancuese në ditën e mëparshme. Një raport javor përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë përmban shumën e të gjitha kompensimeve për kapacitetet e kontraktuara dhe energjitë e aktivizuara. Pjesa e dytë përmban të gjitha reduktimet e kompensimeve të llogaritura nga OST, duke treguar gjithashtu metodën e llogaritjes dhe të gjitha të dhënat mbi të cilat bazohet llogaritja.

10.3 Nëse më pas duket se llogaritja e reduktimit të kompensimit është (janë) e (të) pasaktë, pala e parë do të informojë palën tjetër për të ndërmarrë veprime sa më shpejt që të jetë e mundur. Palët do të përpiqen pastaj të arrijnë një zgjidhje miqësore. Në mungesë të saj, do të zbatohet procedura e paracaktuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve e përcaktuare në Seksionin 3.3.4.

10.4 Brenda tri ditëve pune pas përfundimit të një jave (që përfundon të dielën), OShB mbledh vlerat nga raportet ditore dhe dërgon në departamentin e shlyerjes të OST faturën *pro-forma* javore të tij për kapacitetin balancues të kontraktuar dhe energjinë balancuese të shpërndarë.

10.5 Brenda 5 ditëve pune pas marrjes së faturës *pro-forma*, OST do të pranojë ose refuzojë atë. Në përputhje me faturën *pro-forma*, fatura mund të dërgohet në Departamentin e Faturimit & Pagesave vetëm pasi OST të ketë aprovuar faturën *pro-forma*.

11 MENAXHIMI I KONGJESTIONEVE TË BRENDSHME

11.1 OST do të ketë detyrimin që ofertat me kohë aktivizimi më të gjatë se 30 minuta, t'i përdorë vetëm për menaxhimin e kongjestionit.

11.2 OST do të ketë të drejtën të kufizojë lirinë e transaksioneve të Palëve të Lidhura (ose PPB-të e tyre) në rast të mundësisë për përsëritje të kongjestionit (p.sh. refuzohet ndryshimi i nominimeve që përfshijnë pikat e lidhjes në zonën me kongjestion në një drejtim që rrit kongjestionin). OST duhet të informojë PPB-të e Palëve të Lidhura respektive sipas rastit.

11.3 Procedurat operative për menaxhimin e kongjestionëve të brendshme do të kryhen si më poshtë:

- a. OST ose OSSh duhet të deklarojnë zonën e konxhestionit (një zonë konxhestioni që do të përcaktohet p.sh. nga grupi i kodeve EIC të pikave të lidhjes respektive). Ndryshimet e nominimeve që përfshijnë pikat e lidhjes në zonën me konxhestion në drejtimin që rrit konxhestionin do të refuzohen. Nuk lejohen më tej transaksionet jashtë zonës nëse janë arritur limitet e eksportit të zonës dhe nuk lejohen më tej transaksionet brenda zonës nëse janë arritur limitet e importit të zonës. Prandaj OST do të refuzojë nominimet e transaksioneve të tilla.
- b. OShB-të brenda një zone të deklaruar kongjestioni janë të detyruara të ofrojnë tek OST rezerva në rritje ose rënie për menaxhimin e kongjestionit të brendshëm. OST mund të caktojë nivelin e pragut të kapaciteteve të njësishë teknike që bien nën këtë detyrim, p.sh. ta ulin nëse nuk janë marrë oferta të mjaftueshme.
- c. OST do të aktivizojë oferta energjie kundër-balancuese jashtë zonës me kongjestion në rastin e aktivizimit të ofertave brenda zonës me kongjestion, për të menaxhuar kongjestionin e brendshëm.

11.4 Për shlyerjen e disbalancave në një zonë të deklaruar me kongjestion, OST mund të përcaktojë një regjim të ndryshëm të shlyerjes që parandalon nxitjen e stimujve të keq-qëllimshëm në mosdhënien e ofertave të aktivizuara në zonën me kongjestion, për të lehtësuar kongjestionin. OST duhet të publikojë rregullat e një regjimi të tillë si pjesë e Specifikimit të Rregullave Operative të balancimit.

12 ANEKSET

12.1 Modeli i Marrëveshjes së OShB (në një dokument të veçantë)

12.2 Modeli i Marrëveshjes së PPB (në një dokument të veçantë)

12.3 Specifikime të Rregullave të Operimit (në një dokument të veçantë)

12.4 Përcaktimi i çmimeve të disbalancave

1. Përkufizime
 - 1.1. Rregullimi në rritje
 - 1.2. Rregullimi në ulje
 - 1.3. Çmimi për energjinë balancuese në rritje
 - 1.4. Çmimi për energjinë balancuese në ulje
 - 1.5. Komponentja nxitëse
 - 1.6. Gjendja e rregullimit(e sistemit)
 - 1.7. Delta e balancës: autorizimi për disbalancat e sistemit për tu publikuar në kohëreale nga OST (open loop ACE)
 - 1.8. Çmimi mesatar: përkufizimi i çmimit të energjisë balancuese në rastin pa rregullim
2. Specifikimi i gjendjeve të rregullimit(për secilën PShD)
 - 2.1. Gjendja e rregullimit=0 nuk kërkohet as rregullim në rritje dhe as në ulje
 - 2.2. Gjendja e rregullimit=+1: kërkohet vetëm rregullim në rritje
 - 2.3. Gjendja e rregullimit=-1: kërkohet vetëm rregullim në ulje
 - 2.4. Gjendja e rregullimit=+1: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme
 - 2.5. Gjendja e rregullimit=-1: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme
 - 2.6. Gjendja e rregullimit = 2:kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës nuk ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme as jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme.
 - 2.7. Gjendja e rregullimit = 2: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme dhe jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme.
3. Specifikimi i çmimeve të disbalancës
 - 3.1. Çmimi i disbalancës në rast segjendja e rregullimit =-1 (tepricë në sistem)
 - a) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në ulje plus komponenten nxitëse.Në këtë rast PPB paguan OST.
 - b) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në ulje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
 - 3.2. Çmimi i disbalancës në rast segjendja e rregullimit =+1(sistemi ka mungesë)
 - a) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në rritje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.

- b) Nëse disbalanca e PPB ka të beje me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në rritje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
- 3.3. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = 2 (disbalance e dyanshme e sistemit)
- a) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), dhe çmimi mesatar është më i lartë se sa çmimi për energjinë balancuese në rritje, çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin mesatar plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- b) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë) dhe çmimi mesatar është më i ulët sesa çmimi për energjinë balancuese në rënie, çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin mesatar minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
- c) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë) dhe mid-price nuk është më i lartë se sa çmimi për energjinë balancuese në rritje, çmimi i disbalancës është i barabartë çmimin për energjinë balancuese në rritje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- d) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë) dhe çmimi mesatar nuk është më i ulët se sa çmimi për energjinë balancuese në ulje, çmimi i disbalancës është i barabartë çmimin për energjinë balancuese në ulje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
- 3.4. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = 0 (pa rregullim)
- a) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin mesatar plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- b) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin mesatar minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
- 3.5. Komponentja nxitëse
- a) Vlera fillestare: €0/MWh
- b) Rregullimet e komponentes nxitëse
- 3.5.b.1. OST do të rregullojë komponentën nxitëse në bazë të kritereve objektive sipas një procedure të përcaktuar dhe të publikuar nga OST në faqen zyrtare.
- 3.5.b.2. Vlera aktuale e komponentes nxitëse do të publikohet në faqen zyrtare të OST.
- 3.5.b.3. ERE ka të drejtën t'i kërkojë OST të përfshijë në Rregullat e TShB, procedurën për rregullimin e komponentes nxitëse.
- 3.6. Neutraliteti i kostove të OST në balancim

- a) OST do të korigjojë tarifën e transmetimit për vitin pasues bazuar në rezultatet neto të shlyerjeve të:
 - 3.6.a.1. Disbalancat me PPB-të
 - 3.6.a.2. Kostot e kontraktimit dhe aktivizimit të rezervave balancuese
 - 3.6.a.3. Proceset e balancimit ndër-kufitar duke përfshirë programet e kompesimit për shkëmbimet e paqëllimshme
- 3.7. Kompensimi për pagesën e komponentes nxitëse
- a) Në rast se disbalanca e PPB shkaktohet nga një ngjarje në rrjet ose nga ndërhyrja e OST ose OSSh, PPB merr kompensim për pagesat në lidhje me komponenten nxitëse. Shembuj të këtyre ngjarjeve janë (jo-shteruese):
 - 3.7.a.1. Shkarkimi automatik ose manual i ngarkesës nga OST ose OSSh
 - 3.7.a.2. Rritja ose ulja e detyruar e shkëmbim në rrjet nga OST ose OSSh.
 - b) Kompensimi do të paguhet nga operatori i rrjetit në rrjetin e të cilit ka ndodhur ngjarja.

(Identifikimi i shoqërisë)

OST
Personi i kontaktit në OST
Adresa

Data:

Projekti:“Shërbime dytësore - OST”

Subjekti: **Deklaratë**

Unë, (*Emri*), (*funksioni*), në zotërim të kompetencave të nevojshme për të përfaqësuar (e mri i shoqërisë) deklaroj nën përgjegjësinë time:

- (*emri i shoqërisë*) nuk është në gjendje falimentimi ose paaftësie paguese, nuk ka pezulluar veprimtarinë e saj ekonomike dhe nuk ka një vendim gjykate, as ndonjë situatë të ngjashme si pasojë e procedurave ekzistuese sipas ligjeve kombëtare dhe / ose rregulloreve në shtetin e origjinës (*emri i shtetit*);
- (*emri i shoqërisë*) nuk ka aplikuar për falimentin dhe as nuk është në procedurë paaftësie paguese, dhe shoqëria nuk është subjekt i procedurave të ngjashme ekzistuese sipas ligjeve kombëtare dhe / ose rregulloreve në shtetin e origjinës (*emri i shtetit*);
- (*emri i shoqërisë*) nuk është dënuar për vepra që lidhen me sjelljen profesionale nga një gjykim që ka fuqinë e *res judicata*;
- (*emri i shoqërisë*) nuk është shpallur fajtor për faj të rëndë profesional të provuar me çfarëdolloj mjete që mund të justifikohet nga autoriteti kontraktor;
- (*emri i shoqërisë*) ka përmbushur të gjitha detyrimet për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore në përputhje me ligjet e shtetit të origjinës ose në përputhje me ligjet e shtetit të autoritetit kontraktor;
- (*emri i shoqërisë*) ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagesën e taksave në përputhje me ligjet e shtetit të origjinës ose në përputhje me ligjet e shtetit të autoritetit kontraktor;
- (*emri i shoqërisë*) nuk është fajtor për mashtrim të rëndë në dhënien e informacionit të kërkuar në këtë dokument;
- (*emri i shoqërisë*) respekton të gjitha ligjet e zbatueshme (edhe nëse dhe kur ato amendohen) dhe në veçanti ligjin në lidhje me mirëqënien e punonjësve në vendin e punës (ligji i 4 gushtit 1996) si edhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga dekreti mbretëror i datës 25 Janar 2001 (në lidhje me kantieret e ndërtimit të përkohshme ose të lëvizshme) të ndryshuar me dekret mbretëror i datës 19 Dhjetor 2001 (në lidhje me trajnimin shtesë të koordinatorëve në fushën e sigurisë dhe shëndetit)

(*emri i shoqërisë*)

Firma (*emri*)(*adresa*)(*funksioni*)

INFORMACION I OShB mbi personat përgjegjës për çështje të tregtisë dhe shlyerjes

1 Detaje të kontaktit për nominimet OShB:

1.1 Kontaktet / shërbimet që do të marrin njoftime me email në lidhje me nominimet OShB dhe / ose duhet të kontaktohen me telefon gjatë orëve të punës:

| Emri dhe mbiemri ise emri i shërbimit (max. 5) | Numri (at) e telefonit / adresa(t) e emailit | |
|---|---|--|
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |

| | | |
|--|----------------|--|
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |

1.2 Detajet e kontaktit për nominimet 24 orëshe të OShB (të disponueshëm 24 orë në ditë, dhe me njohuri të përshtatshme për specifikimet dhe kushtet e emërimeve OShB)

| Emri dhe mbiemri ise emri i shërbimit (max. 5) | Numri (at) e telefonit / adresa(t) e emailit | |
|--|--|--|
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |

1.3 Detaje të kontaktit për fatura

| Faturimi¹ | |
|--|--|
| 1. Shoqëria të cilës do ti faturohet | |
| Emri i shoqërisë dhe forma ligjore | |
| Numri i NIPT | |
| Numri i shoqërisë | |
| Adresa e selisë ligjore | |
| 2. Detaje për dërgimin e faturave | |
| a. Detaje të shoqërisë | |
| Emri i shoqërisë dhe forma ligjore | |
| Numri i NIPT | |
| Numri i shoqërisë | |
| Adresa e selisë ligjore | |
| b. Adresa në të cilën dërgohen faturat | |
| Adresa në të cilën dërgohen faturat: | |
| c. Personi i kontaktit për faturimin | |
| Pozicioni: | z. / znj. (fshijeni sipas rastit) |
| Emri dhe mbiemri² | |
| Gjuha: | Shqip / Anglisht (fshijeni sipas rastit) |
| Tel.: | |
| E-mail: | |

¹Detajet në qeliza gri do të përfshihen në faturë, ndërsa detajet e tjera nevojiten për menaxhimin e saktë të shoqërive në bazën tonë të të dhënave.

²Emri i personit të kontaktit do të përfshihet në faturë, por jo në adresën në të cilin do të dërgohet fatura

INFORMACION I PPB mbi personat përgjegjës për çështje të tregtisë dhe shlyerjes

1 Detaje të kontaktit për emërimet PPB:

1.1 Kontaktet / shërbimet që do të marrin njoftime me email në lidhje me emërimet PPB dhe / ose duhet të kontaktohen me telefon gjatë orëve të punës:

| Emri dhe mbiemri ise emri i shërbimit (max. 5) | Numri (at) e telefonit / adresa(t) e emailit | |
|---|---|--|
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |

| | | |
|--|----------------|--|
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |

1.2 Detajet e kontaktit për emërimet 24 orëshe të PPB (të disponueshëm 24 orë në ditë, dhe me njohuri të përshtatshme për specifikimet dhe kushtet e emërimeve PPB)

| Emri dhe mbiemri ise emri i shërbimit (max. 5) | Numri (at) e telefonit / adresa(t) e emailit | |
|--|--|--|
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |

1.3 Detaje të kontaktit për fatura

| Faturimi ¹ | |
|---|--|
| 1. Shoqëria të cilës do ti faturohet | |
| Emri i shoqërisë dhe forma ligjore | |
| Numri i NIPT | |
| Numri i shoqërisë | |
| Adresa e selisë ligjore | |
| 2. Detaje për dërgimin e faturave | |
| a. Detaje të shoqërisë | |
| Emri i shoqërisë dhe forma ligjore | |
| Numri i NIPT | |
| Numri i shoqërisë | |
| Adresa e selisë ligjore | |
| b. Adresa në të cilën dërgohen faturat | |
| Adresa në të cilën dërgohen faturat: | |
| c. Personi i kontaktit për faturimin | |
| Pozicioni: | z. / znj. (fshijeni sipas rastit) |
| Emri dhe mbiemri ² | |
| Gjuha: | Shqip / Anglisht (fshijeni sipas rastit) |
| Tel.: | |
| E-mail: | |

¹Detajet në qeliza gri do të përfshihen në faturë, ndërsa detajet e tjera nevojiten për menaxhimin e saktë të shoqërive në bazën tonë të të dhënave.

²Emri i personit të kontaktit do të përfshihet në faturë, por jo në adresën në të cilin do të dërgohet fatura

Kërkesë për Kontratë Pala Përgjegjëse për Balancimin

Me qëllim të mundësojmë lidhjen e një kontrate PPB, duhet të paraqitet një kërkesë tek OST. Të dhënat e mëposhtme janë të nevojshme për përpilimin e kontratës PPB.

Ju ftojme të informoni OST për gjuhën e versionit zyrtar të kontratës suaj duke shënuar në kutinë përkatëse në vijim (versioni ANG i kontratës është vetëm për qëllime informimi):

SHQ

ANG

1. Detaje të shoqërisë që nënshkruan kontratën

| | |
|------------------------------------|--|
| Emri i shoqërisë dhe forma ligjore | |
| Kodi EIC ¹ : | |
| Kodi GLN ² : | |
| Ligji i zbatueshëm: | |
| Adresa e selisë ligjore: | |
| Nr. I shoqërisë: | |
| Nr. NIPT.: | |

2. Detaje të personit që nënshkruan kontratën

| | |
|--|--|
| Pozicioni: | z. / znj. (fshijeni sipas rastit) |
| Nënshkrimi 1 (emri dhe mbiemri): | |
| Gjuha ³ : | Shqip / Anglisht (fshijeni sipas rastit) |
| Pozicioni i nënshkruesit ¹⁴ : | |
| Pozicioni: | z. / znj. (fshijeni sipas rastit) |

¹Një kod EIC kërkohet për të mundësuar emërimin si PPB. Në rast se njësi kërkuese nuk ka ende një kod EIC, kërkesa në fjalë për kontratë PPB duhet të paraqitet OST së bashku me kërkesën për një kod EIC (formular elektronik është i disponueshëm në faqen e internetit të OST). Nëse pala kërkuese disponon një kod ndërkombëtar EIC të regjistruar në shtetet fqinje dhe të deklaruar në Entso-e au mund ta përdorë atë për emërimet e tij në Belgjikë.

²Kodi GLN (Numri Global i Lokalizimit) kërkohet vetëm në rastet e emërimeve zyrtare. Për këtë, ju lutemi të indikoni një kod të vetëm GLN, i cili duhet të jetë i njëjti me atë me të cilin shoqëria njihet nga operatorët e sistemit të shpërndarjes.

³Gjuha e preferuar për komunikime individuale

⁴Një nënshkrues është i mjaftueshëm për OST, nënshkruesi i dytë është opsional

| | |
|----------------------------------|--|
| Nënshkrimi 1 (emri dhe mbiemri): | |
| Gjuha ² : | Shqip / Anglisht (fshijeni sipas rastit) |
| Pozicioni i nënshkruesit 2: | |

3. *Detaje kontakti për aspektet kontraktuale:*

| Personi i kontaktit 1 për aspekte kontraktuale ⁵ | |
|---|--|
| Title: | Mr. / Mrs. (delete as appropriate) |
| First name and surname: | |
| Language ² : | Albanian / English (delete as appropriate) |
| Address ⁶ : | |
| Tel.: | |
| Tel. (mobile): | |
| E-mail: | |

| Contact person 2 for contractual aspects | |
|--|--|
| Pozicioni: | z. / znj. (fshijeni sipas rastit) |
| Emri dhe mbiemri | |
| Gjuha ² : | Shqip / Anglisht (fshijeni sipas rastit) |
| Adresa: | |
| Tel.: | |
| Tel. (mobile): | |
| E-mail: | |

⁵Fusha e numrit të telefonit dhe adresës së emailit të personit të parë të kontaktit do të indikohen në listën e PPB-ve në faqen e internetit të OST

⁶Nëse adresa nuk indikohet, OST do të supozojë se adresa personale është e njëjtë me adresën e selisë ligjore

4. Detaje kontakti për nominimet:

4.1. Kontaktet / shërbimet që do të marrin njoftime me email në lidhje me nominimet PPB dhe / ose duhet të kontaktohen me telefon gjatë orëve të punës:

| Emri dhe mbiemri ose emri i shërbimit (max. 5) | Numri (at) e telefonit / adresa(t) e emailit | |
|---|--|--|
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |

4.2 Detajet e kontaktit për nominimet 24 orëshe të PPB (të disponueshëm 24 orë në ditë, dhe me njohuri të përshtatshme për specifikimet dhe kushtet e nominimeve PPB)

| Emri dhe mbiemri ose emri i shërbimit (max. 5) | Numri (at) e telefonit / adresa(t) e emailit | |
|---|--|--|
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |
| | Tel.: | |
| | Tel. (mobile): | |
| | E-mail: | |

5. Detaje të kontaktit për fatura

| Faturimi ⁷ | |
|---|--|
| 1. Shoqëria të cilës do ti faturohet | |
| Emri i shoqërisë dhe forma ligjore | |
| Numri i NIPT | |
| Numri i shoqërisë | |
| Adresa e selisë ligjore | |
| 2. Detaje për dërgimin e faturave | |
| a. Detaje të shoqërisë | |
| Emri i shoqërisë dhe forma ligjore | |
| Numri i NIPT | |
| Numri i shoqërisë | |
| Adresa e selisë ligjore | |
| b. Adresa në të cilën dërgohen faturat | |
| Adresa në të cilën dërgohen faturat: | |
| c. Personi i kontaktit për faturimin | |
| Pozicioni: | z. / znj. (fshijeni sipas rastit) |
| Emri dhe mbiemri ⁸ | |
| Gjuha: | Shqip / Anglisht (fshijeni sipas rastit) |
| Tel.: | |
| E-mail: | |

Shënime:

- a) Nëse kërkohet faturimi elektronik atëherë duhet të plotësohet "Pranimi i Faturave elektronike" (shih pikën 8). Në këtë rast, të gjitha faturat e lidhura me subjektin e faturuar do të dërgohen në mënyrë elektronike.
- b) Të gjitha faturat dhe kontratat tuaja do të konsultohen me anë të portalit të OST Customer Hub; nëse kërkohet akses në Customer Hub duhet të plotësohet formulari i aplikimit për kërkesën për akses në Customer Hub të OST-së (shih pikën 9).

⁷Detajet në qeliza gri do të përfshihen në faturë, ndërsa detajet e tjera nevojiten për menaxhimin e saktë të shoqërive në bazën tonë të të dhënave.

⁸Emri i personit të kontaktit do të përfshihet në faturë, por jo në adresën në të cilin do të dërgohet fatura

- C) Procesi i konvalidimit të anekseve të Kontratës së Aksesit mund të bëhet në mënyrë elektronike me anë të portalit Customer Hub, për këtë qëllim ne kemi nevojë për të dhënat e përfshira në pikën 9, sidomos për plotësimin e rolit të "Vlerësuesit". Megjithatë është i mundur edhe konvalidimi elektronik, nëse të gjitha palët e bëjnë këtë

6. Elementet vijuese duhet të jepen së bashku me këtë formular:

- Deklaratë në përputhje me modelin e dhënë nga OST, llogaritë për kapacitetet financiare të shoqërisë dhe sjellja profesionale.
- Kapaciteti teknik (elektriciteti):
 - ***Një përmbledhje të transaksioneve kryesore të blerjeve dhe shitjeve të energjisë elektrike në tre vitet e kaluara;***
 - ***Një listë e OST dhe OSSH Evropiane për të cilat ju jeni palë përgjegjëse e balancimit (PPB).***

Ju lutemi vini re se kontrata PPB do të jetë e vlefshme vetëm me kushtin që të përmbushet kërkesa paraprake në lidhje me garancinë financiare sipas aneksit 2. Vini re gjithashtu se shuma e garancisë është e ndryshueshme dhe varet nga pozicioni i PPB sipas dispozitave të Aneksit 2.

7. Deklaratë – tekst standard

OST SYSTEM OPERATOR
(emri)
Marrëdhëniet me Klientin

(Identifikimi i shoqërisë)

Datë:

Projekti : (emri i shërbimit)

Subjekti: **Deklaratë**

Unë, (Emri), (funksioni), në zotërim të kompetencave të nevojshme për të përfaqësuar (emri i shoqërisë) deklaroj nën përgjegjësinë time:

- (emri i shoqërisë) nuk është në gjendje falimentimi ose paaftësie paguese, nuk ka pezulluar veprimtarinë e saj ekonomike dhe nuk ka një vendim gjykate, as ndonjë situatë të ngjashme si pasojë e procedurave ekzistuese sipas ligjeve kombëtare dhe / ose rregulloreve në shtetin e origjinës (emri i shtetit);
- (emri i shoqërisë) nuk ka aplikuar për falimentin dhe as nuk është në procedurë paaftësie paguese, dhe shoqëria nuk është subjekt i procedurave të ngjashme ekzistuese sipas ligjeve kombëtare dhe / ose rregulloreve në shtetin e origjinës (emri i shtetit);
- (emri i shoqërisë) nuk është dënuar për vepra që lidhen me sjelljen profesionale nga një gjykim që ka fuqinë e *res judicata*;
- (emri i shoqërisë) nuk është shpallur fajtor për faj të rëndë profesional të provuar me çfarëdolloj mjeti që mund të justifikohet nga autoriteti kontraktor;
- (emri i shoqërisë) ka përmbushur të gjitha detyrimet për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore në përputhje me ligjet e shtetit të origjinës ose në përputhje me ligjet e shtetit të autoritetit kontraktor;
- (emri i shoqërisë) ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagesën e taksave në përputhje me ligjet e shtetit të origjinës ose në përputhje me ligjet e shtetit të autoritetit kontraktor;
- (emri i shoqërisë) nuk është fajtor për mashtrim të rëndë në dhënien e informacionit të kërkuar në këtë dokument;
- (emri i shoqërisë) ka të gjitha sigurimet e nevojshme për të realizuar shërbimet përkatëse.

(emri i shoqërisë)

(data)

Nënshkrimi (emri)(adresa)(funksioni)

8. Pranimi i faturave elektronike nga OST.

Faturimi elektronik është efektiv vetëm pas nënshkrimit të këtij aplikimi / formulari për e-faturim i cili rendit kushtet për e-faturimin.

| | |
|-----------------------------------|--|
| Shoqëria | |
| Numër NIPT | |
| Numri i klientit OST ⁹ | |
| Adresa e e-mail për e-faturimin | |
| Përfaqësuar nga | |

Konfirmon në këtë dokument se është dakord të marrë fatura elektronike me kushtet vijuese:

- Do të dërgohet një email në adresën e e-mailit të dhënë më sipër, i cili përmban faturën në formatin PDF duke përfshirë një format xml.
- Fatura duhet të përmbajë firmë elektronike.
- Rreshti i subjektit të emailit duhet të përmbajë "Fatura e Grupit OST 32xxxxxxx i datës xx/xx/xxxx".
- Emri i PDF duhet të përmbajë "Fatura PDF 32xxxxxxx".
- PDF origjinale duhet të dërgohet nga noreply_invoice_ar@OST.be.
- Nuk duhet të dërgohen anekse me faturën; megjithatë, anekset do të jenë të disponueshme në Customer Hub.
- Nëse adresa e emailit të dhënë që nuk punojnë më, OST do të vihet në kontakt me personin e kontaktit të përcaktuar më sipër. Nëse ne nuk kemi një adresë të re e-maili brenda tre ditësh, fatura do të dërgohet me postë.
- Kjo marrëveshje do të jetë në fuqi për një afat të pacaktuar.
- Secila palë mund të përfundojë këtë marrëveshje me anë të letrës rekomande.
- Përfundimi si më sipër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit vijues, duke llogaritur 30 ditë pas datës së dërgimit të letrës rekomande. Përfundimi nuk ndryshon detyrimet respektive të palëve në lidhje me administrimin.

Kjo marrëveshje zbatohet në të gjitha lidhjet e vlefshme, pikat e aksesit, PPB, pajisjet matëse ose ndonjë marrëveshje tjetër në lidhje me të cilën OST lëshon fatura ndaj shoqërisë të përmendur më sipër. Shoqëria autorizon OST të amendojë anekset përkatëse të këtyre kontratave (p.sh. pjesët ku përmendet e-faturimi) në bazë të informacionit të dhënë më sipër.

Nënshkrimi

Data

⁹Ky është kodi unik i identifikimit të shoqërisë tuaj në OST. Ai konsiston në 3 deri në 5 karaktere të kontratës suaj. Ju lutemi të kontaktoni kontaktin e shoqërisë suaj për aspektet kontraktuale nëse nuk i dini referencat e kontrave që ka aktualisht shoqëria juaj

9. Deklarimi i kompensimit të detyrimeve

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST

(emri)

Marrëdhëniet me Klientin

Data:

Projekti: (emri i shërbimit)

Subjekti: **Deklarimi i kompensimit**

Unë, (emri), (funksioni), në zotërim të kompetencave të nevojshme për të përfaqësuar (emri i shoqërisë) deklaroj se une jam dakord mbi rakordimin e debive reciproke me OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) dhe se pozicionet neto do të llogariten duke zbritur debinë më të vogël nga ajo më e madhe për çdo periudhë kompensimi.

Nënshkrimi

Data

10. Kërkesë për akses në OST Customer Hub (një faqe për peson)

| | |
|---|--|
| Emri i shoqërisë: | |
| <p>Company CCN (Numri i Kontratës së Shoqërisë):</p> <p>Ky është një kod unik identifikimi i shoqërisë suaj në OST.</p> <p>Ai konsiston në 3 deri në 5 karaktere të kontratës suaj. Ju lutemi të kontaktoni kontaktin e shoqërisë suaj për aspektet kontraktuale nëse nuk i dini referencat e kontrave që ka aktualisht shoqëria juaj</p> <p>p.sh. referenca e kontratës B-456-15 => CCN = 456 U-456-15-01 => CCN = 456 C-456-001 => CCN = 456</p> | |
| <p>Roli i konvalidimit</p> <p>Ju lutemi specifikoni për cilën lloj kontrate ose rol në treg duhet të ketë rolin e konvalidimit përdoruesi.</p> <p>ACH = Kontratë aksesi BRP = Kontratë i Palës Përgjegjëse të Aksesit GU = Kontrata e Lidhjes</p> | |
| <p>Aksesi Standard:</p> <p>Ju lutemi specifikoni për cilën lloj kontrate përdoruesi duhet të ketë akses standard. (nuk është e aplikueshme për furnitorët)</p> <p>BSP = Kontratë e Ofruesit të Shërbimit të Balancimit BRP = Kontratë e Palës Përgjegjëse të Balancimit GU = Kontrata e Lidhjes</p> | |
| <p>Gjuha e preferuar e korrespondencës:</p> <p>Shqip / Anglisht</p> | |
| <p>Z. znj.</p> | |
| Emri | |
| Mbiemri | |
| Funksioni | |
| Telefoni | |
| Celular (opsional) | |
| <p>Email i përdoruesit të vetëm</p> <p>Ju lutemi të specifikoni vetëm emailin për përdoruesin e vetëm të ID së përdoruesit të kërkuar. Konfirmimi i krijimit të ID së përdoruesit dhe çdo komunikim i mëtejshëm rreth ID së përdoruesit (p.sh. email kujtesë për skadencë, email me link në rast të harresës së</p> | |

| | |
|--|--|
| fjalëkalimit) do të dërgohen në këtë adresë email. | |
|--|--|

MARRËVESHJA e Ofruesit të Shërbimit të Balancimit

Nr. /

Sot më,.....2019, në Tiranë, nënshkruar midis Palëve:

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a., një shoqëri e regjistruar në [**Adresa**], me NIPT [**numrin e regjistrimit**] dhe i licencuar për operimin e sistemit të transmetimit me licencën nr.[**numri i licencës**] përfaqësuar nga _____ - Administratori, në vijim i referuar si **OST**;

Dhe

2. [**emri i kompanisë OShB**], një shoqëri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të [**Shteti**], me zyrën e saj të regjistruar në [**Adresa, Qyteti, Shteti**] dhe e regjistruar në regjistrin tregtar [**qytetin**] me numrin [**numrin e regjistrimit**] dhe numër të TVSH-së [**numri i ID të TVSH-së**] përfaqësuar ngaAdministrator, referuar në vijim si **Ofrues i Shërbimit të Balancimit (OSHB)**.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. OST si mbajtës i licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë, organizon tregun balancues për energjinë elektrike.
2. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje të Ofruesit të Shërbimit të Balancimit (në vijim referuar si "Marrëveshja"), OSHB siguron të drejtën për të kryer transaksione në tregun e balancimit të energjisë elektrike, të cilat do të jenë objekt i faturimit dhe pagesave.
3. Të drejtat dhe detyrimet e OSHB, duke iu referuar pjesëmarrjes së tij në Tregun Shqiptar të Balancimit, janë parashikuar në Rregullat e TShB dhe Aneksat e këtyre rregullave, si dhe në legjislacionin përkatës në fuqi dhe vendimet e ERE-s.
4. OSHB në vijim pranon të jetë i lidhur nga kjo Marrëveshje që konsiderohet si pjesë e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit.
5. Termat dhe afatet e përcaktuara në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit janë përfshirë edhe në këtë marrëveshje. Në rast të konfliktit midis Rregullave të Tregut Shqiptar të

Balancimit dhe kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojnë Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit.

6. OSHB pranon që Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit miratohen nga ERE dhe se ERE do të ketë të drejtë të imponojë dispozitat e këtyre rregullave mbi OSHB siç parashikohet në to.

II. TERMAT DHE KUSHTET E MARRËVESHJES

7. OSHB është përzgjedhur për të kryer aktivitete në përputhje me këtë Marrëveshje, bazuar në procedurën e hapur dhe transparente të parakualifikimit të kryer nga OST, në përputhje me Nenin 4.1.2 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit.
8. Kërkesat e përcaktuara nga OST si kushte për parakualifikimin e OSHB-së, sipas Rregullave të TShB si: aftësitë ligjore, tekniko-informative, komunikuese, organizative, aftësia financiare e OSHB, si dhe portofoli i OSHB-së, duhet të përmbushen nga OSHB gjatë gjithë kohëzgjatjes të kësaj Marrëveshjeje.
9. OST do të verifikojë portofolin e burimeve gjeneruese të OSHB-së nëse teorikisht OSHB mundet të sigurojë kapacitetin balancues për një produkt të caktuar gjatë gjithë periudhës së kontraktuar.
10. Kualifikimi i njërive të OSHB-së mund të ri-vlerësohet nga OST në rastin e: ndryshimeve të kërkesave teknike ose të disponueshmërisë ose nëse ka ndryshuar pajisjet, ose në rast të modernizimit të pajisjeve që lidhen me aktivizimin e Rezervës së Energjisë Balancuese.
11. Në përputhje me dispozitat e Rregullave të TShB, OST rezervon të drejtën për të përshtatur prodhimin e OSHB-së sipas nevojës. OSHB-të kanë të drejtë të marrin kompensim për këtë shërbim të aktivizuar në mënyrë të veçantë. Për këtë qëllim, OST lëshon një njoftim pagese për çdo PShD duke specifikuar sasinë e matur që i korrespondon shërbimit dhe çmimin përkatës të shlyerjes së disbalancës.
- 12.

III. MBIKËQYRJA NGA OST, PEZULLIMI

13. Nëse gjatë zbatimit të Marrëveshjes, OSHB nuk i përmbush më kushtet e parakualifikimit, OST do të njoftojë OSHB përmes një shkrese zyrtare për papajtueshmërinë.
14. Nëse OSHB nuk i përgjigjet shkresës zyrtare brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas marrjes së njoftimit ose nuk merr masat përkatëse, OST mund ta pezullojë Marrëveshjen për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh.

15. Pas periudhës së pezullimit, OST vlerëson përsëri pajtueshmërinë e OSHB me kushtet. Nëse është rivendosur pajtueshmëria, pezullimi anulohet. Nëse jo, Marrëveshja me OSHB përfundon. Kjo nënkupton që pas përfundimit të Marrëveshjes, nëse PPB dëshiron të ofrojë shërbimin, duhet të ri-aplikojë nëpërmjet procedurës së parakualifikimit dhe të nënshkruajë një Marrëveshje të re me OST, në pajtim me kushtet përkatëse sipas Rregullave të TShB.

IV. DEKLARIME

Deklarime nga OSHB

16. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, OSHB i garanton OST që:
- a. Janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për autorizimin e duhur, siç kërkohet nga Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit, dhe
 - b. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje, të plotësuar nga Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit nuk cenon: ndonjë ligj, rregull, rregullore, marrëveshje ose dokument të detyrueshëm ose të zbatueshëm për OSHB.
17. OSHB pranon se ka detyrimin ta njoftojë menjëherë OST në rast të çdo pa-pajtueshmërisë ose shkeljes së detyrimeve kontraktuale në këtë marrëveshje.

Deklarime nga OST

18. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, OST i garanton OSHB që:
- a. Janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për autorizimin e duhur, siç kërkohet nga Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit, dhe
 - b. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje, të plotësuar nga Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit nuk cenon: ndonjë ligj, rregull, rregullore, marrëveshje ose dokument të detyrueshëm ose të zbatueshëm për OSHB.

V. KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

19. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy Palët dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në përfundimin nga secila Palë në përputhje me Seksionin III dhe Seksionin VIII.

VI. KONFIDENCIALITETI

20. OST garanton që asnjë palë e tretë nuk do të ketë qasje ose të marrë informacione për çështjet që kanë të bëjnë me biznesin ose çështjet personale të OSHB, të cilat rrjedhin nga transaksionet e kryera nga OSHB në tregun e balancimit. OST nuk do ta përdorë këtë

informacion për qëllime të tjera përveç atyre që lidhen me aktivitetin e OST në transaksionet në tregun e balancimit.

21. OSHB do të garantojë që asnjë palë e tretë nuk do të ketë qasje ose të marrë informacion konfidencial në lidhje me aktivitetin, biznesin, konsumatorët, klientët ose furnizuesit e OST.
22. Detyrimi i konfidencialitetit nuk ka të bëjë me informacionin, që është ose është bërë publik, jo për shkak të shkeljes së detyrimeve të konfidencialitetit sipas kësaj Marrëveshjeje.
23. Detyrimi i konfidencialitetit nuk e kufizon OST për të paraqitur informacion tek ERE ose ku dhe kur kërkohet me ligj.
24. OSHB pranon të drejtën e pronësisë së OST në informacionin tregtar si dhe të drejtën e tij për të vepruar në përputhje me kushtet dhe kërkesat e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit.

VII. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

25. Në rast të mosmarrëveshjes në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët e Marrëveshjes do të bëjnë përpjekjet më të mira për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre në mënyrë miqësore, nëpërmjet negocimit. Në rast se Palët nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen përmes negocimit, Pala/Palët mund të paraqesin mosmarrëveshjen e tyre në ERE në përputhje me Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror (Bordi i ERE-s vendimi nr 114, datë 8.7.2016).
26. Në rast se mosmarrëveshja midis Palëve lidhet me interpretimin e Kodit të Transmetimit, Palët e kësaj Marrëveshjeje do të bëjnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Transmetimit, si edhe të zbatojnë Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve.
27. Në rastin e mos-pëlqimit të vendimit të ERE, çdo Palë në Marrëveshjeje ka të drejtë të çojë çështjen për zgjidhje në gjykatën kompetente në Tiranë.

VIII. AMENDIMI I MARRËVESHJES

28. Kjo Marrëveshje është pjesë përbërëse e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe si e tillë miratohet nga ERE. Amendimet e kësaj marrëveshjeje kërkojnë miratimin e ERE.
29. OST mund të propozojë ndryshime në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit në përputhje me kushtet e përcaktuara në to.
30. Çdo amendim i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit ndikon drejtpërsëdrejti te Palët në këtë Marrëveshjeje.

IX. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

31. Secila nga palët mund ta përfundojë këtë Marrëveshje pas një njoftimi me shkrim, në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit.
32. Përfundimi i përkohshëm ose përfundimtar i Marrëveshjes për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga njëra Palë rregullohet nga Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit.

X. NDASHMËRIA

33. Pavlefshmëria e ndonjë prej klauzolave të Marrëveshjes nuk çon në pavlefshmërinë e ndonjë klauzole tjetër ose të marrëveshjes në tërësi.

XI. ZBATIMI I LIGJIT

34. Çdo pretendim, mosmarrëveshje ose diferenca që mund të lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo çështje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e saj, do të zgjidhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
35. Secila Palë heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose më vonë lidhur me seancat e zhvilluara në gjykatat shqiptare dhe gjithashtu pranon që vendimi i marrë në gjykatat shqiptare do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët.

NË DËSHMI TË KËSAJ MARRËVESHJE, secila Palë ka bërë të mundur që përfaqësuesi i saj i autorizuar të zbatojë këtë marrëveshje, e cila është në fuqi që nga data e nënshkrimit nga të dy Palët.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale, dy (2) në gjuhën angleze dhe dy (2) në gjuhën shqipe dhe secila Palë mban dy (2), një (1) për çdo gjuhë.

Për dhe në emër të OSHB

Nënshkrimi

Emri dhe Titulli (me shkronja shtypi)

Datë:

Për dhe në emër të OST sh.a

Nënshkrimi

Emri dhe Titulli (me shkronja shtypi)

Datë:

Aplikimet, pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje:

1. Informacion rreth personave përgjegjës për tregtimin dhe shlyerjen në emër të OSHB dhe PPB së tij.
2. Kolaterali fillestar.
3. Deklarata për kompensimin e detyrimeve.
4. Deklarata për pëlqimin për marrjen e faturave elektronike.

Shënim:

Marrëveshja nënshkruhet nga përfaqësuesi i OSHB në përputhje me certifikatën për regjistrim të dorëzuar në procesin e regjistrimit. OST mund të kërkojë informacion shtesë në rast se OSHB nuk është regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të paraqesë certifikatën e nevojshme të regjistrimit.

SPECIFIKIMI I RREGULLAVE OPERACIONALE

Drafti final 17.10.18

| | |
|-------------------|---|
| Përmbajtja | |
| 1 | QËLLIMI.....4 |
| 2 | BALANCIMI I SISTEMIT4 |
| 2.1 | Proçesi i Nominimit të Energjisë4 |
| 2.1.1 | Proçesi i nominimit4 |
| 2.1.2 | Mbylljet e portës së nominimit7 |
| 2.1.3 | Proçesi i komunikimit - palët dhe mesazhet7 |
| 2.1.4 | Nominimet <i>ex-ante</i>7 |
| 2.1.5 | Nominimet <i>ex-post</i>7 |
| 2.1.6 | Fall-back7 |
| 2.2 | Proçesi i shkëmbimit të të dhënave të matjes.....7 |
| 2.3 | Llogaritja e çmimit të disbalancës.....8 |
| 2.3.1 | Përkufizime10 |
| 2.3.2 | Specifikimi i gjendjeve të rregullimit (për secilën PShD).....8 |
| 2.3.3 | Specifikimi i çmimeve të disbalancës.....11 |
| 3 | KUALIFIKIMI10 |
| 3.1 | Proçesi i parakualifikimit10 |
| 3.1.1 | Furnizuesi i shërbimeve balancuese.....10 |
| 3.1.2 | Input10 |
| 3.1.3 | Proçesi.....11 |
| 3.1.4 | Rezultati12 |
| 3.2 | Kualifikimi i ofruesit të FCR15 |
| 3.2.1 | Kriteret teknik12 |
| 3.2.2 | Testet e parakualifikimit14 |
| 3.2.3 | Testi i Profilit Sintetik të Frekuencës (SFC).....14 |
| 3.2.4 | Testet e frekuencës në kohë reale16 |
| 3.2.5 | Llogaritja e FCR_{max}17 |
| 3.3 | Kualifikimi i ofruesit të aFRR.....17 |
| 3.3.1 | Kriteri teknik.....17 |
| 3.3.2 | Testi e parakualifikimit18 |
| 3.4 | Kualifikimi i ofruesit të mFRR/RR.....19 |

| | | |
|-------|---|----|
| 3.4.1 | Kriteret teknike | 19 |
| 3.4.2 | Testi i parakualifikimit..... | 19 |
| 3.5 | Kualifikimi i ofruesit të ER..... | 20 |
| 3.5.1 | Kriteret teknike | 20 |
| 3.5.2 | Testi i Parakualifikimit | 21 |
| 3.6 | Fall-back..... | 21 |
| 4 | PROÇESI I ANGAZHIMIT PËR DISPONUESHMËRI..... | 21 |
| 4.1 | Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe proçesi i ndryshimeve..... | 21 |
| 4.2 | Dimensionimi dhe madhësia | 22 |
| 4.2.1 | FCR..... | 22 |
| 4.2.2 | aFRR | 22 |
| 4.2.3 | mFRR..... | 23 |
| 4.2.4 | RR | 23 |
| 4.2.5 | Rezervat e emergjencës..... | 23 |
| 4.3 | Proçesi i ofertimit | 23 |
| 4.4 | Proçesi i përzgjedhjes..... | 24 |
| 4.5 | Përcaktimi i çmimeve..... | 24 |
| 4.6 | Publikimi i rezultateve | 24 |
| 4.7 | Afatet..... | 24 |
| 4.8 | Fall-backs | 25 |
| 5 | PROÇESI I ANGAZHIMIT PËR SHPËRNDARJE..... | 26 |
| 5.1 | Specifikimi i ofertës | 26 |
| 5.1.1 | Kategoritë e ofertës | 26 |
| 5.1.2 | Struktura e një mesazhi të ofertës së angazhimit për shpërndarje | 26 |
| 5.1.3 | Karakteristikat e një mesazhi oferte..... | 26 |
| 5.1.4 | Karakteristikat e një oferte të angazhimit për shpërndarje | 27 |
| 5.1.5 | Karakteristikat e rreshtit të ofertës së angazhimit për shpërndarje | 28 |
| 5.1.6 | Aspektet alternative të karakteristikave | 28 |
| 5.2 | Mbyllja e portës së ofertimit | 29 |
| 5.2.1 | Para ditës së shpërndarjes | 29 |
| 5.2.2 | Gjatë ditës së shpërndarjes..... | 29 |

| | | |
|-----|-------------------------------|----|
| 5.3 | Publikimi i rezultateve | 29 |
| 5.4 | Afatet..... | 30 |

1 QËLLIMI

1.1 Ky dokument është një dokument plotësues i cili i bashkëngjitet Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit. Qëllimi i këtij dokumenti është të shpjegojë të gjithë proceset që zbatohen në Tregun e Balancimit, bazuar në përshkrimin e detajuar të veprimeve të aktivitetit, specifikimeve të aktiviteteve si dhe kohën e çdo aktiviteti.

2 BALANCIMI I SISTEMIT

2.1 Proçesi i Nominimit të Energjisë

2.1.1 Proçesi i nominimit

2.1.1.1 Furnizuesi: PPB-të

- a. Informacioni hyrës: tregtimet ndër-kufitare, p.sh për çdo PShD të ditës së transaksionit
 - i. PPB nominuese;
 - ii. Numri i kontratës së të drejtave të kapacitetit ndër-kufitar të alokuar;
 - iii. Zona e ofertimit fqinje;
 - iv. PPB e nominuar (d.m.th PPB e huaj, duhet të njihet si PPB nga OST fqinje);
 - v. Vëllimi i të drejtave të kapacitetit të nominuar për transaksionin respektiv;
 - vi. Drejtimi i nominimit

- b. Tregtimet brenda-vendit, p.sh për secilën PShD të tregtimit në ditën e transaksionit
 - i. PPB nominuese (çdo PPB me njohje tregtare ose të plotë);
 - ii. PPB e nominuar (çdo PPB me njohje tregtare ose të plotë);
 - iii. Energjia e transferuar;
 - iv. Drejtimi i transferimit të energjisë;

- c. Shkëmbimet brenda-vendit të rrjetit
 - i. PPB nominuese (vetëm me njohje të plotë)

- ii. Dita e nominimit
- iii. Për çdo Pikë Lidhje dhe PShD
 - iii.1 PShD
 - iii.2 Kodi EIC i pikës së lidhjes
 - iii.3 Vëllimi i nominuar i shkëmbimit në rrjet
- iv.1 Drejtimi i vëllimit të nominuar të shkëmbimit në rrjet

2.1.1.2 Proçesi: (shënim: të gjitha kohët janë me orën lokale në Shqipëri)

- a. PPB-të që zotërojnë të drejtat afatgjata të transmetimit, paraqesin transaksionet që ato dëshirojnë të bëjnë duke përdorur këto të drejta jo më vonë se ora 9.00 para ditës së transaksioneve. Kjo do të bëhet përmes një mesazhi elektronik standart.
- b. Në rast se një PPB humbet një afat për nominimin afatgjatë të kapacitetit, OST nuk do të pranohet asnjë nominim ndër-kufitar që përdor këto të drejta kapaciteti.
- c. OST informon tregun për nominimet e pranuar ndërkufitare të të drejtave afatgjata të kapaciteteve të alokuara dhe kapacitetin ndërkufitar të mbetur në dispozicion për tregun e përbashkët të ditës në avancë jo më vonë se ora **xxh:00** (Për t'u plotësuar nga OST, zakonisht të paktën 1 orë para hapjes së portës së tregut të ditës në avancë)
- d. Të gjitha nominimet afatgjata dhe të ditës në avancë si dhe të gjitha nominimet brenda-vendit që rezultojnë nga tregu i ditës në avancë do të paraqiten para orës 14:00 të ditës para ditës së transaksionit.
- e. Kërkesat e miratimit të nominimeve të energjisë nga një PPB:
 - i. OST mund të refuzojë miratimin e një nominimi nëse nuk ka konsistencë të brendëshme ose të jashtme.
 - i.1. Konsistenca e brendëshme nënkupton:
 - i.1.1. Për një PPB me njohje të plotë:

Për çdo PShD, tërheqjet e nominuara të rrjetit plus shitjet e nominuara të PPB-të e tjera, plus eksportet e nominuara janë të barabarta me injektimet e nominuara të rrjetit, plus blerjet e nominuara nga PPB-të e tjera plus importet e nominuara.
 - i.1.2. Për një PPB me njohje tregtare:

Për çdo PShD, shitjet e nominuara te PPB-të e tjera plus eksportet e nominuara janë të barabarta me blerjet e nominuara nga PPB-të e tjera plus importet e nominuara

i.2. Konsistenca e jashtme nënkupton që:

Të gjitha informacionet mbi një transaksion janë në konsistence me çdo informacion mbi të njëjtin transaksion nga PPB-të e tjera respektive.

Për transaksionin ndër-kufitar kjo nënkupton se OST do të kontrollojë konsistencën e jashtme me OST fqinje respektive: PPB-të në të dy anët duhet të kenë nominuar të njëjtën sasi, por në drejtim të kundërt.

Në rast të konflikteve në konsistencat e jashtme të transaksioneve ndërmjet dy PPB-ve, do të zbatohet vëllimi më i vogël i nominuar i tregtimit dhe PPB-të do të informohen sipas rastit.

Në rast të mos konsistencës së jashtme në lidhje me transaksionet me PPB e PX , nominimet e PX do të prevalojnë. PPB-të respektive do të informohen sipas rastit në mënyrë që të mund të përshtatin nominimet e tyre të shkëmbimit në rrjet për të qenë në balancë me nominimet e rregulluara tregtare (nëse nevojitet).

- ii. Në rast të mosmiratimit, OST informon PPB-të repektive, të cilat më pas paraqesin nominime të përmirësuara sa më shpejt që të jetë e mundur. Këto nominime kërkojnë përsëri miratimin nga OST.

f. Nominimet e miratuara hyjnë në fuqi në orën 00:00 të ditës respektive.

g. Ndryshimet në nominime:

- i. Ndryshimet mund të paraqiten deri në orën 10:00 pas ditës së transaksionit (D+1, 10:00)
- ii. Në rast të ndryshimeve, i gjithë nominimi për ditën në fjalë duhet të ri-dërgohet. Nëse miratohet, nominimi i ri zëvendëson atë të vjetrin. Nominimi i ri nuk mund të miratohet pjesërisht.
- iii. Ndryshimet duhet të miratohen nga OST nëse: (*shënim*: kjo do të thotë se në të kundërt ato mund të refuzohen):
 - iii.1. Kanë të bëjnë me transaksionet brenda-vendit dhe ndryshimet e paraqitura nga të gjitha PPB-të respektive janë konsistente
 - iii.2. Kanë të bëjnë me transaksionet ndër-kufitare dhe ndryshimet e paraqitura konfirmohen nga OST në anën tjetër të kufirit ose nga platforma përkatëse

e kapaciteteve që vepron në emër të atij OST dhe ndryshimet paraqiten jo më vonë se një orë para orës së transaksionit.

2.1.1.3 Rezultati:

- a. Nominimet ndër-kufitare dhe brenda-vendit të miratuara të të gjitha PPB-ve
- b. Pozicioni neto i nominuar për çdo PShD për secilën PPB (për qëllime të shlyerjes së disbalancës), shuma e miratuar
 - i. -- Nominimet e tërheqjeve të rrjetit në çdo pikë lidhje të PPB
 - ii. + Nominimet e injektiveve të rrjetit në çdo pikë lidhje të PPB
 - iii. – Nominimet ndër-kufitare të eksportit në të gjitha kufijtë e zonës
 - iv. + Nominimet brenda-vendit të importit në të gjitha kufijtë e zonës

2.1.1.4 Klientët:

- a. PPB-të

2.1.2 Mbylljet e portës së nominimit

2.1.2.1 09:00 D-1: Nominimet ndër-kufitare të të drejtave afatgjata të kapacitetit

2.1.2.2 14:00 D-1: Nominimet brenda-vendit dhe ndërkufitare

2.1.2.3 H-1: Ndryshimet në nominimet ndër-kufitare (p.sh. brenda ditës)

2.1.2.4 D + 1, 10:00: Nominimet brenda-vendit

2.1.3 Proçesi i komunikimit - palët dhe mesazhet

2.1.3.1 Palët janë PPB-të dhe OST.

2.1.3.2 Nga përshkrimi paraprak, mesazhet e komunikimit të kërkuara mund të rrjedhin dhe të hartohen në një diagramë veprimesh të proçesit të aktivitetit si një ndihmë për analizën e papajtueshmërisë me sistemin DAMAS që do të kryhet nga OST. Nga OST gjithashtu do të hartohet, nëse është e nevojshme diagrama e veprimeve të proçesit të aktivitetit,

2.1.3.3 Lista jo-shteruese e mesazheve përbëhet nga:

- a. Mesazhi fillestar i paraqitjes së nominimit
- b. Mesazhi i ri-paraqitjes së nominimit (p.sh. pas refuzimit ose gabimit në komunikim)
- c. Mesazhi i ndryshimit të nominimit
- d. Mesazhi i miratimit të nominimit

e. Mesazhi i refuzimit të nominimit

2.1.4 Nominimet *ex-ante*

2.1.4.1 Nominimet fillestare për transaksionet ndër-kufitare që përdorin të drejtat afatgjata të kapaciteteve të alokuara si dhe nominimet për transaksionet brenda-vendit dhe transaksionet ndër-kufitare që vijnë nga tregu i ditës në avancë (i përbashkët) duhet të paraqiten në D-1 para orës 14:00.

2.1.4.2 Nominimet shtesë përshkruhen si ndryshim në nominimet e mësipërme. Nominimet shtesë për transaksionet ndër-kufitare mund të paraqiten deri në një orë para orës së transaksionit.

2.1.5 Nominimet *ex-post*

2.1.5.1 Vetëm nominimet brenda-vendit do të pranohen *ex-post*. Ora përfundimtare e mbylljes së portës për nominimet brenda-vendit është D + 1, 10:00.

2.1.6 Fall-back

2.1.6.1 Në rast se sistemi i mesazheve elektronike nuk funksionon ose PPB nuk ka përkohësisht akses në sistem, një procedurë emergjence mund të lejojë PPB-të të dorëzojnë nominimet / ri-nominimet nëpërmjet e-mailit , sipas kërkesave të një formati të përcaktuar nga OST.

2.2 Proçesi i shkëmbimit të të dhënave të matjes

2.2.1 Lidhur me shkëmbimin e të dhënave në kohë-reale midis sistemeve SCADA të OShB dhe OST, do të zbatohet shkëmbimi i informacionit si më poshtë:

- a. Matjet që përcaktojnë sinjalin referues të njësisë ofruese të aFRR.
- b. Rezultatet e matjeve e në kohë reale.
- c. Ndryshimet e rezervës totale të fuqisë komunikohen nga OST në kohë reale. Ato duhet të regjistrohen në mënyrë elektronike nga OST dhe OShB.
- d. OShB kthen sinjalin përsëri në OST (pasqyrim i sinjalit të marrë) në mënyrë që të kontrollojë nëse sinjali është marrë si duhet.
- e. Informacioni i në vijim vjen nga secila njësi e OShB tek OST.
- f. Një sinjal logjik (0 ose 1) që tregon nëse Njësia (ose Centrali gjenerues) i OShB po merr pjesë aktualisht në Shërbim.
- g. Lloji i produktit të shërbimit balancues dhe drejtimi.

- h. Sasia në MW e ndryshimit të rezervës totale të fuqisë të kërkuar nga OST që i atribuohet një njësie.
- i. Fuqia referente (në MW) që çdo Njësi OShB e OShB pjesëmarrëse në angazhimin për shpërndarje duhet të injektojë në $t + \Delta t$ s për nevojat vetjake të OShB-së.
- j. Fuqia minimale/maksimale e Njësisë OShB.
- k. Shkalla maksimale e pjerrësisë (rampingur) të njësisë OShB
- l. Matja e fuqisë neto (bruto nëse vlera neto nuk mund të matet) e prodhuar nga çdo Njësi OShB.

2.3 Llogaritja e çmimit të disbalancës

2.3.1 Përkufizime

2.3.1.1 Rregullimi në rritje

2.3.1.2 Rregullimi në ulje

2.3.1.3 Çmimi për energjinë balancuese në rritje

2.3.1.4 Çmimi për energjinë balancuese në ulje

2.3.1.5 Komponentja nxitëse

2.3.1.6 Gjendja e rregullimit(e sistemit)

2.3.1.7 Delta e balancës: proxy për disbalancat e sistemit për tu publikuar në kohë reale nga OST (open loop ACE)

2.3.1.8 Mid-Price: përkufizimi i çmimit të energjisë balancuese në rastin pa rregullim

2.3.2 Specifikimi i gjendjeve të rregullimit (për secilën PShD)

2.3.2.1 Gjendja e rregullimit=0 nuk kërkohet as rregullim në rritje dhe as në ulje

2.3.2.2 Gjendja e rregullimit=+1: kërkohet vetëm rregullim në rritje

2.3.2.3 Gjendja e rregullimit=-1: kërkohet vetëm rregullim në ulje

2.3.2.4 Gjendja e rregullimit=+1: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme

2.3.2.5 Gjendja e rregullimit=-1: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme

2.3.2.6 Gjendja e rregullimit = 2: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë as jo-rritëse në mënyrë të vijueshme as jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme.

2.3.2.7 Gjendja e rregullimit = 2: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje por delta e balancës ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme dhe jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme.

2.3.3 Specifikimi i çmimeve të disbalancës

2.3.3.1 Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit =-1 (tepricë në sistem)

- a. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në ulje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- b. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepriçë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në ulje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

2.3.3.2 Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit =+1(sistemi ka mungesë)

- a. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në rritje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- b. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepriçë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në rritje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

2.3.3.3 Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = 2 (disbalance e dyanshme e sistemit)

- a. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), dhe mid-price është më i lartë se sa çmimi për energjinë balancuese në rritje, çmimi i disbalancës është i barabartë me mid-price plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- b. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepriçë) dhe mid-price është më i ulët se sa çmimi për energjinë balancuese në rënie,

çmimi i disbalancës është i barabartë me mid-price minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

- c. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë) dhe mid-price nuk është më i lartë se sa çmimi për energjinë balancuese në rritje, çmimi i disbalancës është i barabartë çmimin për energjinë balancuese në rritje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- d. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepriçë) dhe mid-price nuk është më i ulët se sa çmimi për energjinë balancuese në ulje, çmimi i disbalancës është i barabartë çmimin për energjinë balancuese në ulje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

2.3.3.4 Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = 0 (pa rregullim)

- a. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me mid-price plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- b. Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepriçë), çmimi i disbalancës është i barabartë me mid-price minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

2.3.3.5 Komponentja nxitëse

- a. Vlera fillestare: €0/MWh
- b. Rregullimet e komponentes nxitëse
 - i. OST do të rregullojë komponentën nxitëse në bazë të kritereve objektive sipas një procedurë të përcaktuar dhe të publikuar nga OST në faqen zyrtare.
 - ii. Vlera aktuale e komponentes nxitëse do të publikohet në faqen zyrtare të OST.
 - iii. ERE ka të drejtën t'i kërkojë OST të përfshijë në Rregullat e TShB, procedurën për rregullimin e komponentes nxitëse.

2.3.3.6 Neutraliteti i kostove të OST në balancim

- a. OST do të korrigjojë tarifën e transmetimit për vitin pasues bazuar në rezultatet neto të shlyerjeve të:
 - i. Disbalancat me PPB-të
 - ii. Kostot e kontraktimit dhe aktivizimit të rezervave balancuese

- iii. Proçeset e balancimit ndër-kufitar duke përfshirë programet e kompensimit për shkëmbimet e paqëllimshme

2.3.3.7 Kompensimi për pagesën e komponentes nxitëse

- a. Në rast se disbalanca e PPB shkaktohet nga një ngjarje në rrjet ose nga ndërhyrja e OST ose OSSh, PPB merr kompensim për pagesat në lidhje me komponenten nxitëse. Shembuj të këtyre ngjarjeve janë(jo-shteruese):
 - i. Shkarkimi automatik ose manual i ngarkesës nga OST ose OSSh
 - ii. Rritja ose ulja e detyruar e shkëmbimit në rrjet nga OST ose OSSh.
- b. Kompensimi do të paguhet nga operatori i rrjetit në rrjetin e të cilit ka ndodhur ngjarja.

3 KUALIFIKIMI

Në këtë seksion prezantohen më në detaje aspektet teknike të kriterëve të parakualifikimit dhe shpjegohen rregullat në lidhje me parakualifikimin e specifikuar në Rregullat e TShB. Informacioni lidhur me parakualifikimin për secilin produkt është i organizuar në dy kategori kryesore: a) kriteret teknike të produktit dhe b) testi i parakualifikimit. Kërkesat për FCR, janë më kërkuese se sa kërkesat për pjesën tjetër të produkteve për shkak të kërkesave teknike më të larta të këtij produkti. Prandaj, për sigurimin e FCR kërkohen në mënyrë të hollësishme më shumë teste për parakualifikim.

3.1 Proçesi i parakualifikimit

3.1.1 Furnizuesi i shërbimeve balancuese

3.1.1.1 Çdo kompani që përfaqëson një ose më shumë Palë të Lidhura që dëshiron të ofrojë secilin nga produktet e përcaktuara quhet kandidat për OShB deri kur të ketë përfunduar me sukses parakualifikimi i tij, ku ai bëhet OShB i kualifikuar për produktet për të cilat kualifikohet.

3.1.1.2 Kur kërkon parakualifikim, kandidati për OShB duhet të sigurojë një deklaratë nga një PPB e cila merr përgjegjësinë e balancimit për ofrimin e shërbimeve, d.m.th. të gjitha aktivizimet e energjisë balancuese të OST nga OShB, mund të korrigjohen në disbalancën e PPB respektive dhe ajo PPB do të paguajë për çdo mos-shpërndarje të energjisë së aktivizuar.

3.1.1.3 OShB mbetet përgjegjës për pajtueshmërinë dhe vetëm OShB duhet të ngarkohet me penalitetet e pa-pajtueshmërisë.

3.1.2 Input

3.1.2.1 Kriteri i kualifikimit (nga OST);

3.1.2.2 Formulari i kërkesës për kualifikim me të paktën listën e Palëve të Lidhura nga që ai do të ofrojë shërbimin;

3.1.2.3 Deklarimi i PPB;

3.1.2.4 Çdo dëshmi që produkti që dëshiron të ofrojë kandidati për OShB, plotëson kriteret e përkufizimit të produktit;

3.1.2.5 Çdo dëshmi të disponueshmërisë së garantuar të vëllimit për të cilin kandidati për OShB dëshiron të kualifikohet. Kjo nuk është e nevojshme nëse kandidati për OShB nuk dëshiron të kualifikohet për pjesëmarrje në ankandin për kontratat e kapacitetit rezervë (angazhimin për disponueshmërinë). Kjo vlen vetëm për produktet që kërkojnë kontraktimin e disponueshmërisë.

3.1.2.6 Çdo dëshmi që kandidati për OShB është financiarisht i qëndrueshëm (përfshirë kolateralin për detyrimet financiare në rastet e papajtueshmërisë nëse kërkohet;)

- a. Çdo dëshmi që tregon që kandidati për OShB ka kompetenca të mjaftueshme për të vepruar si një OShB për produktin dhe procesin për të cilin dëshiron të kualifikohet {(FCR, aFRR, mFRR, RR, angazhimin e disponueshmërisë (ankand), angazhimin e shpërndarjes (oferta ditore e produkteve balancuese për OST) ose të dyja}.

3.1.3 Proçesi

3.1.3.1 Parakualifikimi është një proçes ku një palë e lidhur në çdo kohë mundet të paraqesë një kërkesë për parakualifikim. Megjithatë, do të përcaktohet një afati për regjistrim për parakualifikim për ankandin e ardhshëm të angazhimit për disponueshmëri (d.m.th. Koha që duhet për të përfunduar proçesin e parakualifikimit përpara hapjes së portës për ankandin).

3.1.3.2 Kërkesa bëhet përmes formularit të kërkesës për kualifikim.

3.1.3.3 Pasi OST të ketë marrë formularin, së paku duhet:

- a. T'i Konfirmojë marrjen OShB, nëpërmjet një kopje për PPB dhe Palëve të Lidhura respektive;

- b. Të vërtetojë që PPB e nominuar është e regjistruar si PPB me njohje të plotë;
- c. Të planifikojë testet teknike të para-kualifikimit me OShB dhe Palët e Lidhura respektive (nëse është e zbatueshme);
- d. Të kontrollojë qëndrueshmërinë financiare të kandidatit për OShB;
- e. Të kontrollojë aftësinë e kandidatit për OShB për të vepruar si OShB.

3.1.3.4 Testimi i para-kualifikimit

- a. Testet teknike, që kandidati për OShB mundet të shpërndajë rezervat sipas specifikimeve të produktit. Nëse kandidati për OShB dëshiron të kualifikohet në angazhimin për disponueshmëri, këto teste do të mbulojnë gjithashtu vëllimin që OShB dëshiron të kualifikohet për të marrë pjesë në ankandin e angazhimit për disponueshmëri.
- b. Testet teknike që të gjitha komunikimet operationale me kandidatin për OShB të funksionojnë siç duhet. Kjo mund të kërkojë një strukturë elektronike të testimit të mesazhit (për proceset e ofertimit dhe aktivizimit) dhe një testim të funksionimit të duhur të çdo komunikimi të kërkuar në kohë reale (p.sh. në lidhje me sinjale referente që përcaktojnë pozicionin e injektimit / tërheqjes pa aktivizim të kandidatit për OShB).
- c. Analiza e portofolit për të vërtetuar se kandidati OShB mund të garantojë disponueshmërinë gjatë gjithë periudhës kontraktuese të vëllimit që kandidati OShB dëshiron të kualifikohet për të marrë pjesë në ankandin e angazhimit për disponueshmëri.

3.1.4 Rezultati

- a. Konfirmimi i kandidatit OShB dhe PPB respektive për përfundimin e suksesshëm të të gjitha verifikimeve dhe testeve. Informacion për OShB e kualifikuar për ankandin e ardhshëm për angazhimin për disponueshmëri për të cilin tashmë kualifikohet dhe për ditën nga e cila tashmë mund të marrë pjesë në procesin e angazhimit për shpërndarje.
- b. Regjistrimi i kandidatit OShB për OShB i kualifikuar për produktin(et) në fjalë në Regjistrin e OShB-së me hyrjen në fuqi, produktet dhe vëllimet për të cilat u kualifikua (vëllimi i kualifikuar vetëm për angazhimin për disponueshmëri, për angazhimin për shpërndarje vëllimi nuk ka nevojë të kualifikohet).

3.2 Kualifikimi i ofruesit të FCR

Rezervat për FCR kontraktohen vetëm si kapacitet dhe jo si energji. Kjo do të thotë që njësitë teknike angazhojnë vetëm disponueshmërinë e njësive të parakualifikuara dhe shpërblehen e kompensohen për disponueshmërinë. Shpërndarja e energjisë në rastin e aktivizimit nuk kompensohet si pjesa tjetër e produkteve të tjera. Prandaj, aspektet teknike të kriterëve të para-kualifikimit lidhen vetëm me angazhimin për disponueshmëri.


3.2.1 Kriteret teknike

3.2.1.1 Në tabelën e mëposhtme është paraqitur një pasqyrë e kërkesave kryesore:

| | |
|---|---|
| Kërkesa për madhësinë e kapacitetit të angazhimit për disponueshmëri (madhësia minimale e ofertës për njësi) | $\pm x$ MW |
| Kërkesa për madhësinë e kapacitetit të angazhimit për disponueshmëri (madhësia maksimale e ofertës për njësi) | $\pm x$ MW |
| Saktësia minimale e matjes së frekuencës | $\leq \pm 10$ mHz |
| dead-banda e Frekuencës | Efekti maksimal i kombinuar i pandjeshmërisë inherente dhe zonës së pandjeshme që lihet enkas në aparatin drejtues të çdo njësie gjeneruese 10 mHz. |
| Koha e Aktivizimit të Plotë | Përgjigja e plotë brenda 30 sekondave pas ngjarjes së frekuencës, dhe gjithashtu për ngjarjet e devijimit maksimal të frekuencës duhet të aktivizohet pas 15 sekondave 50% e kapacitetit të FCR |
| Kohëzgjatja e shpërndarjes | të paktën 15 min Për njësitë me rezervuarë me energji të kufizuar (p.sh. bateritë, rrotat fluturuese, pump-storage) mund të aplikohet kohëzgjatje specifike. |
| Devijimi i frekuencës në cilën kërkohet përgjigje e plotë | ± 200 mHz |

| | |
|---|---|
| Kërkesat për matjen operationale | në MW me cikël përditësimi 4s |
| Droop (lëshimi i aparatit drejtues): Raporti i devijimit respektiv të frekuencës gati të qëndrueshme (Df/f_N) respektive me ndryshimin respektiv të fuqisë (DP/P_N) të njësisë nën ndikimin e rregullatorit FCR. | Do të jetë në gjendje të rregullohet kur OST e kërkon (vlera e parazgjedhur e rekomanduar: 5%) dhe duke u siguruar që kapaciteti i kontraktuar të aktivizohet plotësisht për devijim të frekuencës 200 mHz. |

3.2.1.2 Në figurën më poshtë paraqiten grafikisht aktivizimi dhe përgjigja:



3.2.1.3 Parametrat teknikë të dhënë më sipër janë në përputhje me dispozitat evropiane për zonën sinkrone kontinentale. Ata mund të ndryshojnë me parametrat e disa zonave të tjera sinkrone, siç tregohet në tabelën më poshtë.

Pronat FCR në zona të ndryshme sinkron

| Saktësia minimale e matjes së frekuencës | EK, GB, IE / NI dhe Nordike | 10 mHz ose standardi industrial nëse është më i mirë |
|---|-----------------------------|--|
| Efekti maksimal i kombinuar i pandjeshmërisë inherente dhe zonës së vdekur që lihet enkas në aparatit drejtues të çdo njësie gjeneruese ofruese e FCR, ose grupe ofruese të FCR | EK | 10 mHz |
| | GB | 15 mHz |
| | , IE / NI | 15 mHz |
| | Nordike | 10 mHz |

| | | |
|--|-----------|--|
| Koha e aktivizimit të plotë të FCR | EK | 30 s |
| | GB | 10 s |
| | , IE / NI | 15 s |
| | Nordike | 30 s nëse frekuenca e sistemit është jashtë rangut të frekuencës standarde |
| Aktivizimi i plotë i FCR për devijim të frekuencës | EK | ± 200 mHz |
| | GB | ± 500 mHz |
| | , IE / NI | FCR dinamike ± 500 mHz FCR statike ± 1000 mHz |
| | Nordike | ± 500 mHz |

3.2.2 Testet e parakualifikimit

3.2.2.1 Në testin e parakualifikimit, OShB duhet të provojë se ndjek kërkesat teknike të përcaktuara nga OST. Këtu, OST teston njësinë teknike ose rezervën e OShB në lidhje me kapacitetin premtues në dispozicion, si dhe aftësinë për të shpërndarë energjinë balancuese kur njësia aktivizohet. Për këtë, OST kërkon dy teste të ndryshme parakualifikimi, Testin e Profilit Sintetik të Frekuencës dhe Testin e Frekuencës në Kohë Reale.

3.2.2.2 Rezultati i testeve do të përcaktojë kapacitetin maksimal të balancimit që lejohet të ofertohet, pra FCR_{max} . Teorikisht, vlera e FCR_{max} i korrespondon vlerës referente të FCR deklaruar nga OShB.

3.2.3 Testi i Profilit Sintetik të Frekuencës (SFC)

3.2.3.1 Rezerva e OShB ose e njësisë së vetme teknike të saj, duhet të demonstrojë një profil reagimi të paracaktuar. OST paraqualifikon njësinë teknike ose rezervën e njësive në çdo drejtim (në rritje dhe në rënie). Testet në dy drejtime të ndryshme mund të kryhen në momente të ndryshme në kohë, brenda një harku kohor prej 24 orësh.

3.2.3.2 OST do të shqyrtojë matjet e secilës njësi teknike që kërkon parakualifikim të cilat janë mbledhur nëpërmjet komunikimit në kohë reale dhe zbaton rregullat e mëposhtme:

- Vlera minimale e fuqisë për çdo hap të frekuencës Δf nga 50 mHz (gjatë një periudhe prej 120 sekondash) do të merret si vlerë referuese FCR_{ref} për hapin përkatës;
- Përveç kohës së aktivizimit të kërkuar, para se OST të shqyrtojë matjet për të përcaktuar vlerën minimale të hapit, lejohet një kufi prej 5 sekondash;

3.2.3.3 Për këtë test, OST do të llogarisë vlerën e $P_{sup_parakual.}(t)$ si më poshtë:

$$P_{sup_parak.}(t) = P_{matur}(t) - P_{ref_parakua.}(t)$$

Ku:


- $P_{ref_parakual.}$: Fuqia mesatare e matur në 20 sekonda para fillimit të testit;


3.2.3.4 Për qëllime të testit, OST do të llogarisë vlerat mesatare të $P_{sup_parakual.}(t)$ 10 sekondshe, të quajtur $P_{sup_parak.}(t)$ _Mesatare. Për të marrë parasysh tolerancën prej 5 sekondash në fillim të çdo hapi, OST do të llogarisë vlerën mesatare 15 sekondshe në fillim të çdo hapi në vend të mesatares për 10 sekonda. Kështu OST do të përzgjedhë për secilin hap vlerën më të ulët (ose më të lartë për drejtim në rënie) midis:

- një vlerë mesatare të $P_{sup_parak.}(t)$ gjatë 15 sekondave të para të hapit pas tolerancës prej 5 sekondash;
- numri i mbetur i vlerave mesatare të $P_{sup_paraku.}(t)$ gjatë 10 sekondave për secilin hap.

3.2.3.5 Rezultati i këtij testi është FCR_{max_SFP} për secilën vlerë të njësisë teknike e cila së bashku me rezultatin e testit të Ndjekjes në Kohë Reale të Frekuencës do të përcaktojnë FCR_{max} .

3.2.3.6 Njësia teknike duhet të ndjekë profilet e mëposhtme (janë treguese) në rritje dhe në rënie duke ndjekur një devijim të simuluar të frekuencës hap pas hapi :





- Njësia teknike në 13 sekonda (7,5 sekonda të kohës së aktivizimit të kërkuar dhe 5 sekonda të tolerancës) duhet të japë vëllimin e secilit hap të 50mHz;
- Njësia teknike duhet të ruajë reagimin e saj për 2 minuta përpara se të shkojë në hapin e ardhshëm të 50mHz.
- Pasi njësia teknike të ketë dhënë fuqinë maksimale të saj, duhet të mbajë reagimin e saj për 22 minuta.
- Reagimi i njëjtë duhet të kryhet në drejtimin e kundërt, siç është treguar më lart brenda 24 orëve;

3.2.3.7 OST do të llogarisë vlerën e $P_{\text{hapi_min}}$ si më poshtë:

$$P_{\text{hapi_min}} = \min(\text{Min1}; \text{Min2}; \text{Min3}; \text{Min4}; \text{Min5}; \text{Min6}; \text{Min7}; \text{Min8})$$

Ku:

- $\text{Min1} = 4 * \Delta P_{\text{sup_Hapi_1}}$ nga $t=13\text{sec}$ to $t=128\text{ sec}$
- $\text{Min2} = 4 * \Delta P_{\text{sup_Hapi_2}}$ nga $t=141\text{sec}$ to $t=256\text{ sec}$
- $\text{Min3} = 4 * \Delta P_{\text{sup_Hapi_3}}$ nga $t=269\text{sec}$ to $t=384\text{ sec}$
- $\text{Min4} = 4 * \Delta P_{\text{sup_Hapi_4}}$ nga $t=397\text{sec}$ to $t=1712\text{sec}$
- $\text{Min5} = -4 * \Delta P_{\text{sup_Hapi_5}}$ nga $t=13\text{sec}$ to $t=128\text{ sec}$
- $\text{Min6} = -4 * \Delta P_{\text{sup_Hapi_6}}$ nga $t=141\text{sec}$ to $t=256\text{ sec}$
- $\text{Min7} = -4 * \Delta P_{\text{sup_Hapi_7}}$ nga $t=269\text{sec}$ to $t=384\text{ sec}$
- $\text{Min8} = -4 * \Delta P_{\text{sup_Hapi_8}}$ nga $t=397\text{sec}$ to $t=1712\text{ sec}$

Ku:

- $\Delta P_{\text{sup_hapi}}$: është diferenca ndërmjet vlerës më të ulët (ose më të lartë për drejtimin në rënie) të $P_{\text{sup_parak. (t)_{Mesatare}}$ gjatë hapit që i paraprin hapit në

fjalë dhe vlerës më të ulët (ose më të lartë për drejtim në rënie) të $P_{sup_parak.}(t)_{Mesatare}$ gjatë hapit përkatës siç përmendet më lart.

- $t=0$ është momenti i caktuar si fillimi i testit për secilin drejtim;

3.2.3.8 Vlera e P_{hapi_min} do të krahasohet me fuqinë minimale të furnizuar (P_{max_rritje} ; $P_{max_rënie}$) gjatë hapave në të cilat OShB pritet të japë reagimin e tij të plotë në drejtim në rritje dhe në rënie sipas profilit të përshkruar më lart.

Këto vlera llogariten si më poshtë:

- $P_{plotë_rritje}$ (drejtimi në rritje): është vlera më e ulët e $P_{sup_paraku.}(t)_{Mesatare}$ gjatë hapit "Fuqi e plotë. _ rritje". Nëse kjo vlerë është negative atëherë $P_{plotë_rritje}$ konsiderohet e barabartë me zero;
- $P_{plotë_rënie}$ (drejtimi në rënie): është vlera më e lartë e $P_{sup_paraku.}(t)_{Mesatare}$ gjatë hapit "Fuqi e plotë _ rënie". Nëse kjo vlerë është pozitive atëherë $P_{plotë_rënie}$ konsiderohet e barabartë me zero;

Nëse :

$$P_{hap_min} \geq 0,9 * \min(P_{plotë_rritje} ; -P_{plotë_rënie})$$

atëherë :

$$FCR_{max_SFP} = \min(P_{plotë_rritje} ; -P_{plotë_rënie})$$

Nëse jo :

$$FCR_{max_SFP} = P_{hapi_min}$$

3.2.4 Testet e frekuencës në kohë reale

3.2.4.1 OShB do të ndjekë frekuencën për **xx** orë të njëpasnjëshme, njësoj sikur të ishte aktivizuar nga OST për ofrimin e Shërbimit pas një ankandi.

3.2.4.2 OShB mund të vendosë kohën e fillimit të testit siç i volit dhe e komunikon atë te OST përpara fillimit të testimit.

3.2.4.3 Nëse gjatë këtij intervali ndodhin një ose disa Lulatje të Frekuencës që tejkalojnë 40mHz, OST do të kontrollojë Lulatjen më të madhe për të parë nëse OShB është përgjigjur siç duhet.

3.2.4.4 Në rast të një difference pozitive midis $P_{\text{kërkuar_aktivizimit}}$ për testin dhe $P_{\text{supozuar_aktivizimit}}$ për Devijimin e Frekuencës të lartpërmendur, OST do të llogarisë një vlerë si më poshtë:

$$\Delta FCR_{\text{max_RF}} = \min(P_{\text{supozuar_aktivizimit}} / P_{\text{kërkuar_aktivizimit}}; 1)$$

Me

$P_{\text{supozuar_aktivizimit}} = \max(P_{\text{supozuar_pas}} - P_{\text{supozuar_para}}; 0)$ për drejtimin në rritje; dhe

$P_{\text{supozuar_aktivizimit}} = \max(P_{\text{supozuar_para}} - P_{\text{supozuar_pas}}; 0)$ për drejtimin në rënie. Ku,

$P_{\text{supozuar_para}}$: është vlera mesatare e matjeve të mbledhura të fuqisë (në MW) të njësisë teknike gjatë një kohe prej 20 sekondash duke filluar saktësisht 20 sekonda para fillimit të luhatjes së frekuencës.

$P_{\text{supozuar_pas}}$: është vlera më e lartë (për rritje)/vlera më e ulët (për rënie) e matjeve të mbledhura të fuqisë (në MW) të njësisë teknike gjatë një kohe prej 30 sekondash duke filluar në kohën kur luhatja e frekuencës arrin vlerën më të lartë.

$$P_{\text{kërkuar_aktivizimit}} = \text{Abs} | P_{\text{kërkuar_para}} - P_{\text{kërkuar_pas}} |$$

3.2.5 Llogaritja e FCR_{max}

3.2.5.1 Vlera e FCR_{max} që njësia teknike e OShB të mund të parakualifikohet për të shpërndarë në OST llogaritet si vijon:

3.2.5.2 Vlera e FCR_{max} që një OShB mund të shpërndajë në OST llogaritet si vijon:

$$FCR_{\text{max}} = \min[FCR_{\text{ref}}, FCR_{\text{max_SFP}} * \Delta FCR_{\text{max_RFT}}]$$

Ku:

- FCR_{Ref} : Vlera referente e ofruar nga OShB
- $FCR_{\text{max_SFP}}$: Vlera e llogaritur si më lart për secilën njësi teknike si rezultat i Testit të Profilit Sintetik (SPF) të frekuencës;
- $\Delta FCR_{\text{max_RF}}$: Vlera e llogaritur siç përmendet më lart për secilën njësi teknike si rezultat i testit të ndjekjes së Frekuencës në Kohë Reale;

3.3 Kualifikimi i ofruesit të aFRR


3.3.1 Kriteri teknik

3.3.1.1 Në tabelën e mëposhtme janë listuar specifikimet teknike për angazhimin për disponueshmëri të aFRR.

| | |
|---|--|
| Kërkesa për madhësinë e kapacitetit të angazhimit për disponueshmëri (madhësia minimale e ofertës për njësi) | $\pm x$ MW |
| Kërkesa për madhësinë e kapacitetit të angazhimit për disponueshmëri (madhësia maksimale e ofertës për njësi) | $\pm x$ MW |
| Kohëzgjatja e aktivizimit | së paku 15 minuta pandërprerje |
| Ndryshimi i parë i dallueshëm i fuqisë | Të paktën brenda 10 sekondave pas ndryshimit të tarimit |
| Koha e aktivizimit dhe de-ktivizimit të plotë | Aktivizimi i plotë pas max. 7.5 minutash |
| Tejkalimi maksimal në terma afatshkurtër | 10% e vëllimit të ofertuar të aFRR, por jo më shumë se 1 MW |
| Saktësia | Devijimi duhet të jetë më i vogël se 7.5%, dhe për çdo hark kohor 10 sek. të matur lejohen vetëm dy devijime |


3.3.2 Testi e parakualifikimit

3.3.2.1 Me qëllim testimin e një njësie teknike për të marrë pjesë në një shërbim të veçantë, ajo duhet të kalojë me sukses një test para-kualifikimi. Në këtë test, OShB demonstroi se njësitë teknike është e aftë të ndjekë kërkesat e pjerrësisë (rampingut) siç paraqitet në figurën më poshtë. Për më tepër, OShB dëshmon se njësitë teknike mund të japë energjinë pandërprerje për të paktën 15 minuta radhazi.



3.3.2.2 Në rast se Njësia teknike nuk përfundon testin e simulimit me sukses, OST dhe OShB do të bëjnë përpjekjet më të mira për të identifikuar burimin e dështimit dhe OShB do të bëjë përpjekjet më të mira për të zgjidhur burimin e dështimit.

3.3.2.3 Për simulimin e aFRR, OShB duhet të simulojë sinjalin e mëposhtëm të aktivizimit. Me këtë sinjal OST do të testojë nëse OshB mund të aktivizojë aFRR e Njesisë teknike dhe nëse ai është në gjendje të ndjekë një sinjal të ndryshueshëm me një devijim më të vogël se 7.5% të vlerës maksimale (lejohen 2 devijime prej 10 sekondash). Ky test do të zgjasë 100 minuta. Për këtë test do të merret çdo 10 sekonda një kampion (duke filluar nga 00:00:00, 00:00:10: ...). Ky sinjal duhet të jetë ndërmjet kufirit të sipërm dhe kufirit të poshtëm të saktësisë (diapazon prej 15%) siç tregohet në figurën më poshtë.



3.3.2.4 Kërkesat për vërtetim:

- A arrin aFRR e dhënë maksimumin sic tregohet në rritjen maksimale?
- A është devijimi më i vogël se 7.5% (2 devijime të lejuara prej 10 sekondash)?

3.4 Kualifikimi i ofruesit të mFRR/RR

3.4.1 Kriteret teknike

3.4.1.1 Në tabelën e mëposhtme janë renditur specifikimet teknike për angazhimin për disponueshmëri të mFRR.

| | |
|--|---|
| Kërkesa për madhësinë e kapacitetit të angazhimit për disponueshmëri (madhësia minimale e ofertës për njësi) | $\pm x$ MW |
| Kërkesa për madhësinë e kapacitetit të angazhuar të disponueshëm (madhësia maksimale e ofertës/njësi) | $\pm x$ MW |
| Koha e aktivizimit dhe de-aktivizimit të plotë | brenda 15 minutave |
| Kohëzgjatja e aktivizimit | OST mund të vazhdojë aktivizimin e kësaj rezerve për sa kohë që është ofruar. |

3.4.2 Testi i parakualifikimit

3.4.2.1 Njësitë teknike të cilat kanë kaluar testin e para-kualifikimit në vitin paraardhës dhe kanë ofruar më pas për OST mRR / RR, konsiderohen të parakualifikuara, përveç nëse OST tërheq parakualifikimin e tyre për shkak të papajtueshmërisë së tyre të mëvonshme. Përndryshe, një njësi teknike duhet të jetë e parakualifikuar përpara se të mund të jetë pjesë e një kontrate.

3.4.2.2 Për të vërtetuar aftësinë e një njësie teknike për të marrë pjesë në ankandin e kapacitetit të mFRR /RR, ai duhet të kalojë me sukses testin e parakualifikimit duke demonstruar aftësinë e tij për të përmbushur kërkesat teknike të lartpërmendura. Testi i parakualifikimit kërkohet për rezervat e prodhimit, si dhe për rezervat që çkyçen në terma të Menaxhimit të Kërkesës (p.sh., impiantet e mëdha të prodhimit industrial). Kriteret teknike për të dy tipet e njësisë ofruese janë të njëjta.

3.4.2.3 Rezultati i testit do të përcaktojë fuqinë maksimale të mFRR dhe / ose RR që OShB mund t'i ofrojë OST.

3.4.2.4 Për testin e simulimit të mFRR (aktivizuar direkt), OShB duhet të demonstrojë një aktivizim të mFRR. Njësia teknike (prodhimi ose kërkesa) duhet të aktivizojë mFRR maksimale brenda 15 minutash.

3.4.2.5 Kërkesat për testin e para-kualifikimit të mFRR max duhet të arrihen brenda 15 minutave (në rritje).

3.4.2.6 Njësia teknike duhet të jetë në gjendje të kthehet në programin fillestar brenda 15 minutave (në rënie)

3.5 Kualifikimi i ofruesit të ER

3.5.0.1 Ky nuk është produkt standard dhe nuk parapëlqehet të zbatohet në terma afatmesëm, megjithatë, mund të merren parasysh në të ardhmen nga OST në rast të mungesës së vëllimit të mFRR nga asetet e gjenerimit të cilat mund të kontraktohen për të mbuluar kërkesat e dimensionimit dhe / ose si një mbështetje për tregun që nuk ka aktivizuar në kohë zëvendësimet për ndërprerjet. Kjo gjithashtu do të varet nga disponueshmëria e objekteve të kërkesës të afta për ofrimin e shërbimeve të tilla.

3.5.1 Kriteret teknike

3.5.1.1 OShB duhet të plotësojë dhe të paraqesë një përshkrim të njësive të konsumit të energjisë nga të cilat do të ofrohet shërbimi. Detajet e kërkesave varen nga natyra dhe disponueshmëria e objekteve të interesuara të kërkesës në ofrimin e shërbimeve të tilla. Si referencë, në këtë dokument janë përfshirë dispozitat në fuqi aktualisht në Gjermani, ku përshkrimi përfshin: ndërtimin, funksionin dhe mënyrën e operimit, si dhe karakteristikat elektrike të ngarkesës së njësisë. Për më tepër, OShB do të përshkruajë procesin e zvogëlimit të konsumit të njësisë, procesin pasues të rritjes së konsumit dhe kufizime të tjera të rëndësishme operationale. OShB duhet të deklarojë gjithashtu kohëzgjatjen minimale dhe maksimale teknikisht të mundshme të ndërprerjes së ngarkesës.

3.5.1.2 OShB do të caktojë vendndodhjen fizike dhe pikën e lidhjes së njësisë së konsumit. Pika e lidhjes do të përcaktohet gjatë para-kualifikimit dhe nuk mund të ndryshohet.

3.5.1.3 Kapaciteti minimal i instaluar i njësisë së kërkesës duhet të jetë të paktën **xx** MW. Duhet të ketë sjellje të parashikueshme të ngarkesës. Vlera minimale dhe maksimale për çdo ofertë kapaciteti në procesin e ankandit vjetor është respektivisht 3 MW dhe 50 MW.

3.5.1.4 Njësia e konsumit duhet të plotësojë disa kërkesa për kurbën e ngarkesës. Ndryshimi i kurbës aktuale të konsumit të fuqisë lejohet të bëhet në një diapazon të caktuar pas aktivizimit të demonstruar. Ky diapazon synon drejt kurbës së pritshme minimale të konsumit të fuqisë së njësisë, që përcaktohet si kufiri i poshtëm i diapazonit. Kufiri i sipërm i diapazonit llogaritet si konsumi minimal i pritshëm i fuqisë plus 20% të rezervës së emergjencës së paguar. Kohëzgjatja minimale e aktivizimit të plotë është 15 minuta. Koha e plotë e aktivizimit nuk mund të jetë më shumë se 10 minuta.

3.5.1.5 OShB duhet të konfirmojë se kapaciteti i rezervës së emergjencës është i disponueshëm në çdo 15 minutësh, por i kufizuar në X herë në ditë, Y herë në javë, Z herë në vit. X, Y dhe Z mund të specifikohen nga OShB dhe duhet të dakordohen gjatë procedurës së negociuar e ankandit për këtë produkt specifik. Vlerat minimale të X, Y dhe Z duhet të përcaktohen nga OST dhe parapëlqehen të jenë rezultat i negociimeve.

3.5.2 Testi i Parakualifikimit

3.5.2.1 Parakualifikimi për rezervat e emergjencës duhet të jetë pjesë përbërëse e procesit të prokurimit për atë produkt. Kërkesa teknike mund të caktohen në varësi të shërbimeve të disponueshme dhe të mundshme që mund të ofrohen nga objektet Shqiptare të kërkesës.

3.5.2.2 OShB duhet të provojë se bëhet ndërprerja e ngarkesës me kapacitetin e plotë të parakualifikuar të saj, brenda kohës së plotë të aktivizimit, pas fillimit të shpërndarjes së komanduar në distancë nga OST. Reduktimi i ngarkesës duhet të fillojë (gati) menjëherë (p.sh. brenda 1 sekonde, për t'u negociuar).

3.6 Fall-back

3.6.1 Kualifikimi i njesive teknike të mjaftueshme do të jetë parakusht për fillimin e TShB. Ky nuk është rasti kur kërkohet një dialog me ERE dhe Industrinë për të kërkuar zgjidhje: vonesa e fillimit të TShB në mënyrë që të lejojë investime të reja drejt më tepër vëllimeve të parakualifikuara, zvogëlimin e saisë që do të kontraktohet, d.m.th. duke u mbështetur më tepër në ofertat vullnetare, angazhimi me OST-të fqinje në ndarjen e rezervave ndërkufitare (vetëm nëse ka kapacitet të papërdorur në drejtimin e importit në të paktën një kufi gjatë gjithë kohës, jo domosdoshmërisht në të njëjtin kufi), angazhimi në përgjigjen e kërkesës me anë të Kërkesës së Menaxhueshme në rast të emergjencës (rezerva e emergjencës si zëvendësim për mFRR). Mënyra për të ecur përpara do të varet nga situata e investimeve në gjenerim, disponueshmëria e rezervës ndërkufitare, vullneti i industrisë dhe OST-të ndërkufitare, ERE dhe kostot.

3.6.2. OST i është kërkuar që të ofrojë një listë të plotë të njësive teknike të lidhura me rrjetin Shqiptar të OST dhe OSSh për të verifikuar disponueshmërinë e vëllimeve të duhura të FCR, aFRR dhe mFRR, si dhe vëllimin potencial të Kërkesës së

Menaxhueshme për zëvendësimin e mFRR nga gjeneruesit. Kjo listë duhet të tregojë mundësinë e fillimit të TShB dhe / ose masat alternative të nevojshme. Analiza e kësaj liste dhe diskutimi i qasjeve alternative nëse janë të nevojshme është në objektin e fazës së implementimit.

4 PROCESI I ANGAZHIMIT PËR DISPONUESHMËRI.

4.1 Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe procesi i ndryshimeve

4.1.1 OST do të shpallë ankandin dhe ftojë palët e interesuara për Shprehje Interesi.

4.1.2 Palët e interesuara do të paraqesin Shprehje Interesi në lidhje me:

- a. Produktin për të cilin mund të garantohet disponueshmëria;
- b. Në rast se pala e interesuar nuk është kualifikuar ende si OShB për të hyrë në ankand për një kontratë kapaciteti:
 - i. Vëllimi në të cilin disponueshmëria mund të garantohet dhe se si mund të garantohet
 - ii. Dëshmi për aksesin në asetet e lidhura nga të cilat do të ofrohet shërbimi
 - iii. Deklarata e pranimit të termave dhe kushteve kontraktuese
- c. Në rast se pala e interesuar është e kualifikuar si OShB për të hyrë në ankand për një kontratë të kapacitetit, OSHB në fjalë.

4.1.3 OST do të ftojë të parakualifikohen si OShB, të gjitha palët që kanë paraqitur një Shprehje Interesi të plotë, por që ende nuk janë kualifikuar si OShB për ankandin.

4.1.4 OST do të regjistrojë të gjitha palët që kanë paraqitur një Shprehje Interesi të plotë dhe që gjithashtu janë kualifikuar si OShB për të marrë pjesë në ankand.

4.2 Dimensionimi dhe madhësia

4.2.1 FCR

4.2.1.1 Për FCR, kërkesat e dimensionimit janë sipas ENTSO-E, Udhëzuesi Operacional EK, Politika 1.

4.2.1.2 OST do të publikojë argumentimin për vëllimet e kërkuara të FCR që do të kontraktohen.

4.2.1.3 Dimensionimi duhet të kryhet të paktën një herë në vit. Të gjitha kapacitetet që rezultojnë nga dimensionimi do të kontraktohen. OST do të synojë krijimin e një platforme të përbashkët me OST-të fqinje për kontraktimin e FCR. Sasia e FCR që mund të shkëmbehet (kontraktohet jashtë bllokut të kontrollit LFC te Shqipërisë nga OST ose kontraktohet nga OST-të fqinje) përcaktohet nga rregullat e ENTSO-E.

4.2.1.4 Si anëtar i ENTSO_E, OST gjithashtu merr pjesë në dimensionimin e përbashkët dhe operimin e FCR. Sipas ENTSO-E, vëllimi total i FCR së nevojshme në zonën sinkrone të UCTE është 3000 MW. Duke e shpërndarë këtë midis vendeve, bazuar në raportin e prodhimit të energjisë elektrike në secilën zonë kontrolli me prodhimin total të energjisë elektrike në zonën sinkrone të UCTE, vëllimi i detyruar i FCR për OST është rreth 6 MW. Një pjesë minimale e vëllimit (30%) do të kontraktohet drejtpërdrejt brenda bllokut të kontrollit të OST.

4.2.2 aFRR

4.2.2.1 Çdo vit, OST përcakton kërkesën e dimensionimit për aFRR bazuar në formulën: **Minimumi i aFRR = $\sqrt{(10 \times L_{\max} + 22500)} - 150$**

Në këtë formulë L_{\max} është ngarkesa maksimale e parashikuar e konsumit për zonën e kontrollit të Shqipërisë për periudhën e ardhshme kontraktuese, pra një vit. L_{\max} do të përcaktohet nga OST. Për shembull, me një ngarkesë të raportuar të pikut të dimrit prej 1400 MW në vitin 2011, sasia minimale e aFRR që do të prokurohet do të jetë rreth 42 MW. Kërkesa e dimensionimit është dy-drejtimitëshe, dmth. sasia që rezulton do të kontraktohet në drejtimin në rritje dhe në rënie.

4.2.3 mFRR

4.2.3.1 Për mFRR në rritje, kërkohet një vëllim i barabartë me njësinë gjeneruese më të madhe që është në operim në çdo kohë gjatë vitit. Centrali prodhues më i madh në Shqipëri është HEC Koman, i cili ka disa njësi prej të cilave më e madhja ka kapacitet të instaluar 150 MW. Nuk do të jetë e nevojshme të kontraktohet rezerva e plotë e mFRR prej 150 MW. Sasia e kontraktuar e aFRR mund të zbritet nga ajo dhe për mFRR e mbetur të kërkuar në rritje, një pjesë mund të ofrohet në baza vullnetare dhe një pjesë mund të sigurohet nga kontrata e emergjencës me OST-të fqinje. Për t'u mbështetur në oferta vullnetare, rezervat e emergjencës mund të kontraktohen për të mbuluar çdo risk të vëllimeve të pamjaftueshme, duke ofruar njëkohësisht nxitje për tregun për të ofruar më shumë.

4.2.3.2 Për kontratat emergjente me OST-të fqinje do të konsiderohet se Shqipëria është një vend tranzit dhe gjithmonë duhet të ketë kapacitet importues në dispozicion me të paktën një OST dhe kapacitet eksportues në dispozicion me një OST tjetër.

4.2.4 RR

4.2.4.1 Zëvendësimi i gjeneratorëve pas një ndërprerjeje të detyruar është përgjegjësi e tregut. Prandaj, nuk ka kërkesa për dimensionimin e RR pasi OST nuk do të ketë nevojë për RR.

4.2.5 Rezervat e emergjencës

4.2.5.1 Për rezervat e emergjencës nuk ka kërkesa për dimensionim. Madhësia e rezervës së emergjencës që do të kontraktohet përcaktohet nga çdo sasi që mungon nga kontratat e aFRR, mFRR dhe shkëmbimit të rezervave balancuese me OST-të fqinjë plus sasinë e ofertave vullnetare. Përvojat e praktikave më të mira në vende të tjera tregojnë se për disa industri të mëdha të konsumit të energjisë elektrike rregullimi i proceseve të tyre të prodhimit për të lejuar reduktimin e kërkesës e komanduar në distancë është plotësisht e realizueshme për një çmim të arsyeshëm dhe ky potencial gjithashtu duhet të shqyrtohet në Shqipëri.

4.3 Proçesi i ofertimit

4.3.1 Në proçesin e ofertimit për kontraktimin e kapaciteteve të kërkuara, vetëm pjesëmarrësit e regjistruar për një produkt të caktuar mund të ofertojnë. Ofertat për kontratë kapaciteti duhet të specifikohen si:

- a. Pala ofertuese;
- b. Kapaciteti i produktit të ofruar i (FCR, aFRR ose mFRR);
- c. Vëllimi i ofruar (MW);
- d. Çmimi i ofruar (€ / MW). *Shënim:* ky është çmimi për MW për të garantuar vëllimin në dispozicion të produktit gjatë gjithë periudhës kontraktuese. E pjesëtuar me orët në periudhën kontraktuese, jep çmimin për MW në orë;
- e. Përfundimi i periudhës së angazhimit për disponueshmëri nëse kjo është para përfundimit të periudhës kontraktuese.

4.3.2 Kjo zbatohet kryesisht për kapacitetet aFRR dhe mFRR që do të prokurohen përmes ankandeve javore. Për FCR, fillimisht parashikohet një ankand vjetor i cili mund të zhvillohet përfundimisht në një ankand javor. Për rezervat e emergjencës është më i përshtatshëm një ankand vjetor.

4.3.3 OST mund të refuzojë një ofertë e cila nuk mbulon të gjithë periudhën e angazhimit për disponueshmëri ose mund të marrë në konsideratë një ndarje të periudhës së angazhimit.

4.4 Proçesi i përzgjedhjes

4.4.1 Sasia totale në rritje e aFRR + mFRR që do të kontraktohet është e barabartë me kërkesat e dimensionimit për aFRR në rritje plus sasinë e mbetur nga kërkesa e dimensionimit për mFRR në rritje pas zbritjes së vëllimit të ofertave vullnetare që mund të priten dhe vëllimit që mund të shkëmbehet në bazë të kontratave të përbashkëta me OST-të fqinje. Sasia minimale e aFRR në rritje dhe në rënie që do të kontraktohet është e barabartë me kërkesat e dimensionimit për aFRR.

4.4.2 Për çdo produkt, për secilën orë në periudhën kontraktuese, ofertat që kanë ofruar disponueshmërinë për atë orë do të përzgjidhen sipas çmimit *merit order* të ofertës derisa të arrihet vëllimi i kërkuar ose deri në arritjen e kufirit buxhetor. Ofertat mund të përzgjidhen vetëm për të gjithë periudhën kontraktuese.

4.4.3 Nëse kufiri buxhetor arrihet para se të arrihet sasia e kërkuar, do të shqyrtohet rritja e buxhetit. Nëse nuk ka më oferta që mbulojnë të gjithë periudhën kontraktuese dhe sasia e kërkuar nuk është arritur, por ofertat që ofrojnë një kohëzgjatje të kufizuar për disponueshmërinë do të plotësonin sasinë e kërkuar, ka dy zgjidhje: ose ofertat shtesë ofrohen në një ankand të ri të kontraktuar për një periudhë më të shkurtër, ose OST mbështetet në oferta vullnetare që plotësojnë vëllimet e kërkuara.

4.5 Përcaktimi i çmimeve

4.5.1 Të gjitha ofertat e kapacitetit paguhën si ofertë. OShB-të kompesohen bazuar në kapacitetin e kontraktuar shumëzuar me çmimin e ofertës së kontraktuar për MW gjatë gjithë periudhës kontraktuese, ose për MW në orë të periudhës kontraktuese.

4.6 Publikimi i rezultateve

4.6.1 Rezultatet e një ankandi do të publikohen para fillimit të procesit të angazhimit për shpërndarje. Një publikim i tillë konsiston në publikimin e:

- a. Produktit të Kërkuar;
- b. Vëllimit total të ofruar;
- c. Çmimit të ofertës më të ulët, çmimit të ofertës më të lartë;
- d. Vëllimit total për të cilin janë shpallur fitues;
- e. Çmimit mesatar të ponderuar të vëllimit për të cilin janë shpallur fitues; dhe
- f. Çmimit të ofertës më të lartë të vëllimit për të cilin janë shpallur fitues.

4.7 Afatet

4.7.1 Ankandet e FCR do të kryhen fillimisht në baza vjetore.

- a. Thirrje për Shprehje Interesi: 13 javë para ditës së fillimit të shpërndarjes
- b. Mbyllja e periudhës për Shprehje Interesi: 11 javë para ditës së fillimit të shpërndarjes
- c. Hapja e portës për ankand: 10 javë para ditës së fillimit të shpërndarjes
- d. Mbyllja e portës për ankand: 8 javë para ditës së fillimit të shpërndarjes
- e. Afati i publikimit të rezultateve: 6 javë para ditës së fillimit të shpërndarjes.

4.7.2 Ankandet e aFRR dhe mFRR në rritje do të kryhen fillimisht në baza javore.

- a. Thirrje për Shprehje Interesi (ankandi i parë): 13 javë para ditës së fillimit të shpërndarjes

- b. Mbyllja e periudhës për Shprehje Interesi (ankandi i parë): 11 javë para ditës së fillimit të shpërndarjes
- c. Hapja e portës për ankand: 10 javë para ditës së fillimit të shpërndarjes
- d. Mbyllja e portës për ankand: 2 ditë pune para ditës së fillimit të shpërndarjes
- e. Afati i publikimit të rezultateve: 1 ditë pune para ditës së fillimit të shpërndarjes

4.7.3 Afatet kohore do t'i japin OST-së kohë të arsyeshme për vendimmarrje dhe pjesëmarrësve të tregut kohë të arsyeshme për përgatitjen për fazën pasuese. Afatet përfundimtare do të dakordohen në dialog me pjesëmarrësit e tregut. Afatet duhet gjithashtu të jenë në pajtueshmëri me afatet për parakualifikim.

4.8 Fall-backs

4.8.1 Në rast të dështimit të ankandit për çfarëdo arsye, do të merren parasysh mundësitë e mëposhtme:

4.8.2 Kualifikimi i njesive teknike të mjaftueshme do të jetë parakusht për fillimin e TShB. Ky nuk është rasti kur kërkohet një dialog me ERE dhe Industrinë për të kërkuar zgjidhje: vonesa e fillimit të TShB në mënyrë që të lejojë investime të reja drejt më tepër vëllimeve më të parakualifikuara, zvogëlimin e saisë që do të kontraktohet, d.m.th. duke u mbështetur më tepër në ofertat vullnetare, angazhimi me OST-të fqinje në ndarjen e rezervave ndërkufitare (vetëm nëse ka kapacitet të papërdorur në drejtimin e importit në të paktën një kufi gjatë gjithë kohës, jo domosdoshmërisht në të njëjtën kufi), angazhimi në përgjigjen e kërkesës me anë të Kërkesës së Menaxhueshme në rast të emergjencës (rezerva e emergjencës si zëvendësim për mFRR). Mënyra për të ecur përpara do të varet nga situata e investimeve në gjenerim, disponueshmëria e rezervës ndërkufitare, vullneti i industrisë dhe OST-të ndërkufitare, ERE dhe kostot.

- a. Nëse nuk mund të sigurohet vëllim i mjaftueshëm me ankandin e parë, OST duhet të konsiderojë shpalljen e kërkesave për më shumë oferta në një raund të dytë të të njëjtit ankand, p.sh. të nesërmen. Afati përfundimtar duhet të diskutohet dhe dakordohet me industrinë në mënyrë që të kenë mundësinë për të rritur vëllimin e ofertave ose për të përshtatur çmimet e ofertës së tyre;
- b. Nëse ankandi dështon për shkak të çështjeve teknike, çështja do të zgjidhet dhe ankandi do të përsëritet pas zgjidhjes së suksesshme të dështimit. Në varësi nga arsyeja e dështimit, afatet e ankandit mund të përshtaten për të lejuar zgjidhjen e problemit.

4.8.3 Nëse në fund të ditës nuk mund të kontraktohet vëllimi i mjaftueshëm, do të merren masa *ad-hoc*. Për shembull, kontratat e emergjencës me OST-të fqinje ose me Kërkesën e Menaxhueshme. Në këtë rast, çmimi i disbalancës kur këto kontrata aktivizohen do të jetë mjaftueshëm i lartë sa të jetë dekurajues për tregun që të

mbështetet në OST, p.sh. një shtesë prej 25% në çmimin e aktivizimit të ofertës më të shtrenjtë të energjisë balancuese.

5 PROCESI I ANGAZHIMIT PËR SHPËRNDARJE

5.1 Specifikimi i ofertës

5.1.1 Kategoritë e ofertës

5.1.1.1 Të gjitha ofertat e angazhimit për shpërndarje për aFRR, mFRR dhe RR i përkasin :

- a. Qëllimeve të balancimit:
 - i. Ofertat e aFRR të kontraktuara;
 - ii. Ofertat e aFRR të pa kontraktuara;
 - iii. Ofertat e mFRR/RR.
- b. Qëllimeve të tjera (p.sh. menaxhimi i konxhestionit):
 - i. Ofertat RR.

5.1.2 Struktura e një mesazhi të ofertës së angazhimit për shpërndarje

5.1.2.1 Një PPB që oferton në emër të një OShB, mund të dërgojë më shumë se një ofertë angazhimi për shpërndarje në një mesazh të vetëm të ofertës. Mesazhi i ofertës ka tri pjesë:

- a. Mesazhi i ofertës
- b. Oferta (0..n për çdo mesazh oferte)
- c. Rreshtat e ofertës (92..100 për çdo ofertë)

5.1.2.2 Mesazhi i ofertës përbëhet nga një numër i pakufizuar i ofertave. Një mesazh oferte me numrin e ofertave zero (0) tregon se PPB nuk dëshiron të paraqesë ndonjë ofertë të angazhimit për shpërndarje.

5.1.2.3 Çdo mesazh i ri i ofertës anulon të gjitha mesazhet e ofertës së mëparshme.

5.1.2.4 Mesazhet e ofertës shkëmbehen në një format të standartizuar. OST do të përcaktojë dhe ta vendosë këtë format në dispozicion për të gjitha palët dhe njëkohësisht do të publikojë një përshkrim të hollësishëm të këtij formati.

5.1.2.5 Mesazhi i ofertës dërgohet nga PPB në sistemin qendror të mesazheve të OST, dhe do t'i drejtohet personit të kontaktit të përcaktuar nga OST.

5.1.2.6 Çdo ofertë e angazhimit për shpërndarje për aFRR/mFRR/RR përbëhet nga rreshtat e ofertës, një për çdo PShD (çdo 15 minuta). Çdo ditë kalendarike numëron 96 PShD.

5.1.3 Karakteristikat e një mesazhi oferte

5.1.3.1 Karakteristikat e një mesazhi oferte paraqiten në tabelën në vijim:

| Karakteristika | Njësia | Përshkrimi | Vlerat e lejuara |
|---------------------|--------|---|---|
| OShB | N/A | Identifikimi i OShB | Kodi EIC |
| PPB | N/A | Identifikimi i PPB, disbalanca e të cilit do të rregullohet në aktivizim | Kodi EIC |
| Kërkesa | N/A | Nëse mesazhi është paraqitur me kërkesë të OST, duhet të përfshihet numri i kërkesës së OST | Numri i kërkesës së OST |
| Data e shpërndarjes | N/A | Data për të cilën janë të vlefshme ofertat | Diapazoni i datave: Aktuale ne Aktuale + 7 ditë kalendarike |

5.1.4 Karakteristikat e një oferte të angazhimit për shpërndarje

5.1.4.1 Karakteristikat e një oferte të angazhimit për shpërndarje paraqiten në tabelën në vijim:

| Karakteristika | Njësia | Përshkrimi | Vlerat e lejuara |
|----------------|--------|---|---|
| Marrëveshja | N/A | Identifikimi i marrëveshjes midis OShB dhe OST | Numri i kontratës me OST përmban 10 karaktere alfa-numerike |
| Referenca | N/A | Identifikimi unik i ofertuesit të ofertës si pjesë e mesazhit | zgjedhja e ofertuesit |

| Karakteristika | Njësia | Përshkrimi | Vlerat e lejuara |
|---------------------------|--------|--|---|
| Objekti ¹ | N/A | Një objekt i mundëson një ofertuesi të bashkojë dy oferta. Nga një Objekt vetëm një ofertë mund të aktivizohet në të njëjtën kohë. | zgjedhja e ofertuesit |
| Koha e aktivizimit | PShD | Intervali minimal i PShD në lidhje me PShD aktuale për të cilën ofrohet oferta për t'u aktivizuar nga OST; ndryshon aFRR, mFRR/RR për balancimin, mFRR/RR për qëllime të tjera | Numër i plotë në diapazonin 0 deri 672 (7 ditë) aFRR (e kontraktuar/jo e kontraktuar): Koha e Aktivizimit = 0; mFRR për balancim: Koha e Aktivizimit = 1; RR për balancim: Koha e aktivizimit = 2, 3, 4; RR për qëllime të tjera: Koha e Aktivizimit \geq 5 |
| Kohëzgjatja e aktivizimit | PShD | Numri minimal i PShD-ve të njëpasnjëshme për aktivizimin e pranueshëm nga OST | Numër i plotë 1 ose në diapazonin 0 deri 672 (7 ditë) aFRR (e kontraktuar/jo e kontraktuar), mFRR / RR për balancim: Kohëzgjatja e Aktivizimit = 1; |

¹ Një objekt aFRR bashkon dy oferta të shenjave të kundërta (në rritje/në rënie); Një objekt mFRR/RR për qëllime të tjera bashkon dy oferta me madhësi oferte dhe kohë aktivizimi të ngjashme, por me kohëzgjatje aktivizimi dhe çmim të ndryshëm.

| Karakteristika | Njësia | Përshkrimi | Vlerat e lejuara |
|------------------------------------|---|---|---|
| | | | RR për qëllime të tjera: Kohëzgjatja e aktivizimit ≥ 4 |
| Vëllimi | MW | Madhësia e ofertës + në rritje – në rënie | Në rritje: numër i plotë në diapazonin 4 deri 200; Numër i plotë në diapazonin -4 deri -200; |
| Shkalla e rregullimit ² | %/min e madhësisë së ofertës (karakteristika "Vëllimi") | Shkalla e rregullimit, si përqindje e karakteristikës Vëllim për minutë | Numër më një shifër pas presjes dhjetore, në diapazonin 7.0 deri në 100.0 |
| Vendndodhja/Rrjeti i objektit | N/A | Një lidhje, ose një grup lidhjesh, brenda rrjetit të tensionit të lartë, nga i cili OShB do të dispeçerojë aktivizimin. Kjo lidhje ose grup lidhjesh i përket një pronari ose administratori. | Kodi EIC |

5.1.5 Karakteristikat e rreshtit të ofertës së angazhimit për shpërndarje

5.1.5.1 Çdo PShD në datën e shpërndarjes për të cilën oferta është në dispozicion duhet të specifikohet.

| Karakteristika | Njësia | Përshkrimi | Vlerat e lejuara |
|----------------|--------|------------|------------------|
|----------------|--------|------------|------------------|

² Shënim: Kjo karakteristikë gjithashtu mund të përcaktohet si koha e plotë e aktivizimit (FAT-full activation time) në minuta, atëherë shkalla e rregullimit mund të rrjedhë nga: shkalla e rritjes = $60 / \text{FAT} [\% / \text{min}]$

| | | | |
|-----------------|-------|--|--|
| Disponueshmëria | ISP | Numri i PShD për të cilat aplikohet oferta | Numër i plotë unik në diapazonin 1 deri në 100, në rritje |
| Çmimi i ofertës | €/MWh | Çmimi i ofertës së energjisë balancuese | Numër me dy shifra pas presjes dhjetore Vlera në diapazonin -10,000.00 deri në +10,000.00 |

5.1.5.2 Për ofertat për qëllime balancimi çmimi i ofertës mund të ndryshojë për çdo PShD; për ofertat për qëllime të tjera çmimi i ofertës duhet të jetë i pandryshueshëm.

5.1.5.3 Simboli (shenja) i produktit të madhësisë së ofertës dhe çmimit të aktivizimit të energjisë balancuese të OShB tregon drejtimin e fluksit të parasë, me + tregon se OST paguan OShB dhe - , OShB paguan OST. Nëse Vëllimi = 0, çmimi i ofertës nuk zbatohet.

5.1.5.4 Simboli (shenja) i ofertës dhe çmimi i aktivizimit që rrjedhin nga çmimet e ofertës për të gjitha ofertat e aktivizuara diktojnë drejtimin e fluksit të parasë:

| | Çmimi i aktivizimit >0 | Çmimi i aktivizimit <0 |
|-------------------------------|------------------------|------------------------|
| Energjia balancuese në rritje | OST paguan OShB | OShB paguan OST |
| Energjia balancuese në rënie | OShB paguan OST | OST paguan OShB |

5.1.6 Aspektet alternative të karakteristikave

5.1.6.1 Tabela e mëposhtme përcakton cilat karakteristika janë alternative dhe të cilat janë të detyrueshme, në varësi nga kategoria e ofertës:

| Kategoria e ofertës / Karakteristika | aFRR e kontraktuar | aFRR e pa kontraktuar | mFRR/RR për balancim | RR për qëllime të tjera |
|--------------------------------------|--------------------|-----------------------|----------------------|-------------------------|
| OShB | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |
| PShD | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |

| | | | | |
|---------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Kërkesa | Alternativ | Alternativ | Alternativ | Alternativ |
| Data e shpërndarjes | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |
| Kontrata | I detyrueshëm | N/A | N/A | N/A |
| Referenca | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |
| Objekti | Alternativ | Alternativ | N/A | Alternativ |
| Koha e aktivizimit | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |
| Kohëzgjatja e aktivizimit | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |
| Shkalla e rregullimit | I detyrueshëm | I detyrueshëm | N/A | N/A |
| Vendodhja | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |
| Vëllimi | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |
| Çmimi i ofertës | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm | I detyrueshëm |

5.2 Mbyllja e portës së ofertimit

5.2.1 Para ditës së shpërndarjes

5.2.1.1 Ofertat e energjisë balancuese për ditën e shpërndarjes duhet të arrijnë në OST deri në orën 14:00 çdo ditë para ditës së shpërndarjes. Mesazhet e ofertës për aFRR/mFRR/RR të marra nga OST, midis orës 14:00 dhe kohës së miratimit nga OST që nuk janë pajisur me një numër të vlefshëm Kërkesa do të injorohen (duke njoftuar dërguesin).

5.2.1.2 Sapo të ketë kaluar afati i miratimit nga OST, ofertat aFRR/mFRR/RR për ditën e shpërndarjes mund të rishikohen. Proçedura për ditën e shpërndarjes hyn në fuqi në orën 23:00 në ditën e përgatitjes.

5.2.2 Gjatë ditës së shpërndarjes

5.2.2.1 Në ditën e shpërndarjes, afati i fundit për dorëzimin e ofertave të rishikuara të aFRR/mFRR/RR gjithmonë mbyllet një orë para secilës PShD. Pas mbylljes së ofertave

për një PShD, të gjitha ofertat për atë PShD refuzohen, përveç atyre që kanë një *Numër Kërkese* të lëshuar nga OST.

Shembull: Është 18:42 dhe një OShB vendos të rishikojë ofertat e tij për ditën aktuale. Në këtë kohë OShB do të lejohet të paraqesë ndryshimet për PShD-në nga ora 19:45 deri në 20:00 dhe për të gjitha PShD në vijim. Në rast se OShB paraqet oferta të ndryshuara për një ose më shumë PShD para orës 19:45, mesazhi i ofertës me të gjitha ofertat e tij do të refuzohet.

5.3 Publikimi i rezultateve

5.3.1 OST do të publikojë një ofertë të përbashkët sipas *merit order* për qëllime balancimi dhe për qëllime të tjera veç e veç në mënyre anonime. Ky rend i ofertës së përbashkët mund të kërkohet në çdo kohë për ditën tjetër dhe për çdo ditë para saj. Kur publikohen, do të paraqitet data dhe ora e kërkesës si dhe dita e shpërndarjes.

5.3.2 Publikimi i një oferte të përbashkët anonime sipas *merit order* ka përparësitë e mëposhtme:

- a. OShB-të mund ta përdorin atë për të (ri) pozicionuar ofertat e tyre ose për të dhënë oferta të reja.
- b. Në një masë më të vogël, në këtë informacion OShB-të mund të bazojnë vlerësimin e tyre të riskut të disbalancës dhe të veprojnë në tregun brenda ditës sipas rastit. Megjithatë:
 - i. Ofertat nuk janë përfundimtare deri në mbylljen përfundimtare të portës
 - ii. Ka të bëjë me rendin e ofertës së përbashkët të ofertave të aFRR dhe mFRR, ndërsa në praktikë ofertat e aFRR mund të aktivizohen ndonjëherë pas ofertave të mFRR, edhe nëse ato janë më të shtrenjta (për arsye teknike)

5.3.3 Rendi i një oferte të përbashkët anonime sipas *merit order* do të tregonte çmimin e energjisë balancuese në nivele të ndryshme të vëllimeve të aktivizuara, p.sh. në 50 MW, 100 MW, 200 MW, 400 MW dhe 100% të vëllimit total në dispozicion në të dy drejtimet (në rritje dhe në rënie).

5.4 Afatet

5.4.1 Kjo është një përmbledhje e afateve të përmendura më sipër:

- a. Hapja e portës për ofertimin e angazhimit për shpërndarje: D-7, 0:00
- b. Mbyllja fillestare e portës për ofertimin e angazhimit për shpërndarje për të gjithë PShD-të e ditës D: D-1, 14:00
- c. Miratimi i ofertave fillestare nga OST dhe ri-hapja e portës së ofertave për të gjithë PShD-të e ditës D: D-1, 15:00

- d. Mbyllja përfundimtare e portës për ofertat e angazhimit për shpërndarje të PShD i ($i = 0-100$) në ditën D: D, 1 orë para fillimit të PShD-së i.